



KUKES

Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2012-2016

"Ndërtojmë së bashku një rajon tërheqës dhe të begatë"

Qershor, 2012

Projekti Mbështetje e Integruar për Decentralizimin është një projekt i financuar nga BE-PNUD. Përfitues i drejtpërdrejtë i projektit është Ministria e Integritimit Europian të Shqipërisë. Projekti zbatohet nga zyra në Shqipëri e Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) me Asistencë Teknike të konsorciumit ECORYS, OPM dhe Co-PLAN. Pikëpamjet dhe komentet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht institucionet e lartpërmendura.

Permbajtja

Fjala e Kryetarit	4
1. Situata Aktuale	5
1.1. Prezantimi me rajonin	5
1.2. Demografia dhe Zhvillimit Hapësinor	8
1.3. Rritja, Konkurruesmeria, dhe Kohezioni Ekonomik	12
1.4. Kohezioni Social, Shëndeti dhe Edukimi	20
1.5. Mjedis, Aksesit në Infrastrukturë dhe Shërbime	26
1.6. Financat lokale dhe eksperiencia me projektet e zhvillimit	29
2. Analiza SWOT	36
3. Vizioni	46
4. Objektivat	47
5. Prioritetet, veprimet dhe përgatitjet	48
6. Burimet e nevojshme	62
7. Menaxhimi	64
Aneks 1 – Projekte Prioritare	64
Aneks 2 – Autorë dhe kontribues	74
Aneks 3 – Konsultimet e strategjisë	76
Aneks 4 – Integrimi i komenteve nga konsultimet publike	77

Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabela 1 Lista e NJQV-ve (bashki/komuna) në qarkun Kukës, 2010	5
Tabela 2 Punëdhënësit më të mëdhenj, 2010	13
Tabela 3 Numri i ndërmarrjeve sipas sektorit ekonomik (2011)	14
Tabela 4 Numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë së biznesit	14
Table 5 Bimet medicinale dhe aromatike (2011)	15
Tabela 6 Prodhimi i bimëve të arave dhe drufrutorëve në rajon dhe në vend ne ton (2010)	16
Tabela 7 Të ardhurat e veta për frymë (2010)	30
Tabela 8 Projektet e zhvillimit, (2005-2012)	33
Tabela 9 Lista e projekteve të zhvillimit sipas sektorëve, Qarku Kukës, 2005-2012	34
Figura 1 Harta e rajonit	7
Figura 2 Popullsia (2006-2010)	9
Figura 3 Vlera e Shtuar Bruto (në %), 2009	12
Figura 4 Ndërmarrjet aktive dhe aktivitetit ekonomik, 2010	13
Figure 5 Struktura e shpenzimeve të konsumit (2010)	21

Fjala e Kryetarit

Botimi i Strategjisë Rajonale të Zhvillimit është një hap shumë i rëndësishëm në procesin e gjatë dhe të vështirë të zhvillimit të qarkut tonë, që do të shërbejë jo vetëm organeve të pushtetit lokal por edhe të gjithë palëve të interesuara.

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie është që të japë një panoramë të plotë të gjendjes ekonomike dhe sociale të rajonit tonë si dhe të krijojë një vizion të qartë se si mund të zhvillohet ai dhe të sigurojë që objektivat e saj të jenë në përputhshmëri të plotë me objektivat lokale dhe ato kombëtare të zhvillimit.

Një analizë e gjendjes së rajonit tonë që për herë të parë mund të thuhet që është reale dhe e bazuar në të dhëna të sakta - evidentimi i problemeve kryesore dhe përcaktimi i prioriteteve dhe objektivave, si dhe përcaktimi i rrugëve se si mund të arrihen ato, e bëjnë strategjinë e zhvillimit një dokument të thjeshtë për tu kuptuar dhe zbatuar nga të gjithë aktorët që do të jenë pjesë e procesit të zhvillimit të Qarkut.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti u shoqërua me një sërë trajnimesh në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të administratës së pushtetit lokal, rajonal dhe grupeve të tjera të interesit në rajon. Projekt idetë e para të hartuara në mbështetje të kësaj strategjie e tregojnë tashmë më së miri rritjen e ketyre kapaciteteve dhe janë një provë e qartë e suksesit të kësaj strategjie.

Një falenderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij partneriteti rajonal; punonjës të administratës së Këshillit të Qarkut Kukës, përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore, të institucioneve të rajonit tonë dhe grupeve të tjera të interesit, të cilët me kontributin dhe ekspertizën e tyre bënë të mundur hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Rajonal si dhe transmetuan mesazhin se aktorë të ndryshëm mund të punojnë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët: një të ardhme më të mirë për rajonin tonë.

Një falenderim i veçantë për PNUD-in, që nëpërmjet projektit "Mbështetje e Integruar për Decentralizim" bëri të mundur hartimin dhe botimin me sukses të kësaj strategjie.

Sfidat në procesin e zhvillimit rajonal janë të shumta, por mund të them me bindje të plotë që në të ardhmen, *Qarku Kukës do të jetë një ndër rajonet më të zhvilluara dhe do të mund të ofrojë shanse reale për të jetuar dhe punuar për një jetesë më të mirë për ne dhe brezat e ardhshëm.*

Ibsen ELEZI

Kryetar i Këshillit të Qarkut Kukës

1. Situata Aktuale

1.1. Prezantimi me rajonin

Qarku i Kukësit ndodhet në pjesën veri-lindore të vendit. Qarku kufizohet në anën e tij lindore me Maedoninë dhe Kosovën, në veri me Malin e Zi, në perëndim me qarqet Shkoder dhe Lezhe dhe në jug me Qarkun e Dibrës. Kukësi karakterizohet nga modelet e terrenit të vështira. Lartësia mesatare e qarkut është e 680 metra mbi nivelin e detit. 41% e popullsisë jeton në zonat e maleve të ulët (mes 301 dhe 500 metra) dhe pjesa tjetër në zonat malore dhe ato me lartësi mesatare (501-800m). Qarku është shumë i pasur në mjedise ujore dhe burime hidrike. Aty bëhet grumbullimi i të gjitha rrjedhave dhe lumenjve që derdhen në Lumin Drin, që nga Liqenet e Prespës dhe Pogradecit, Bjeshkët e Namuna e deri tek bashkimi i Lumit Drin me Lumin Buna. Liqeni i Fierzës është qendra e të gjitha rrjedhave dhe mjediseve ujore dhe shumë i përshtatshëm për rritjen e peshve të llojeve të ndryshme. Pasuritë ujore të rajonit përdoren edhe si burime energjie. Rajoni është i pasur me minerale të shumta metalore (sidomos krom, dhe më pak Nikel-Silikat, Hekur Nikel e bakër) dhe jo metalore (kuarc, mermer). Lidhja me Tiranën bëhet nëpërmjet rrugës nacionale Kukës – Tiranë, me gjatësi 144 km dhe përkohet për 120 minuta. Me aeroportin e Rinasit rajoni lidhet me rrugën nacionale Kukës – Vore – Rinas, me gjatësi 124 km e cila përkohet për 90 minuta. Distancat e rajonit nga portet kryesore të vendit, Durrës dhe Vlorë janë përkatësisht 160 km (135 min) dhe 291 km (300 min). Qarku ka akses në dy pika doganore; atë të Morinit nëpërmjet rrugës nacionale Kukës – Morin, me gjatësi 20.5 km dhe distancë kohore 20 minuta; dhe doganën Qafe Prush – rruga nacionale Kukës – Krume – Qafe Prush, me gjatësi 55 km e cila përkohet për 90 minuta. Popullsia e rajonit sipas regjistrimit të fundit në tetor të 2011, rezulton të jetë 85,239 banorë.

Në tabelën më poshtë është paraqitur lista e NJQV-ve (bashki dhe komuna) që përbëjnë qarkun.

Tabela 1 Lista e NJQV-ve (bashki/komuna) në qarkun Kukës, 2010


1	Bashkia	Kukës	19	Komuna	Fajza
2	Bashkia	Krumë	20	Komuna	Gjinaj
3	Bashkia	Bajram Curri	21	Komuna	Bytyc
4	Komuna	Malzi	22	Komuna	Lekbibaj
5	Komuna	Bicaj	23	Komuna	Fierzë
6	Komuna	Ujmisht	24	Komuna	Margegaj
7	Komuna	Tërthore	25	Komuna	Bujan
8	Komuna	Shtiqen	26	Komuna	Llugaj
9	Komuna	Zapod	27	Komuna	Tropojë-Fshat
10	Komuna	Shishtavec			
11	Komuna	Topojan			
12	Komuna	Bushtrice			
13	Komuna	Surroj			
14	Komuna	Arren			
15	Komuna	Kolsh			
16	Komuna	Kalisë			
17	Komuna	Grykë Cajë			
18	Komuna	Golaj			

Ekonomia e rajonit ka levizur nga bujqësia drejt ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Ka shumë pak subjekte të mëdha private në rajon. Shumica e bizneseve kanë më pak se 7 punonjës pjesa më e madhe e të cilave drejtohen nga një person ose janë biznese familjare. Sektorët ekonomikë prioritarë dhe me

potencial të rëndësishëm zhvillimi, rritje e konomike dhe punësimi janë; turizmi, sektori minerar dhe bimët medicinale

Rajoni ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolar. Atraksionet që tërheqin më shumë turistë janë; Lugina e Valbonës, Liqeni i Fierzës, Liqeni i Komanit, Shishtaveci etj.

Figura 1 : Harta e rajonit



Burimi: Harta fizike dhe administrative, llogaritjet tona

1.2. Demografia dhe Zhvillimit Hapësinor

Popullsia

Qarku i Kukësit ndodhet në pjesën veri-lindore të vendit. Qarku kufizohet në anën e tij lindore me Maqedoninë dhe Kosovën, në veri me Malin e Zi, në perëndim me qarqet Shkoder dhe Lezhe dhe në jug me Qarkun e Dibrës. Rajoni ka një popullsi prej 114,000 banorësh¹ të shpërndarë në 3 bashki dhe 24 komuna. Që nga viti 1990, popullata përjetoi një rënie dramatike (rreth 30%), edhe pse kjo prirje negative është zvogëluar në periudhën 2006-2010,

Dy tendencat të rëndësishme kanë qenë të pranishme në këtë qark: shpopullimi i përgjithshëm i ndjekur nga migrimet ndër-rajonale nga zonat rurale në qendrat urbane. Ndërmjet 2006 dhe 2010, popullsia e bashkive u rrit me 3.8 për qind, ndërsa në komuna ajo ka rënë me 2.5 për qind. Komunitat që kanë përjetuar rënien më të madhe në 4 vjet janë; Kalis (42.8%), Kolsh 30.6%, Fierzë (13.5%) dhe Topojan (12.8%). Rritjet më të mëdha të popullsisë janë shfaqur në komunën Bytyc (48.4%), Bashkinë e Krumës (15.8%) dhe në komunën Lekbibaj (14.9%).


Dendësia mesatare rajonale e popullsisë është 53 ban/km², e qëndrueshme që nga viti 2006. NJQV-të me dendësinë e popullsisë mbi mesataren rajonale janë bashkitë e Kukësit (2,569 ban/km²) dhe Bajram Curri 676 inh/km². Shifrat më të ulëta të densitetit janë vërejtur në komunat Arren (10 ban/km²), e Bytyc (12 ban/km²), e Lekbibaj dhe Margegaj (13 ban/km²), e Gryke-Çaje (20 ban/km²), Gjinaj 23 ban/km²).

Aktualisht popullsia urbane përbën 34.2% të popullsisë totale të qarkut krahasuar me 32.8% në vitin 2006

Kukësi ka një popullsi relativisht të re. Grupi i moshës 0-14 përfaqëson 38.5% të popullsisë së qarkut, grupmosha 15-64 vjeç përbën 45.9 për qind të totalit, ndërsa 15.6% është mbi 64 vjeç. Tendencat e tre grupmoshave² të përmendura më sipër kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme që nga viti 2006.

¹ Sipas Regjistrimit Civil. Rezultatet e censusit të vitit 2011 nga INSTAT tregojnë se në rajon popullsia rezidente është 85.000 banorë.

Figura 2 Popullsia (2006-2010)



Burimi: Gjendja civile Qarku Kukës, llogaritjet e veta

Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi, infrastruktura e transportit dhe e komunikimit jashtëzakonisht e dobët, terrenit në përgjithësi të vështirë, kushteve të pafavorshme klimatike dhe bujqësore, si dhe shfrytëzimit pa kriter të pyjeve

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Kukësi në terma të popullsisë është qarku më i vogël në Shqipëri. Popullsia totale e qarkut Kukës është vetëm 4% e shifrës kombëtare. ii. Dendësia e popullsisë së rajonit është në 48 % e dendësisë kombëtare. iii. Shkalla e urbanizimit të rajonit (34%), gjithashtu shumë më e ulët se mesatarja kombëtare.
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. 67% e njërive të qeverisjes vendore të rajonit kanë pësuar një rënie të popullsisë që nga viti 2006 ii. Vetëm 34.2% e popullsisë së Qarkut jeton në zonat urbane. iii. Shpërndarja mes grupmohave nuk ndryshon dukshëm mes njërive të qeverisjes vendore
<p><i>Faktorët që kontribuojnë në gjendjen aktuale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Tranzicioni ekonomik dhe rënia e ofertës rajonale të punës ii. Migrimi nga zonat rurale në ato urbane brenda qarkut si rrjedhojë e kushteve të vështira të punës në bujqësi, produktivitetit të ulët të këtij sektori dhe aksesit të kufizuar ndaj shërbimeve në zonat rurale. iii. Katër vitet e fundit, popullsia totale e rajonit është stabilizuar për shkak të përmirësimeve në infrastrukturën e transportit rajonal dhe lokal. (Psh: projektet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale të financuar nga Banka Botërore dhe zbatuar nga FSHZH, Durrës-Kukës-Morinë (2007)
<p><i>Mënyrat e mundshme për përmirësim</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Krijimi i mundësive për punë të qëndrueshme në rajon. ii. Përmirësimi i transportit, komunikimit dhe aksesit në shërbime. iii. Krijimi i mundësive në zonat rurale për punimin e tokës dhe stimulimin e aktivitetit blegtoral sipas zonave (psh: dhënia me qera të ulët e mjeteve të punës për bujqësi apo ngritja e baxhove të komunave për grumbullimin e qumështit) iv. Sigurimi i tregut të shitjes për produktet bujqësore dhe blegtorale

Zhvillimi Hapësinor

Kukesi karakterizohet nga modele terreni të vështira. Lartësia mesatare e qarkut është e 680 metra mbi nivelin e detit. 41% e popullsisë jeton në zonat e maleve të ulët (mes 301 dhe 500 metra) dhe pjesa tjetër në zonat malore dhe ato me lartësi mesatare (501-800m).

Sipas të dhënave të territorit dhe të tokës bujqësore, rajoni i Kukësit ka një sipërfaqe prej 2,373 km². Qarku karakterizohet nga pjesë shumë të ulëta të tokës bujqësore (11 %), pjesë të larta të pyjeve dhe kullotave (64%) pjesë të vogla të tokës tjetër (25%).

Sipërfaqet me pjesë më të madhe të tokës bujqësore (më shumë se 20% e strukturës së përgjithshme së tokës) vihen re në; Komunat Fajza (27%), Shishtavec (27%), Llugaj (26%), Kalisë (24%), Ujmisht (23%) Bushtricë (20%), Topojan (20%) dhe Bashkinë Krumë (20%). Qarku i Kukësit është shumë i pasur me pyje dhe kullota. 70% e njësive të qeverisjes vendore të qarkut kanë më shumë se 50% pyje dhe kullota në strukturën e tyre tokësore. Përqindjet më të larta shënohen në; Gjinaj (95%), Malzi (90%), Bytyc (89%), Fierzë (89%), Surroj (83%), Fajze (82%). Nivelet e ulëta të tokës bujqësore dhe struktura e fragmentuar e tokës janë për shkak të ndryshimit të lartë të terrenit.³

Përdorimi i tokës bujqësore në qark është 0.22 ha për frymë ndërsa toka arë e punuar për frymë është 0.11 hektarë (49% e tokës bujqësore). Raportet më të mëdha të tokës së punueshme ndaj asaj totale bujqësore gjenden në njësitë Shtiqen (83%), Bicaj (75%), Kukës (69%), Zapod (66%), Llugaj (65%)

Toka bujqësore për frymë ka pësuar rënie të konsiderueshme në komunën Bytyc (-33%), bashkinë Krumë (-14%), komunën Lekbibaj (-13%) dhe komunën Ujmisht (-7%). Këto janë gjithashtu njësitë me rritjen më të madhe të popullsisë. Ka një rritje të konsiderueshme të hektarëve të tokës bujqësore për frymë në komunat e Kalisë (74.8%), Kolsh (44.1%), Fierzë (15.6%), Topojan (14.7%). Këto NJQV kanë pësuar ulje të konsiderueshme të popullsisë për të njëjtën periudhë, 2006-2010.

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <ol style="list-style-type: none">Lartësia mesatare e Kukësit (680 m) është rreth 1.6 herë më e madhe se mesatarja kombëtare (424m)Qarku ka një sipërfaqe të ulët të tokës bujqësore dhe sipërfaqe të lartë të pyjeve (11% / 64%) në krahasim me nivelin kombëtar, ku raporti është 24% / 54%.Përdorimi i tokës bujqësore për frymë në qark është pothuajse i njëjtë me shifrën e vendit. (0.22)Tokat bujqësore lërohen kryesisht me dorë ose kafshë. Numri i fermave ku tokat lërohen me traktorë është sa gjysma e shifrës kombëtare.
<p><i>Perspektiva e Brendshme</i></p> <ol style="list-style-type: none">Shumica e NJQV-ve (20 nga 27) janë të vendosura në lartësi mbi 500 metra.59% e NJQV-ve (16 nga 27) janë mbi mesataren rajonale sa i përket përdorimit të tokës bujqësore 55.5% e njësive (15 nga 27) kanë hektarë toke bujqësore për frymë më të madhe se 125% e treguesit rajonal.70% e njësive të qeverisjes vendore të rajonit kanë më shumë se 50% të pyjeve dhe kullotave në strukturën e tyre të tokës
<p><i>Faktorët që kontribuojnë në gjendjen aktuale</i></p> <ol style="list-style-type: none">Mundësi të kufizuara për të pasur zona të punueshme për shkak të terreneve të vështiraInfrastruktura e dobët bujqësore (mjetet mekanike, sistemet e ujitjeje)Lëvizjet ndërrajonale të popullsisë kanë ndikuar direkt shifrat e përdorimit të tokës bujqësoreTokë bujqësore shumë e fragmentuar që përbën një nga problemet kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe blegtorisë.
<p><i>Mënyrat e mundshme për përmirësim</i></p> <ol style="list-style-type: none">Kreditimi dhe subvencionimi i mëtejshëm i produkteve bujqësore dhe blegtoriale. Skema subvencionimi për mbështetjen e fermerëve.Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore (mjetet mekanike dhe sistemet e ujitjes)

³ Pabarazitë Rajonale në Shqipëri (2010), f. 41

- | | |
|------|--|
| iii. | Zhvillimi i fermave sipas produkteve të veçanta (pemtari, vitikulturë, arrore) |
| iv. | Zhvillimi i turizmit tradicional në zonat periferike dhe rurale. |

Konkluzione

Çështjet e mëposhtme kryesore janë të dukshme sa i përket demografisë dhe zhvillimit hapësinor:

- Në një perspektivë afatgjate, rajoni ka humbur pothuajse 1/3 e popullsisë së tij që nga viti 2000 ndërsa në periudhën 2006-2010 situata është stabilizuar.. Ndërkohë, ka patur një zhvendosje të njëkohëshme por më të lehtë të popullsisë nga komunat në bashki. Stabilizimi i popullsisë ka ndodhur për shkak të përmirësimeve në infrastrukturën e transportit rajonal dhe lokal dhe politikave më të mira bujqësore.
- Shfrytëzimi i hapësirave dhe demografia në rajon është e lidhur drejtpërdrejt me karakteristikat gjeografike të rajonit, terrenet e vështira malore, sipërfaqet e larta të pyjeve, fragmentimit të tokës bujqësore dhe aksesit të vështirë në shërbime dhe infrastrukturë.
- Nevojiten investime të metjeshme infrastrukturore sidomos për zonat e thella rurale dhe në pjesë të vështira malore për të tërhequr vendbanime të reja dhe rigjallërimin e pjesëve të shpopulluara.

1.3. Rritja, Konkurrueshmeria, dhe Kohezioni Ekonomik


Aktiviteti Ekonomik

Per sa l përket performancës ekonomike, Kukesi është konsideruar gjithmonë si një ndër rajonet me të varfëra të vendit. PBB e llogaritur është 1,753 Euro për frymë ndërkohë që PBB e vendit është 2469 Euro. Megjithatë këto vlera mund të jenë të nënvlerësuar nëse marrim parasysh efektin e shpopullimit.

4

Gjate tetë viteve të fundit ekonomia ka levizur nga bujqësia drejt ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Që nga 2002, pjesa që zë vlera e shtuar bruto e bujqësisë dhe tregtisë me shumicë e pakicë kanë rënë përkatesisht me -14% dhe -15% ndërkohë që industria, ndërtimi dhe shërbime të tjera janë rritur respektivisht me 63%, 44% dhe 15%.

Figura 3 Vlera e Shtuar Bruto (në %), 2009



Burimi: INSTAT

Ka shumë pak subjekte të mëdha private në rajon. Shumica e bizneseve kanë më pak se 7 punonjës pjesa më e madhe e të cilave drejtohen nga një person ose janë biznese familjare.

⁴PBB e vlerësuar për frymë në 2007 : Pabarazitë Rajonale në Shqipëri (2010), faqe. 47

Llogaritjet e fundit të PBB-së rajonale nga INSTAT në 2009 dhe sipas shifrave të censurit të fundit të popullsisë në 2011, e vendosin Kukësin afër mesatares kombëtare të PBB-së për frymë.


Tabela 2 Punëdhënësit më të mëdhenj, 2010

Emri i Kompanisë	Sektori Ekonomik	Nr i të punësuarve
SHRSF Trezhnjeva	Sherbimi i ruajtjes fizike	95
Bechtel-Enka	Transport	70
SHRSF Brahaj 01	Sherbimi i ruajtjes fizike	35
Istrefi - AG	Tregti	35
Marsi	Ndertim	32
Armemil	Ndertim	26
Hasi shpk	Ndertim	11

Burimi: Zyra e tatim taksave, Qarku Kukës

Sipas INSTAT numri i ndërmarrjeve të krijuara rishtazi në rajon, për vitin 2010 është 111. Ky tregues ka patur një rënie me 17 % për periudhën 2006-2010. Ndërsa numri i ndërmarrjeve që mbyllen çdo vit ka ndryshuar nga 38 në 2008 deri në 33 në 2010⁵. 85% e bizneseve aktive janë ndërmarrje të vogla me 1-4 punonjës, 7% kanë nga 5-9 punonjës, 8 % me 10-49 punonjës dhe vetëm 1% e tyre kanë mbi 50 punonjës.

Figura 4 Ndërmarrjet aktive dhe aktivitetit ekonomik, 2010



Burimi: INSTAT

Një pasqyrë më e qartë e aktivitetit sipërmarrës në rajon, sipas sektorëve të ekonomisë dhe madhësisë së biznesit jepet në tabelën më poshtë:

⁵ Të dhënat për mbylljet e ndërmarrjeve (pakësimet) janë marrë nga zyra rajonale e QKR-së në Qark

Tabela 3 Numri i ndërmarrjeve sipas sektorit ekonomik (2011)

Sektori i Ekonomise	Nr i ndermarrjeve
Tregeti	620
Sherbime	131
Transport	98
Ndertim	65
Prodhim	39
Sherbime te tjera/profesionet e lira	30
Ambulant	27
Minerare	8
Total	1018

Burimi: Drejtoria e Tatim Taksave, Qarku Kukës

Tabela 4 Numri i ndërmarrjeve sipas madhësisë së biznesit

Madhesia e Biznesit	Nr i ndermarrjeve
Biznes I madh	213
Biznes i vogel	805
Totali	1018

Burimi: Drejtoria e Tatim Taksave, Qarku Kukës

79 % e ndërmarrjeve janë biznese të vogla. Ndërmarrjet në rajon përqëndrohen më tepër në tregëti (61%), shërbime (13%) dhe transport (10%). Aktiviteti sipërmarrës është më shumë i përqëndruar fizikisht në zonën e Kukësit (jug-lindje e rajonit), Tropojës (veri-perëndim) dhe Hasit (në lindje). Në 2010, vetëm 10 subjekte financohen me kapital të huaj në rajon.

Sektori Minerar

Rajoni është i pasur me minerale të shumta metalore (sidomos krom, dhe më pak Nikel-Silikat, Hekur Nikel e bakër) dhe jo metalore (kuarc, mermer). Keto të fundit përdoren kryesisht si lëndë ndërtimi ose zbulurimi. 930 km² ose 43% e sipërfaqes totale të rajonit, është e pasur me minerale. Nga këto 930 km², 96% është e pasur me Krom, sidomos zona e Tropojës (84%) dhe e Kukësit (12%). Mineralet e tjera ndodhen në sasi më të vogla; nikel-silikat (2.3% e sipërfaqes totale me minerale), ferro-nikel (1%) dhe bakër (0.13%). Janë 30 ndërmarrje në rajon që kanë leje minerare dhe ushtrojnë aktivitetin në këtë sektor, 20 nga të cilët janë vetëm në Tropojë dhe Kukës.

Bimët Medicinale⁶

Relievi i larmishëm dhe klima kanë ndikuar në krijimin e mikrozonave, të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e ekosistemeve të pasura në llojshmëri biologjike. Kështu kemi edhe një shumëllojshmëri të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, (MET) të cilat janë një pasuri e madhe, që duhet njohur e

⁶ Procesi i vjeljes, grumbullimit dhe manipulimit të bimëve mjekësore dhe eterovajore, rregullohet me Ligjin Nr.10120, datë 23.4.2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore".

shfrytëzuar. Në Kukës njihen 45 lloje drurësh dhe shkurrësh mjekësore dhe 83 lloje bimë mjekësore por numri tyre është edhe më i madh. Numri llojeve të bimeve që grumbullohen aktualisht është rreth 30

Bimet MET janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë ekonom⁷ familjare në fshatra. Në rrethet Kukës dhe Has ka pasur një traditë të herëshme të mbledhjes dhe grumbullimit të tyre. Grumbullimi bëhet nga ish ndërmarrja e grumbullimit dhe destinacioni kryesor ishte eksporti. Në disa ish kooperativa si në Arren, Shemri, Surroj kanë qene të ngritura impiante distilimi të gjetheve të pishës dhe rreshires, për prodhimin e esencave. Aktualisht bimët mbledhen kryesisht nga banorë të fshatrave në territoret e të cilëve ato ndodhen dhe pastaj grumbullohen nga tregëtarë lokal apo të tjerë që jo të gjithë janë të licensuar. Fermerët lokalë nuk i kultivojnë këto bimë por thjesht i mbledhin në natyrë.

Table 5 Bimet medicinale dhe aromatike (2011)⁸

Lloji i bimeve që grumbullohet (ton/vit)	Kukës	Has	Tropoje	Total
Meshtekna	60	-	-	60
Boronica	40	-	30	70
Dellinja e zeze	70	-	40	110
Trendafil e eger	30	-	20	50
Molla e eger	50	10	30	90
Total	250	10	120	380

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë Kukës

Këto dy vitet e fundit në Kukës nga ana e fermerëve ka filluar kultivimi i bimeve mjekësore kryesisht sherbelja. Në vitin 2011 Qarku i Kukësit ka mbjellë 3.1 ha me bime medicinale (Sherbele 2.9 ha dhe Gentian 0.2 ha). Destinacioni kryesor i këtyre bimëve vazhdon të mbetet eksporti.

Turizmi⁹

Qarku i Kukësit ka asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolar. Është bërë një anketim¹⁰ me bizneset që operojnë në sektorin turistik, në kuadër të strategjisë së turizmit dhe planit të veprimit për rajonin e Kukësit. Ky anketim tregon se rajoni ka kapacitete turistike të pashfrytëzuara maksimalisht. Norma e zënies së shtretërve në hotele dhe shtëpitë pritëse është vetëm 17% në vit. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në rajon është 2.9 ditë. Shpenzimi për një ditë është 7.705 lekë pjesa më e madhe e të cilit shkon për akomodim, ushqim/pije dhe blerje.

Strategjia e turizmit të rajonit përfshin një plan strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, si dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në këtë qark. Ajo merr në konsideratë njëherazi fokusin e politikës së BE-së për zhvillimin e turizmit dhe atë të strategjisë kombëtare që në thelb të dyja kanë si synim promovimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale të privuara dhe rritjen e cilësisë së jetës atje. Strategjia e vendit thekson gjithashtu zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor.

Bujqësia dhe Blegjoria

⁷ Nuk disponohen informacione të sakta për këtë sektor (psh: sa njëz janë të punësuar, sa janë volumet dhe vlerat që eksportohen në rajone apo vende të tjera)

⁸ Shifra të përafërta

⁹ Strategjia e turizmit dhe plani i veprimit për rajonin e Kukësit, 2010

¹⁰ Të dhënat e siguruar nga KQK, Kukës

Rajoni ka kapacitete shumë të vogla prodhuese bujqesore dhe blegtorale¹¹. Ky prodhim shërben kryesisht vetëm për të kënaqur nevojat e brendshme të rajonit, madje edhe këto të fundit jo gjithmonë në masën e duhur.

Tabela 6 Prodhimi i bimëve të arave dhe drufrutorëve në rajon dhe në vend ne ton (2010)

Lloji i kultures	Prodhimi qarku, 2010 (ton),	Prodhimi vendi, 2010 (ton),	Raporti i qarkut ndaj vendit
Grure	5421	294,900	2%
Miser	18288	362,000	5%
Theker	960	2,300	42%
Elbe dhe tagjira	390	34,600	1%
Perime	12411	860,400	1%
Patate	12235	208,000	6%
Fasule	732	24,000	3%
Foragjere	86000	5,429,000	2%
Prodhim fruta	7076	167,800	4%
Rrush	4349	184,900	2%

Burimi: Drejtoria rajonale e bujqësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Edhe kapacitetet prodhuese blegtorale janë të kufizuara. Kukësi ze respektivisht vetëm 4% dhe 5% të prodhimit kombëtar të qumështit dhe mishit. Detyrat e prodhimit blegtoral gjithnjë e me shume janë duke u trajtuar të lidhura me rritjen e numrit të fermave blegtorale të orientuara nga tregu.

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. PBB për frymë në Kukës është nën mesataren e vendit. ii. Kukësi si rajon ka numrin më të ulët të ndërmarrjeve aktive në vend iii. Shkalla e lindshmërisë¹² së ndërmarrjeve në Kukës (12.1) është më e ulëta për vendin (16.2)
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve ekonomike janë mikro ndërmarrje. Aktiviteti sipërmarrës është më shumë i përqëndruar fizikisht në zonën e Kukësit (jug-lindje e qarkut), Tropojës (veri-perëndim) dhe Hasit (në lindje). ii. Në zonat rurale ndërmarrjet ekonomike funksionojnë pothuajse si "pika shitjeje". iii. Zona më e pasur me mineralin e Kromit është Tropoja
<p>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</p> <ul style="list-style-type: none"> i. 20 vitet e fundit vendi ka kaluar nëpër një periudhë tranzicioni e cila është shoqëruar me reforma të ndryshme lidhur me pronësinë, privatizimet dhe ka sjell gjithashtu ndryshime në strukturën e ekonomisë. ii. Ashtu si në të gjithë vendin, zhvillimi i bujqësisë edhe në Kukës ndikohet nga ceshtja e fragmentarizimit të tokës¹³. Duke qene se pjesa më e madhe e saj është e ndare në ferma të madhësisë 0-1 ha, kjo e bën të vështirë rritjen e prodhimit dhe konkurrueshmërisë së produkteve dhe ndërmarrjen e investimeve në modernizimin e mjeteve dhe teknologjive të përdorura në bujqësi. iii. Për sa i përket industrisë së turizmit ky është një sektor relativisht i ri i cili ka nevojë për promovim. Megjithatë ka patur përmirësime të infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë dhe energji elektrike disa nga problemet më të mëdha në lidhje me këtë sektor janë; dëmtimi dhe ndotja e mjedisit, mungesa e infrastrukturës turistike dhe e marketingut. iv. Investimet në transport- sidomos ato në autostradën Durrës-Kukës- i kanë dhënë nxitje zhvillimit të biznesit por në të njëjtën kohë përbëjnë edhe një kërcënim për të (konkurrenca nga rajone apo vendet fqinje)

¹¹ Nga një analizë e përafert, del se me prodhimet blegtorale të rajonit plotësohet nevojat për: produktet e qumështit rreth 470 kg /fryme, produktet e mishit 69 kg/fryme, veze 158 kokra për fryme dhe mjalte 1 kg

¹² Raporti i ndërmarrjeve të krijuara rishtazi me totalin e ndërmarrjeve aktive në qark

¹³ 58 % e tokës në vend është nga 0-1ha, 34% nga 1.1-2 ha dhe 8% me shumë se 2 ha

- v. Një nga problemet kryesore të bizneseve në rajon është financimi.
- vi. Shfrytëzimi drastik i pyjeve dhe nënprodukteve të dyta, siç janë bimët mjekësore eterovajore e tanifere në 20 vitet e fundit, ka sjellë rrjedhoja negative. Kështuqë disa lloje rrezikohen të zhduken.
- vii. Kapacitetet e vogla prodhuese bujqësore e blegtorale të rajonit e bëjnë të vështirë aksesin për linja agroperpunimi dhe marketingu
- viii. Në rajon nuk janë prezente shoqatat e tregëtarëve , perpunuesve apo pale të tjera të interesuara duke bërë që tregëtimi i prodhimeve bimore , blegtorale dhe të nënprodukteve të tyre të mos jete të organizuara

Rekomandime për përmirësim

- i. Bizneset duhet të përmirësojnë zinxhirin e tyre me produkte dhe shërbime që kërkojnë më shumë njohuri dhe investime në teknologji por që në të njëjtën kohë kanë marzhe më të larta fitimi dhe sigurojnë kushte më të mira pune.
- ii. Ka nevojë për projekte specifike të dedikuara mbështetjes, zhvillimit dhe nxitjes së ndërveprimit dhe rrjetëzimit për bizneset.
- iii. Të hapen depo për perpunimin e patates, baxho dhe pika grumbullimi për prodhimet blegtorale
- iv. Shfrytëzimi i sipërfaqeve të pasura me bime medicinale dhe aromatike duhet të bëhet i studiuar e me kriter, me qëllim riciklimin e qëndrueshëm të saj¹⁴.

Punësimi¹⁵

Rajoni I Kukësit ka një popullsi relativisht të re. Moshë 15-64 vjeç, kategori e cila përfaqëson dhe popullsinë në moshe pune është 46% e totalit. Megjithatë kjo shifër mbetet e ulët në krahasim me të njëjtin tregues në nivel kombëtar (67%¹⁶). Me shumë se gjysma e popullsisë në moshe pune (66.3%) jetojnë në zonat rurale të qarkut. Popullsia ekonomisht aktive¹⁷ është 19.341 (ose 17 % e popullsisë totale). Ajo ka rënë me 17% që nga viti 2006. Kjo forcë pune është e përqendruar në bashkitë e qarkut më shumë sesa në komuna¹⁸. Në 2010 struktura e punësimit në rajon tregon se 19% e personave të regjistruar janë të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor kurse 31% në sektorin privat bujqësor. Pjesa tjetër(51%) janë të punësuar në sektorin shtetëror. Biznesi i madh që operon në sektorin privat jo bujqësor punëson 14% të totalit të të punësuarve në rajon kurse biznesi i vogël i të njëjtit sektor punëson 4% të totalit. Në vitin 2011 është hartuar një Pakt Territorial Punësimi¹⁹ për qarkun e Kukësit i cili nëpërmjet ndërhyrjeve të parashikuara, të tilla si; shërbime këshillimore për sipërmarrjen dhe biznesin, trajnime dhe financim të trajnimeve, asistencë për akses në kredimarrje , punësimi të subvencionuar ka patur si qëllim krijimin dhe formalizimin e vendeve të punës në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së rajonit. Parashikimi i produktit të këtij Pakti ka qenë krijimi i 440 vendeve të reja të

¹⁴ Në vitin '1987 nga Ndermarrja Shërbimit Pyjor është bërë një studim për bimët mjekësore. Ose nga ajo kohë kanë ndodhur ndryshime të mëdha të mjedisit natyror dhe të fondit të pyjeve e për rrjedhojë është e domosdoshme të bëhet një rivelesim i situatës nëpërmjet një studimi të thelluar.

¹⁵ Të dhënat e paraqitura për punësimin janë shifrat e regjistruara në zyrat e punës në rajon. Ato jo domosdoshmërisht përfaqësojnë gjendjen reale të punësimit. Një kufizim tjetër i të dhënave të punësimit është se popullsia që jeton në zonat rurale, konsiderohet e tëra si e punësuar (e lidhur me tokën), meqenëse çdo familje disponon nga një sipërfaqe të caktuar tokë.

¹⁶ Sipas INSTAT, 2009

¹⁷ Forcat e punës përcaktohen si shumë e e numrit të personave të punësuar me numrin e personave të papunë

¹⁸ Kjo dhe për arsye se pjesa më e madhe e popullsisë në komuna nuk është e regjistruar nëpër zyrat e punës.

¹⁹ PTP është një bashkëpunim i Qeverisë Shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Ai është financuar nga Qeveria Spanjolle nëpërmjet Fondit për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe është hartuar me asistencën teknike të ILO-s.

punës. Realisht janë dhënë deri tani 12 grante në të gjithë sektorët dhe numri i vendeve të reja të punës të krijuara ka qenë 19

Papunësia²⁰

Të papunë të regjistruar në rajon janë 9,359 për vitin 2010. Ato përfaqësojnë 48% të forcave të punës. Megjithatë kjo është papunësi e zonave urbane në përgjithësi. Në komuna njerëzit konsiderohen të gjithë si të vetë-punësuar në tokat e tyre, cka do të thotë se papunësia e fshehur në bujqësi mbetet problem.

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <p>Për sa l përket treguesve të punësimit dhe papunësisë, rajoni mbetet relativisht l prapambetur, krahasuar me nivelet kombëtare.</p> <ol style="list-style-type: none"> Popullsia në moshë pune e rajonit është sa 68% e mesatares së vendit Forcat e punës si raport e popullsisë totale (17%) ne rajon janë sa gjysma (51%) e të njëjtit tregues në shkallë kombëtare Shkalla e punësimit në Kukës është sa 45% shkallës së punësimit në vend Pjesa që zë punësimi në sektorin privat jo-bujqësor mbi totalin e punësimit rajonal (19%) është sa 69% e mestares kombëtare (27%) Shkalla e papunësisë²¹ sërajonit është 48% dhe e kalon mestaren e vendit (13.5 %) me 3.5 herë për vitin 2010. Norma e pjesëmarrjes²² së qarkut është sa gjysma 75% e të njëjtit tregues në nivel kombëtar
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Popullsia ne moshe pune eshte ne te njetat nivele (rreth 45% e totalit) pothuajse ne te gjitha njesite e rajonit Pjesa dërrmuese e polullsisë për shkak edhe të mundësive të kufizuara në sektorin privat dhe të shërbimeve, merret me bujqësi ose është e punësuar në sektorin shtetëror. Në të 23 komunat e qarkut popullsia banuese është shumë e varur nga sektori bujqësor. Në 20 nga 27 njësitë e rajonit mbi 60% e banorëve merren me bujqësi. Pjesa më e madhe e të regjistruarve si të punësuar jetojnë në zonat urbane (90%) Norma e punësimit është nën mesataren e rajonit ne 24 nga 27 njesite në Qark
<p>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</p> <ol style="list-style-type: none"> Një pjesë e madhe e personave nuk regjistrohen në zyrat e punës si të papunë. Kjo ndodh për arsye të ndryshme; ata nuk kanë më besim se mund të gjejnë një punë; jetojnë me të ardhura që i vijnë nga emigracioni ose një arsye tjetër është frika e humbjes së ndihmës ekonomike apo përfitimeve të tjera. Ka persona në komuna të cilë kanë tokë por nuk e punojnë atë dhe jetojnë në qytet. Këto persona nuk përfitojnë as nga statusi i papunësisë. Ka patur disa iniciativa nga projekte të ndryshme për të stimuluar bujqësinë dhe blegtorinë por ato kanë rezultuar të pasuksesshme si pasojë e mos sigurimit të personave apo veprimeve të ndryshme abuzive në lidhje me këtë dukuri.
<p><i>Rekomandime për përmirësim</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Duhet të rritet punësimi në sektorin privat jo-bujqësor sidomos ne sektoret prioritare per rajonin sic është turizmi apo sektorë të tjerë lidhur me të (psh artizanati) Zbatimi i mëtejshëm i paktit territorial te punesimit nepermjet asistences se biznesit, incentiveve financiare dhe zhvillimit te burimeve njerezore me qëllim krijimin e vendeve te reja te punes ne rajon. Përmirësimi i kushteve të punës në bujqësi dhe stimulimi i iniciativave te parbashkëta mes fermerëve me qëllim përfitimin nga ekonomia e shkallës dhe rritjen e eficences dhe efektivitetit

²⁰ Të dhënat e paraqitura për papunësinë janë shifrat e regjistruara në zyrat e punës në rajon. Ato jo domosdoshmërisht përfaqësojnë gjendjen reale të papunësisë në rajon.

²¹ Shkalla e papunësisë është raporti midis numrit të të papunëve te rregjistruar dhe numrit të popullsisë aktive (forcës së punës).

²² Forcat e punës si përqindje e popullsisë në moshë pune

Konkluzione

Çështjet e mëposhtme kryesore janë të dukshme sa i përket rritjes, konkurrueshmërisë dhe kohezionit ekonomik:

- Ekonomia rajonale, e prekur nga shpopullimi në shkallë të madhe, është zhvilluar në drejtim të shfrytëzimit të mineraleve, ndërtimit dhe sektorit të shërbimeve. Ka ende mundësi të pashfrytëzuara në shumë sektorë, veçanërisht në turizëm, bujqësi dhe bimë medicinale të cilat nuk çenojnë qëndrueshmërinë mjedisore të rajonit. Këto sektorë duhet të mbështeten nëpërmjet një organizimi më të mirë të prodhuesve, shfrytëzimit të tregjeve jashtë rajonit dhe duke u zhvendosur në aktivitete me vlerë të shtuar më të lartë, duke gjeneruar kështu punësim dhe të ardhura. Këta sektorë janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe duhet të zhvillohen në një mënyrë të rrjetëzuar nga operatorët publik dhe privat.
- Sektori privat është i dobët dhe jo dinamik, duke lënë mundësi të vogla për punësim, kryesisht, në bujqësinë tradicionale dhe sektorin publik, të cilat nuk gjenerojnë rritje të qëndrueshme rajonale. Kësaj i shtohet edhe një forcë pune jo shumë e kualifikuar e cila shkakton papunësi më të lartë dhe mundësi të kufizuara sidomos për të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabil. Bujqësia vetëm mund të sigurojë punësim të kufizuar vetëm për familjet rurale, përveç rasti kur ajo mund të modernizohet. Pasiviteti i lartë ekonomik i popullsisë është i dukshëm veçanërisht te femrat. Përpjekjet e (Ri)kualifikimit dhe promovimit të sipërmarrjes duhet të rriten në masë të madhe. Është e nevojshme infrastruktura mbështetëse ndaj biznesit

Kohezioni Social

Rajoni i Kukësit njihet si një nga katër qarqet më të varfër²³ në vend. Në vitin 2010, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike²⁴ është 1027 familje për 10.000 banorë dhe që nga viti 2006 ky tregues ka rënë vetëm me 2.5%. Përgjithësisht numri më i madh i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike jetojnë në zonat rurale (komuna) ku ky tregues është 1.5 herë më i madh se në bashki. Vihet re se familjet që jetojnë në zonat urbane i nënshtrohen mbulimit të plotë të ndihmës ekonomike kurse ato që jetojnë në zonat rurale janë subjekt i llojit të pjesshëm të ndihmës. Këto të fundit trajtohen kryesisht me ndihmë të pjesshme ekonomike, sepse ata konsiderohen si të vetë-punësuar në sektorin e bujqësisë, ndonëse ata përballen me vështirësitë të ndryshme financiare të si psh; të ardhurat e ulëta nga pronat e tyre; sipërfaqe e vogël e tokës bujqësore për frymë; jo-produktivitetin e tokës dhe sistem jo efikas i sistemit të ujitjes dhe kullimit. Fragmentimi i lartë i tokës rrit koston e prodhimit të produkteve bujqësore dhe atyre blegtorale dhe i bëjnë kushtet e jetesës së këto familje edhe më të ashpra. Për vitin 2010, 843 familje në 10,000 banorë përfitojnë ndihmë ekonomike të pjesshme në rajon. Në komuna, nr i familjeve arrin në 1,151 për 10,000 banorë kurse në bashki 251 familje për 10,000 banorë²⁵. Qarku ka edhe një numër të konsiderueshëm personash me aftësi të kufizuar (të verbër, para-tetra-plegjikë, invalidë pune etj) në raport me popullsinë. Numri i personave me aftësi të kufizuar në rajon për vitin 2011 është 4,275 persona ose 5% e popullsisë²⁶. Një tjetër tregues mbi situatën sociale në qark janë edhe shpenzimet që bëhen për konsum. Nga struktura e treguar në figurën më poshtë, më shumë se gjysma e këtyre shpenzimeve në qark shkojnë për konsum ushqimi dhe pijesh jo-alkoolike. Kukësi është një ndër 5 rajonet me tregues të lartë të këtij lloji shpenzimi.


²³ Sipas "Hartës së Ndhmës Shtetërore", vendimi nr 30, datë 8.4.2009 / (Fletore Zyrtare nr. 55 e vitit 2009, faqe 2566) – Përkufizimi si rajon I prapambetur mbështetet mbi indeksimin e 6 treguesve statistikorë. Ky sistem vlerësimi përcakton si rajone thellësisht të prapambetura qarqet Kukës, Shkodër, Dibër dhe Lezhë.

²⁴ Sipas ligjit nr 9355, datë 10.3.2005 për ndihmën dhe shërbimet shoqërore; "Ndhmë ekonomike" është mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë

²⁵ Ndhma ekonomike nuk është një tregues tërësisht përfaqësues dhe i saktë i varfërisë në rajon. Arsye të tilla si; ligji përkatës shumë evaziv, inspektimi jo gjithmonë i rregullt i gjëndjes reale të familjeve e bëjnë këtë tregues të këtu kufizimet e veta. Mungesa e shumë treguesve të tjerë të varfërisë dhe analizave apo studimeve të mirëfillta të gjëndjes sociale në rajon e bëjnë shumë të vështirë paraqitjen e një situatë sociale reale dhe të përditësuar.

²⁶ Llogaritur mbi bazën e rezultateve paraprake të regjistrimit të popullsisë në 2011, <http://www.instat.gov.al/>

Figure 5 Struktura e shpenzimeve te konsumit (2010)



Burimi: INSTAT

Perspektiva e jashtme

- i. Numri I familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike është 3.4 herë më lartë se mesatarja kombëtare
- ii. Nr I familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike në rajon (-2.5%) ka rënë 5.5 herë më ngadalë në raport me rënien në shkallë vendi (-14.1%)
- iii. Të ardhurat mesatare mujore²⁷ janë më të ulëta krahasuar me rajonet e tjera. Respektivisht në zonat urbane dhe rurale ata janë sa 64 dhe 66% e mesatares së vendit.

Perspektiva e brendshme

- i. Numri më lartë i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike u përkasin zonave rurale Vetëm 4 njësi nga 27 janë nën 75% të mesatares rajonale për sa lartë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, 10 njësi janë mbi 125 %. Numri i këtyre familjeve në komuna ka rënë me 3. % kurse në bashki ato janë rritur me 1% që nga viti 2006.
- ii. 18 nga 27 komuna kanë një numër në ulje të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike për 10.000 banorë. Rëniet më të mëdha vihen re në komunat Surroj (-51 %), Bytyc (-26%), Zapod (-19%), Shishtavec dhe Kolsh (-18%). Ndërsa rritjet më të mëdha të këtij treguesi vihen re në komunat; Tropojë Fshat (43%), Bushtrice (28), Fierzë (26), Gjinaj (20) dhe Fajzë 16.

Faktorët që ndikojnë situatën aktuale

- i. Rënie e lehtë e numrit të familjeve nën asistencë sociale gjatë viteve 2007-2009, si rezultat i punësimit në autostradën Durrës-Kukës
- ii. Papunësi e lartë në rajon dhe raport i lartë i popullsisë së vetë-punësuar në sektorin bujqësor i cili karakterizohet nga të ardhura të ulëta për arsye të shumta si; kushtet e vështira natyrore, copëzimi i lartë i tokës bujqësore, mungesa e infrastrukturës së duhur bujqësore etj.
- iii. Shërbimet sociale²⁸ në rajon, shumë të rëndësishme dhe komplementare në përballimin e nevojave sociale të kategorive sociale dhe individëve në nevojë, nuk janë të plota. Ka shumë Organizata jo Qeveritare që nuk janë operative.

²⁷ Të ardhurat nga puna me pagë, nga puna në sektorin privat bujqësor dhe jo-bujqësor, nga emigracioni, pensionet, prona, ndihma ekonomike dhe të ardhura të tjera)

Rekomandime për përmirësim

- i. Të nxitet një klimë e favorshme e biznesit për të krijuar mundësi punësimi në biznesin privat jo-bujqësor, si edhe në sektorin e minierave, energjisë dhe turizmit
- ii. Krijimi i mundësive të punësimit sezonal për të rinjtë në sektorin e turizmit
- iii. Regjistrimi i sakte i pasurisë blektorale e bujqësore të familjeve fshatare dhe zbatimi me korrektesë i bazes ligjore për Ndhimen Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore sipas ligjit 9355 dt 10.03.2005²⁹.
- iv. Institucionet përkatëse, përveç grumbullimit të të dhënave duhet të bëjnë edhe analiza më të thelluara dhe studime mbi situatën sociale, me qëllim identifikimin dhe ndjekjen e rregullt të gjendjes sociale në rajon.
- v. Ngritja e qendrave ditore në rajon të cilat do trajtojnë probleme të moshës së tretë, të rinjeve, grave dhe familjeve me probleme sociale, ngritja e një shtepie për të moshuar të braktisur ose të vetmuar në qendër të Qarkut Kukës, krijimi i programeve për trajnimin e femijeve me aftësi të kufizuara në të gjithë fazat e zhvillimit, sipas grup-moshave, ngritje kapacitetesh dhe trajnime kualifikuese për ceshtjet që u takojnë personave me aftësi të kufizuara.

Shëndeti

Të dhënat mbi vdekshmërinë foshnjore tregojnë se ka përmirësime në këtë indikator përgjatë viteve 2006-2010. Treguesi i vdekshmërisë foshnjore³⁰ për 1000 lindje është 4.4 në 2010 dhe ka rënë me 67%. Vdekshmëria 1-5 vjeç (për 1000 lindje të gjalla) në rrethet Kukës dhe Tropojë është 1.6%. Në 2010 pati 14 vdekje nga 901 lindje të gjalla. Në 2010 objektet shëndetësore në rajon përfshijnë 3 spitale, 27 Qendra Shëndetësore, 165 ambulanca. Numri i shtretërve në spitale nuk ka ndryshuar pothuajse fare në që nga viti 2006. Edhe në vitin 2010 ai mbetet 24 shtretër për 10.000 banorë. Numri i qendrave shëndetësore për 10.000 banorë është 2.3 dhe nuk ka ndryshuar që nga 2006, kurse numri i ambulancave është 13.3 për 10.000 banorë për periudhën 2006-2010. Në 2010 ka 33 shtretër për 10.000 banorë në rajon, 12% më shumë se në 2006. Sipas të dhënave të fundit të Drejtorisë së Shëndetit Publik në rajon numri mjekëve në rajon është 43 mjekë dhe ai i infermiereve 336. Raporti është 0.4 mjekë për 1000 banorë në rajon. Në përgjithësi, mund të thuhet se shërbimi shëndetësor është përmirësuar. Shërbimi ambulator është rritur në zonat rurale me qëllim ofrimin e një shërbimi parësor shëndetësor më të mirë dhe më të shpejtë popullatës rurale. Çdo fshat ka një ambulance dhe çdo komunë ka një qendër shëndetësore. Gjithashtu, një ndikim pozitiv që qendrat shëndetësore kanë pasur janë edhe fushatat sensibilizuese që janë nisur nga to. Megjithatë, për shkak të infrastrukturës së dobët dhe distancave të largëta nga spitalet që ndodhen në zonat urbane, transporti në kohë i pacientëve drejt tyre mbetet një sfidë. Për sa i përket strukturës së vdekjeve në 2010 në rajon, të dhënat e shëndetit publik në Kukës dhe Tropojë³¹ tregojnë se sëmundjet që shkaktojnë numrin më të madh të këtyre vdekjeve janë: sëmundjet pulmonare (cor pulmonare), infarkt akut dhe koma cerebrale.

Perspektiva e jashtme

²⁸ Shërbimet e kujdesit social japin mbështetje për individët në nevojë (të moshuarit e vetmuar/braktisur, fëmijet jetimë (sociale dhe biologjike) fëmijet me zhvillim të vonuar, fëmijet dhe femrat viktime të trafikimit etj.)

²⁹ Shiko kreu IV neni 19,20,31 si dhe udhëzimit 338/3 dt 10.03.2006 kreu II pika 5, kreu XI pika 11, kreu II pika 2, kreu II pika 4.

³⁰ Drejtoria e Shëndetit Publik deklaroi se këto vdekje janë për lindje premature që do të thote vdekje gjatë lindjes jo pas lindjes

³¹ Të dhënat për Hasin nuk janë vënë në dispozicion

<ul style="list-style-type: none"> i. Numri i shtretërve në spitale të rajonit është sa 88% e mesatares kombëtare ii. Vdekshmëria foshnjore në rajon është 69% e mesatares së vendit (6.4 vdekje për 1000 lindje të gjalla). iii. Numri i ambulancave për 10.000 banorë është sa 123 e niveit kombëtar
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Ka ulje drastike të vdekjeve foshnjore për 1000 lindje të gjalla në rajon. Treguesi ka rënë me 67% për periudhën 2006-2010. ii. Nr i vdekjeve nën 5 vjeç mbetet shumë i lartë në rajon dhe është rritur me 23% që nga 2006. iii. Transporti drejt spitaleve mbetet një problem i madh sidomos për zonat rurale të rajonit iv. Në 15 njësi (më shumë se gjysma e njesive në rajon), nr i ambulancave dhe QSH për 10.000 banorë e tejkalon 125% të mesatares rajonale. v. Mjekëvt e përgjithshëm janë të shpërndarë në mënyrë disi më të barabartë në rajon. Vetëm 9 nga 27 njësitë i tejkalojnë kufijtë limitë³² të mesatares së rajonit vi. Në Tropojë mungojnë mjekë specialistë peditër, reumatolog, kardiolog. vii. Në Kukës dhe Has ka 8 mjekë më pak se c' duhet të jenë nga organika normale.
<p><i>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Akses më i lehtë dhe i shpejtë i popullsisë urbane në objektet shëndetësore por vështirësi për popullsinë rurale për të mbërritur në spitale për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore. ii. Shpërndarje e mirë e shërbimit shëndetësor parësor në të gjithë rajonin iii. Niveli i ulët ekonomik dhe shkalla e lartë e varfërisë iv. Ndërgjegjësim i pamjaftueshëm i popullsisë për të parandaluar sëmundjet v. Mungesa e specialitetëve në spitalet e Qarkut është e evidente. Për një pjesë të madhe të sëmundjeve banorët duhet ti drejtohen Tiranës. vi. Ka mungesë ekspertësh në sektorë të tilla si Shëndeti Publik, Manaxhimi Shëndetësor, Planifikimi Shëndetësor, Ekonomi Shëndetësore.
<p><i>Rekomandime për përmirësim</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Përmirësimi i mëtejshëm i kujdesit shëndetësor parësor si në zonat urbane edhe ato rurale ii. Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimeve spitalore në specialitetet të ndryshme dhe përdorimi i teknologjive të azoruara në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve iii. Përmirësimi i infrastrukturës në zonat rurale iv. Aktivitete efikase dhe të vazhdueshme ndërgjegjësimi për përkujdesin ndaj shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. v. Institucionet shëndetësore publike dhe private në rajon duhet ti nënshtrohen procesit të detyrueshëm të akreditimit. vi. Një nga degët e arsimit profesional në rajon duhet të jetë edhe ajo e infermierisë

Edukimi

Shkollat fillore janë të pranishme në cdo njësi të rajonit ndërkohe që gjimnazet janë të shpërndara në 17 nga 27 njësitë e qarkut. Në arsimin fillor ka 18.5 nxënës për një mësues, tregues ky i rritur me 7.4% nga 2006. Në bashki numri i nxënësve për një mësues është 1.2 herë më i lartë se në komuna. Madhësia mesatare e një klase në arsimin fillor është 20.3 nxënës (26.8 në bashki dhe 17.9 në komuna). Madhësia e klasës në arsimin fillor ka rënë me 3.9 % për periudhën 2006-2010. Në arsimin e mesëm numri i nxënësve për një mësues është 26.4 dhe është rritur me 11.6% në katër vite. Ndërsa madhësia mesatare e një klase është 37.6 studentë dhe është rritur me gati 14% nga 2006. Fenomeni i braktisjes në shkolla mbetet prezent në rajon. Megjithatë shifrat janë në rënie me kalimin e viteve, për vitin shkollor 2010-2011, 123 nxënës kanë braktisur shkollën, 84 nga të cilët janë femra. 70 % e atyre që braktisin shkollën janë midis moshës 12-15 vjeç. Megjithatë vihet re një numër shumë i madh që e kanë braktisur shkollën që në klasën e parë. Fenomeni i klasave të kombinuara është gjithashtu shqetësues për rajonin, Viti shkollor 2010-2011, shënon 147 klase të kombinuara (ose 2,223 nxënës që ndjekin mesimin në këto klase). 66% e klasave të kombinuara i takojnë ciklit të ulët (klasa 1-5). Duke filluar nga viti 2008, Universiteti i Tiranës ka hapur degën e saj në Kukës. Ka tre fakultete dhe numri i nxënësve të

³² Statistikisht vlera limite janë konsideruar më pak se 75% ose më shumë se 125% e mesatareve përkatëse

regjistruar në nivelin e lartë të arsimit është rritur me 75 për qind - nga 240 studentë në vitin 2008 në 420 në vitin 2010, ndërsa 680 në vitin 2011. Arsimi profesional që ekziston në Kukës behet 2 vjet në Kukës dhe 2 vite të tjera në Shkodër kjo për mungesë të stafit mesimdhënës. Ka një shkollë profesionale në rajon e cila ka degët; mekanikë, elektrike dhe përpunim druri (47 meshkuj të regjistruar); dhe Ekonomi e Manaxhim Zyre (28 femra të regjistruara). Në arsimin profesional ka më shumë të regjistruar nga komunat sesa nga bashkitë. Para 3 vitesh GIZ ka bërë një studim dhe ka investuar në hapjen e dy degëve të reja. Ndërkohë edhe Qeveria Shqiptare ka hapur në 2011 një degë të re të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <p>i. Numri i nxenesve është gjithnjë e në zbritje kjo për arsye të levizjes së banorëve në drejtim të Tiranës dhe jashtë vendit</p> <p>ii. Arsimi profesional për 2 vite ndiqer në Shkodër mqs rajoni nuk ka kapacitetet të mjaftueshme</p>
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <p>i. Raporti i nxënësve për një mësues dhe madhësia mesatare e një klase në arsimin e mesëm është më e ulët se 75% e shifrës rajonale në më shumë se 70% të njësive të rajonit</p> <p>ii. Rritjet më të larta të nxënësve për një mësues kanë ndodhur në Komunën Golaj (24.8%) dhe Bashkinë Kukës (19.7%) kurse rritjet më të larta të madhësisë së klasave në gjimnaz janë shënuar në Topojan (26.9%), bashkia Kukës (22.6%) dhe Komunat Zapod (15.2%) e Shishtavec (15.5%). Ndërkohë në Komunat Malzi, Lekbibaj, Fierzë, Bytyc, Llugaj e Tërthorë këta tregues kanë rënë me më shumë se 20%</p> <p>iii. Treguesit më sipër për arsimin fillor, kanë patur një rënie në 17 nga 27 njësive të rajonit, më saktësisht në zonat Kukës dhe Bajram Curri. Sidomos komunat e B.Currit (Bytyc, Bujan dhe Llugaj) kanë rënie që kalojnë 20%. Edhe Bashkia Kukës dhe komuna Topojan karakterizohen nga rënie të theksuara në këto tregues. Përkundrazi rritje të konsiderueshme vihen re në komunat Margegaj, Kolsh dhe Kalise.</p>
<p><i>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</i></p> <p>i. Në pjesën dërrmuese të komunave nuk ka një raport të mirë (apo një shpërndarje të përpjeshtme) ndërmjet popullatës që banon aty dhe objekteve të edukimit</p> <p>ii. Numri i studentëve është në rënie për shkak të emigracionit të lartë nga zonat rurale në ato urbane dhe nga brenda qarkut jashtë tij, drejt rajoneve të tjera</p> <p>iii. Fenomeni i klasave të kombinuara vazhdon të mbetet një problem shqetësues për rajonin dhe që ndikon në mënyrë seriozë cilësinë e nxënies në shkollë.</p>
<p><i>Rekomandime për përmirësim</i></p> <p>iv. Nepermjet përqendrimit të shkollave dhe rishpërndarjes së mësuesve mund të eliminohet dukuria e shpërndarjes jo efektive të studentëve nëpër shkollat e rajonit. Si rrjedhojë edhe madhësia e klasave dhe raporti nxenes/mësues do të jenë më uniforme.</p> <p>v. Universitetet kanë nevojë të pasurojnë dhe përshtasin kurrikulat e tyre në përputhje me tregun e punës</p> <p>vi. Të investohet dhe të promovohet më tepër në arsimin profesional, përmirësimin e kapaciteteve të arsimit profesional, hapjen e degëve të reja dhe përshtatjen e vazhdueshme të tyre me kërkesat e tregut të punës.</p>

Konkluzione

Sa i përket çështjeve sociale, shëndetit dhe edukimit vëzhgimet si më poshtë tregojnë se:

- Rajoni ka nevojë emergjente për ngritjen e një sistemi cilësor shërbimesh dhe nderhyrjesh sa më pranë komunitetit për të punuar në mënyrë më efektive për; reduktimin e varferisë dhe riintegrimin në jetën social-ekonomike të vendit të kategorive në rrezik. Ofruesit e shërbimeve sociale (ofrues publik, privat ose OJF- te.) duhet të licencohen dhe të ofrojnë shërbime të standardeve të larta.
- Sa i përket gjendjes shëndetësore të rajonit në fokus është përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit nëpërmjet; ndërgjegjësimit për përkujdesin ndaj shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve; rritjes së cilësisë së shërbimeve parësore dhe spitalore dhe infrastrukturave

- Në edukim ka nevojë për një ri-perqendrim te shkollave në funksion të një shpërndarjeje më eficente të studentëve dhe mësuesve. Arsimi profesional ka nevojë për më tepër investim, promovim përmirësim të kapaciteteve dhe hapjen e degëve të reja të përshtatura në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës.

1.4 Mjedisi, Aksesi në Infrastrukturë dhe Shërbime

Mjedisi

Lumenjtë/Liqenet³³ dhe cilësia e ujrave sipërfaqësor. Qarku i Kukësit është shumë i pasur në mjedise ujore dhe burime hidrike. Ajo që e bën të veçantë janë grumbullimi i të gjitha rrjedhave dhe lumenjve që derdhen në Lumin Drin, që nga Liqenet e Prespës dhe Pogradecit, Bjeshkët e Namuna e deri tek bashkimi i Lumit Drin me Lumin Buna. Lumenjte kanë shpejtësi të madhe, 0.8 -3.14 m në sek. Në më pak pak se 30 - 40 km gjatësi përrrenjte janë në gjendje të zbresin nga lartësitë 1500 – 2000 m mbi nivelin e detit në kuotën e Liqenit të Fierzës 300 metër mbi nivelin e detit. Ky disnivel i bën ato të rrëmbyer, gërryes, transformues luginash.. Me ndërtimin e pritave, digave dhe kanaleve hidrike po i jepet fund njëherë e përgjithmonë edhe erozionit dhe shembjeve massive të dherave.Ka mbi 30 ujmbledhës të shpërndarë në rajon të cilët përdoren për vaditjen e mijërave hektarë tokë dhe gjithashtu ato janë edhe burim të ardhurash edhe me përdorimin e pishikulturës. Liqeni i Fierzës është qendra e të gjitha rrjedhave dhe mjediseve ujore. Perreth brigjeve të tij jeton një komunitet prej rreth 8000 familjesh që i kanë të lidhura interesat e tyre direkt me ujrën e Liqenit. Ai është shumë i përshtatshëm për rritjen e peshve të llojeve të ndryshme. Megjithatë, si ujmbledhësi kryesor i të gjitha ujrave rrjedhëse ky liqen përballet më shumë se të gjithë me ndotjet mjedisore. Ndotjet kanë natyrë urbane. Ato janë ndotje dentritesh organike dhe shplarja e tokave agrare. Kjo sjell përveç mbeturinave lundruese plastike, edhe një ndotje kimike të ujrave me sasira të konsiderueshme të azotit dhe fosforit.Ujrat e lumit Drin cilësohen si ujra të cilësisë së mirë për nga përmbajtja e oksigjenit të tretur në to e cila është brenda intervalit 8.5-9.91 mg l O₂ dhe për nga përmbajtja e fosfateve (0.007-0.011 mg/l P). Vetëm për pjesën e lumit (stacioni Bahcallek) që është nën ndikimin e shkarkimeve urbane të qytetit të Shkodrës cilësia është e keqe sepse vlera e nitrateve në ujë është e lartë. Ndërkohë në stacionin tjetër të matur të Drinit (Topojan) ato bien në vlera mesatare³⁴.Pasuritë ujore të rajonit përdoren edhe si burime energjie. Në liqenin e Fierzës është ndërtuar diga e Hidrocentralit të Fierzës mbi lumin Drin. Ky hidrocentral shërben si rregullator i furnizimit me ujë për dy hidrocentralet e ngritura në kaskadën e Drinit, atë të Vaut të Dejës dhe Komanit. Liqeni i Komanit ka të zhvilluar edhe transportin e brendshëm ujor për pasagjerë e mallra³⁵.

Mbetjet Urbane - Rajoni gjeneron 0.13 ton mbeturina (urbane dhe inerte) për banor në 2010. Ky tregues është rritur me 18% që nga viti 2006.Sasia totale mbetjeve urbane në rajon është 9,270³⁶ ton për vitin 2010, më e ulëta e gjeneruar në vend. Edhe sasia e mbetjeve inerte që vijnë nga aktiviteti ndërtues në rajon është edhe ai një ndër më të ulët në vend, 5900 ton për vitin 2010. Struktura e mbetjeve për 2010 është 61% urbane dhe 39% inerte. Sistemi i mbledhjes së mbeturinave në qytete është jo i mirë ndërsa në komuna pothuajse mungon fare. Vetëm në Bashkinë Bajram Curri ka një vendgrumbullim për hedhjen e mbeturinave. Për sa i përket mbetjeve spitalore është zgjidhur problemi i tyre. Tre spitalet e rajonit kanë lidhur një kontratë me një shoqëri private e cila bën transportimin dhe largimin e mbetjeve spitalore.

³³ Lumenjte e Kukësit janë; Drini i Bardhë, Drini i Zi, Lumi i Tërshenës, Lumi i Lumës (degë e Drinit të Bardhë në JL të Kukësit) Lumi i Bushtricës, lumenjtë Valbonë, Tropojë, Gashi dhe lumi i Krumës

³⁴ Raport për Gjendjen e Mjedisit 2009, (2010), Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

³⁵ Transporti i brendshëm në ujrën e liqenit të Fierzës, nga nentori i viti të kaluar nuk funksionon, transporti i mallrave dhe pasagjerëve kryhet në rrugë tokësore

³⁶ Burimi : Agjensia Rajonale e Mjedisit, Kukës

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Mbetjet urbane për banor të gjeneruara në rajon janë sa 57% e mesatares kombëtare ii. Volumi i mbetjeve inerte përbën vetëm 1.2 % të shifrës totale të vendit
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Bashkia Kukës ka treguesin më të lartë të mbetjeve urbane për banor në vit (0.35 ton) si njësi më e populluar dhe e urbanizuar e rajonit. Në shumicën e komunave kjo matje mungon ii. Cilësia e ujrave të lumit Drin konsiderohet si mesatare kurse ajo e ujërave të liqenit të Fierzës përballet me probleme të ndryshme mjedisore. Megjithatë nuk ka një sudim të mirëfilltë mbi gjendjen e ujërave të këtij të fundit iii. Shtrati i Lumit Luma përdoret për nxjerrjen e materialeve ndërtimore.
<p><i>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Burimet e ndotjes së ujrave në rajon janë³⁷; depozitimi i mbetjeve urbane në brigjet e liqeneve dhe lumenjve, ujërat e zeza që derdhen në liqene, aktiviteti industrial dhe uji i minierave, aktiviteti bujqësor, derdhja e vajrave/ karburanteve nga tregtia, erozioni, përdorimi i lëndëve plasëse për gjuetinë e peshkut ii. Cilësia e ujërave rrjedhës monitorohet vetëm në hyrje dhe dalje dhe rezultatet jo domosdoshmerisht përfaqesojnë gjendjen reale gjatë gjithë gjatësisë së lumit, ndërsa monitorimet e sipërfaqes së ujit të liqenit të Fierzës mungojnë plotësisht. iii. Megjithatë, organizimi më i mirë rajonal, marrëveshjet ndërkuftare dhe mbi të gjitha sensibilizimi komunal dhe familjar i popullatës ka kontribuar në përmirësimin e situatës. iv. v. Sasia e vogël e mbetjeve urbane të gjeneruara lidhet me numrin e vogël të popullsisë në rajon dhe shkallën e zhvillimit ekonomik vi. Administrim i dobët i mbeturinave në rajon, pa ndarje dhe pa trajtim. Sistemi i mbledhjes së mbeturinave në qytete është jo i mirë ndërsa në komuna pothuajse mungon. vii. Mungon një sistem për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve viii. Mbetjet që gjenerohen (nga banorët apo edhe nga aktiviteti industrial e ndërtues) depozitohen në vende depozitime të rastësishme duke paraqitur rrezik për mjedisin dhe shëndetin
<p><i>Rekomandime për përmirësim</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Ka nevojë të hartohet një Plan Rajonal i Menaxhimit të Mbeturinave dhe plane lokale në bazë të planifikimit me pjesëmarrëse. ii. Nevojë emergjente për të kaluar nga grumbullimi i mbetjeve në menaxhimin e integruar të tyre iii. Krijimi i strukturave administrative në nivel rajonal dhe lokal për forcimin e mëtejshëm të administrimit të mbetjeve iv. Zvogëlimi dhe parandalimi i mbetjeve të krijuara nëpërmjet riciklimit dhe incenerimit v. Ndërtime të vende depozitimeve në përputhje me standartet mjedisore vi. Ndërgjegjesim i publikut për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe ndarjen e grumbullimit selektiv të mbetjeve urbane, shoqëruar kjo me nisma vullnetare për pastrimin e mbeturinave vii. Duhet të bëhet trajtim i ujërave urbane nëpërmjet impianteve të pastrimit, përpara shkarkimit në ujrat pritës sipërfaqësorë. viii. Duhet të merren masa për ndalimin e aktiviteteve të tilla të jashtëligjshme si: shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve për materiale ndërtimi; përdorimi i lëndëve plasëse për gjuetinë e peshkut; ndotja e shkaktuar nga aktiviteti industrial, bujqësor dhe tregtar (derdhja e vajrave karburanteve)

Aksesi në Infrastrukturë dhe Shërbime

Aksesi i rajonit në infrastrukturën rrugore dhe lidhja me pjesën tjetër të vendit sidomos kryeqytetin, aeroportin dhe portet është përmirësuar së tepërmi sidomos pas investimit në rrugën Durrës-Kukës-Morinë gjatë 2007-2010 (koha e udhëtimit është shkurtuar me 240 minuta). Lidhja me Tiranën bëhet nëpërmjet rrugës nacionale Kukës – Tiranë, me gjatësi 144 km dhe përkohet për 120 minuta. Me aeroportin e Rinasit rajoni lidhet me rrugën nacionale Kukës – Vore – Rinas, me gjatësi 124 km e cila përkohet për 90 minuta. Distanca e rajonit nga portet kryesore të vendit, Durrës dhe Vlorë janë

³⁷ Analiza në Qarkun e Kukësit, Studim Vlerësues për PTAOK

përkatësisht 160 km (135 min) dhe 291 km (300 min). Qarku ka akses në dy pika doganore; atë të Morinit nëpërmjet rrugës nacionale Kukës – Morin, me gjatësi 20.5 km dhe distancë kohore 20 minuta; dhe doganën Qafe Prush – rruga nacionale Kukës – Krume – Qafe Prush, me gjatësi 55 km e cila përkohet për 90 minuta. Rajoni është 99 minuta larg Pukës (qarku Shkodër), 50 minuta nga Rrësheni (Qarku Lezhë) dhe 150 minuta nga Peshkopia (Qarku Dibër). Në inventarin e rrugëve, në 2010, rajoni ka 309.97 km rrugë kombëtare, 251.5 km rrugë rurale rajonale dhe 506.8 km rrugë lokale (rurale komunale). Sidoqoftë në terma aksesi dhe lidhjeje me pika të tjera, pengesë kryesore për rajonin mbetet pozicioni gjeografik dhe terreni malor dhe kjo impakton në mënyrë të drejtpërdrejtë lëvizjet e popullsisë dhe aktivitetit ekonomik në rajon. Rrjeti i brendshëm rrugor vazhdon të ketë probleme. Megjithatë nga ana tjetër janë bërë disa investime në këtë rrjet për rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugëve si Kukës-Krume Kukës-Ujmisht, Kukës-Zapod, Kukës-Bushtricë, Krumë-Kam . Koha e udhëtimit në këto rrugë është reduktuar me më shumë se 20 minuta. Rajoni, falë autostradës që e lidh me pikat kyce të vendit është tashmë më i hapur për perspektiva të reja zhvillimi biznesi apo investime të ndryshme. Aksesi më i lehtë dhe infrastruktura e përmirësuar ka influencuar dhe rritur përdorimin vetjak/personal të makinave. Ai është rritur me 37 % që nga 2006, nga 17 makina për banor në 24. Aksesi në ujën e pijshëm është i mundur për 86 % të popullatës së rajonit në 2010. Në bashki e gjithë popullsia ka akses në rrjetin e ujit të pijshëm. Situata e mirë paraqitet në edhe në pjesën më të madhe të komunave. Gjendja është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme që nga 2006 kur popullsia nuk kishte fare akses për Komunitat Ujmisht, Tërthorë, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Surroj, Arren, Kalisë, Grykë Cajë, Gjinaj, dhe të gjithë komunat e Bajram Currit. Investime janë kryer dhe në Malzi, Kolsh, Golaj dhe Fajza. Komunitat më problematike në këtë aspekt janë Golaj ku vetëm 35% e popullsisë ka akses, Komunitat Bytyc dhe Lekbibaj (41%), Fajza (45%), Tropojë Fshat (52%) dhe Margegaj (64%). Për sa i përket aksesit në ujrat e zeza situata është më e vështirë. Përveç bashkive të vendit që kanë 100% akses dhe komunave Bicaj (66%), Shishtavec (60%), Fierzë (61%) dhe Shtiqen (11%) në asnjë nga komunat e tjera nuk ka akses në këtë sistem.

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Investimet në infrastrukturë në rrjetin kombëtar rrugor (Autostrada Durrës-Kukës-Morinë) kanë lehtësuar së tepërmi lidhjen e rajonit me pjesën tjetër të vendit (kryeqyteti mund të arrihet 2 orëve) dhe me Kosovën gjithashtu. ii. Rrjeti i brendshëm rrugor i rajonit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme
<p><i>Perspektiva e brendshme</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Përmirësimi i infrastrukturës në disa rrugë të rëndësishme (Kukës-Krume Kukës-Ujmisht, Kukës-Zapod, Kukës-Bushtricë, Kukës Bytyc , Kukës-Shishatvec, Kukës-Peshkopi, B.Curri-Margegaj, Kam-Golaj, Sheshi iTrageteve-Lekbibaj) ii. Është përmirësuar infrastruktura rrugore e pikave kryesore doganore me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë iii. 6 komuna me nje popullsi prej 24.945 banorë në rajon kanë nevojë për përmirësim të aksesit në sistemin e ujit të pijshëm iv. Nga 24 komuna, në 21 prej tyre popullsia nuk ka akses në ujrat e zeza v. Në bashki e gjithë popullsia ka akses në të dy rrjetet të ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza
<p><i>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Rajoni ka terrene malore dhe të vështira për tu arritur ii. Investimet e qeverisë në rrjetin kombëtar rrugor (autostrada Durrës-Kukës-Morinë) iii. Projektet rrugore rurale të financuara nga Banka Botërore, Banka Islamike dhe zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit
<p><i>Rekomandime për përmirësim</i></p> <ul style="list-style-type: none"> i. Duhet bërë prioritizim investimesh në infrastrukturën rurale sidomos për zonat e largëta me burime potenciale për turizëm ii. Ka nevojë për planifikim në nivel rajonal për infrastrukturën e KUZ iii. Duhet bërë Investime të mëtejshme në rrjetin e ujësjellës kanalizime në mënyrë që e gjithë popullsia të ketë akses në këto rrjete.

Konkluzione

Vihen re çështjet e mëposhtëme kyçe në lidhje me mjedisin dhe aksesin në Infrastrukturë dhe shërbime:

- Situata e mjedisit, si pasojë e një përqendrimi më të kufizuar të popullsisë, duket më pak problematike se në pjesët e tjera të Shqipërisë, por ende kërkon përpjekje të mëtejshme dhe ngritjen e vetëdijes, ngritjen e sistemeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave dhe investime të mëdha në infrastrukturë përkatëse.
- Pavarësisht investimeve infrastrukturore të bëra së fundmi dhe që e kanë përmirësuar dukshëm aksesin e rajonit me pjesën tjetër të vendit, zonat rurale dhe të tjerëlla të rajonit kanë akoma infrastrukturë të dobët dhe akses të ulët.
- Investimet infrastrukturore në rrugë dhe ujësjellës kanalizime duhet të prioritarizohen sipas kritereve lidhur me popullsinë dhe përqëndrimin e aktivitetit ekonomik në rajon

1.5 Financat lokale dhe eksperiencia me projektet e zhvillimit

Local finances

Të ardhurat e qarkut përbëhen nga burimet e veta të financimit dhe burime të tjera të shpërndara nga niveli kombëtar. Të hyrat nga burimet vetjake janë;

- Transferta pakushtëzuar, duke përfshirë edhe kuotat e anëtarësimit të komunave dhe bashkive. Këto përdoren për ushtrimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta me njësitë e qeverisjes vendore
- Transfertat e kushtëzuara, që shërbejnë për kryerjen e funksioneve dhe kompetencave të deleguara nga komunat dhe bashkitë. Këto përdoren vetëm për qëllimin për të cilin ato jepen në përputhje me rregullat e vendosura nga qeveria qendrore
- Taksat dhe detyrimet e përcaktuara në nivel qarku
- Tarifat për shërbimet publike të ofruara nga qarku

E ardhura e vet totale e qarkut Kukës, e gjeneruar si një entitet të veçantë nga taksat dhe tarifat në vitin 2010, është 8,9 mln lekë. Këto janë të ardhura kryesisht nga tarifat për shërbimet e ofruara (68%) dhe pjesa tjetër nga taksat. Krahasuar me të ardhurat e veta të gjeneruara nga secila NJQV brenda qarkut, kjo shumë është shumë e parëndësishme (rreth 21 herë më e vogël). Të ardhurat e veta për frymë të qarkut janë të papërfillshme; vetëm 81 lekë për banor në vitin 2010, ndërsa të ardhurat e veta që vijnë nga njësitë e qeverisjes vendore (bashki dhe komuna në qark), është 1665 lekë për frymë. Transferta e pakushtëzuar dhënë për Qarkun vetëm është 84 mln lekë ndërsa shuma e dhënë për njësitë e qeverisjes vendore është 495 mln lekë (6 herë më të larta këto të fundit). Një tablo e ngjashme vihet re në lidhje me investimet dhe shpenzimet. Nuk janë kryer investime nga qarku në 2010 ndërsa NJQV-të në qark kanë shpenzuar 209 milion lekë. Pjesa që zënë investimet ndaj totalit të shpenzimeve të përgjithshme është 0 % për qarkun dhe 28 % për NJQV-të përbërëse. Megjithatë, ka pasur ndryshime të mëdha gjatë viteve. Që nga viti 2002 të ardhurat e veta për frymë të NJQV-ve në rajon janë 11 herë më të larta ndërsa investimet dhe shpenzimet janë rritur respektivisht me 120 dhe 121%. Raporti i investimeve mbi shpenzimet është ulur në bashkitë e rajonit (me 58%) dhe është rritur për komunat (me 71%) që nga 2002 .

Tabela 7 Të ardhurat e veta për frymë (2010)

NJQV-të me të ardhura < 75% e mesatares rajonale (1602 ALL për frymë)		NJQV-të me të ardhura midis 75 - 125 % të mesatares rajonale		NJQV-të me të ardhura > 125% e mesatares rajonale	
Komuna Arren	69%	Komuna Lekbibaj	92%	Komuna Fierze	299%
Komuna Kolsh	68%			Bashkia Kukes	211%
Komuna Llugaj	64%			Bashkia Krume	179%
Komuna Bushtrice	55%			Bashkia Bajram-Curri	162%
Komuna Zapod	55%			Komuna Surroj	150%
Komuna Margegaj	54%				
Komuna Terthore	52%				
Komuna Bicaj	47%				
Komuna Shtiqen	42%				
Komuna Golaj	42%				
Komuna Kalis	40%				
Komuna F.Tropoje	38%				
Komuna Mal Zi	37%				
Komuna Fajze	31%				
Komuna Topojan	28%				
Komuna Bujan	22%				
Komuna Ujmisht	21%				
Komuna Gjinaj	18%				
Komuna Shishtavec	12%				
Komuna Bytyç	7%				
Komuna Gryke caje	4%				

Burimi: Ministria e Financave

<p><i>Perspektiva e jashtme</i></p> <p>i. Rajoni i Kukësit mbledh me pak të ardhurat nga taksat dhe tarifatat krahasuar me 11 rajonet e tjera të vendit. Kjo vlen për qarkun dhe për njësitë që e përbëjnë atë gjithashtu.</p>
<p><i>Perspektiva e brëndshme</i></p> <p>i. Ka një variacion të lartë të të ardhurave të veta midis NJQV-ve në rajon. 21 komuna nga 27 njësitë kanë të ardhura të vet nën 75% të mesatares rajonale. Vetëm tri bashkitë dhe komuna Fierzë kanë të ardhurën e vet mbi 125% të mesatares së të rajonit.</p> <p>ii. Transferta e pakushtëzuar midis NJQV-ve në rajon i eliminon disi dallimet, sepse ajo është e bazuar në një formulë e cila e barazon disi gjendjen financiare dhe llogaritet kryesisht mbi shifrat e popullsisë. 20 nga 27 njësitë e qeverisjes vendore e kanë transfertën e pakushtëzuar për frymë mbi 125% të mesatares rajonale.</p>
<p>Faktorët që ndikojnë situatën aktuale</p> <p>i. Aftësia e dobët për të mbledhur taksat në nivel NJQV</p> <p>ii. Administrata e Qarkut mbledh shumë pak taksat. E ardhura e vetë përbëhet kryesisht nga tarifatat për disa nga shërbimet publike të ofruara nga administrata qarku.</p> <p>iii. E ardhurat totale që administrata e qarkut përfiton nga burimet e veta dhe kombëtare është shumë e ulët dhe jo e mjaftueshme për të ndërmarrë ndonjë investim të madh apo iniciativë zhvillimi, pa ndihma të tjera financiare.</p>
<p><i>Rekomandime për përmirësim</i></p> <p>i. Rritje e nivelit të mbledhjes së taksave dhe tarifave në nivel lokal</p> <p>ii. Delegim i funksioneve dhe kompetencave të tjera Qarkut nga nivelet kombëtare ose ato vendore</p> <p>iii. Ndërmarrja e iniciativave të përbashkëta të zhvillimit midis NJQV-ve brenda rajonit ose rajonet kufitare (psh: zhvillimi i projekteve të përbashkëta në zona që shtrihen në më shumë se një njësi për të ngritur facilitete dhe infrastruktura të përbashkëta dhe për të ndarë përgjegjësitë dhe përfitimet)</p>

Eksperiencia me projektet e zhvillimit

Gjatë periudhës shtatë vjeçare, 2005-2012, rajoni i Kukësit ka përfituar ndihmë financiare nga donatorë të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të tilla si: BE, PNUD, SNV, FSHZH në sektorë të ndryshëm të zhvillimit. Tabela e parë më poshtë jep detaje të tjera të disa nga projekteve më të mëdha në rajon, ndërsa e dyta tregon shpërndarjen e parave në të gjithë sektorët. Projektet janë fokusuar kryesisht në ndërtimin e infrastrukturës, zhvillimin e turizmit dhe kapaciteteve.

Tabela 8 Projektet e zhvillimit, (2005-2012)

Nr.	Emri i Projektit	Statusi	Sektori	Donatori	Kohëzgjatja	Vlera totale	Valuta
1	KRDI-Projekti i Permiresimit te Infrastruktures Vendore	<i>Perfunduar</i>	Infrastruktura Transporti	EC-UNDP	2005-2008	498,720,253 ³⁸	ALL
2	Zhvillimi i kapacitetetve rajonale mbi tema të perspektives Europiane per Zhvillim Rajonal dhe Rural	<i>Perfunduar</i>	Zhvillim Kapacitetesh	SNV	2010		
3	Projekti i Bjeshkeve te Namuna	<i>Perfunduar</i>	Turizem	SNV			
4	Ndertimi i rruges Kam-Golaj	<i>Perfunduar</i>	Infrastruktura Transporti	FZSH	25/03/2011-22/12/2011 ne proces	676,402,430	ALL
5	Vazhdim i Lotit II te rruges se Shistavecit	<i>Perfunduar</i>	Infrastruktura Transporti	FZSH		986,634,000	ALL
6	Rruga Sheshi i Trageteve-Lekbibaj	<i>Perfunduar</i>	Infrastruktura Transporti	FZSH	10/04/2011-10/10/2012 perfunduar	624,512,532	ALL
7	Projekti i promovimit te turizmit dhe mbrojtjes se mjedisit (KRTEP)	<i>ne vazhdim</i>	Turizem	UNDP	2009-2011	1,134,000	EUR
8	Projekti unilateral i bashkepunimit nderkufitar me Kosoven	<i>ne vazhdim</i>	Zhvillim Kapacitetesh	UNDP		590,000	EUR
9	Pakti Territorial i Punesimit	<i>ne vazhdim</i>	Zhvillim bujqesor dhe rural, Punesim	UNDP	2010-2012	300,000	USD
10	Mbeshtetje e Integruar per Decentralizim	<i>ne vazhdim</i>	Zhvillim Kapacitetesh	EC-UNDP	2008-2012		
11	Mbeshtetje e Integruar per Decentralizim	<i>ne vazhdim</i>	Infrastruktura	EC-UNDP	2012	500,000	EUR
12	Rruga Aerodrom-Domaj	<i>ne vazhdim</i>	Infrastruktura Transporti	FZSH	01/05/2011-30/09/2012 perfunduar	301,788,720	ALL

Burimi: Keshilli i Qarkut Kukës

³⁸ Vlera totale e projekteve eshte 498.720.253 Leke. Nga kjo shumë, 424.324.865 është dhënë nga KE & UNDP dhe 74.395.388 bashkefinansim (15%) jane te periudhes 2005-2008.

Tabela 9 Lista e projekteve të zhvillimit sipas sektorëve, Qarku Kukës, 2005-2012

Sektori	Nr projekteve
Arsim (shkolla, kopshte, terrene sportive dhe oborre)	26
Shendetesi (Qendra Shendetesore dhe Ambulanca)	10
Infrastruktura Rrugore (rruge, ura dhe trotuare)	17
Ujesjelles Kanalizime (ujësjellesa dhe KUZ)	12
Bujqesi (kanale vaditese dhe rezervuare)	13
Gjelberim/Mjedis (Parqe dhe lulishte)	2
Elektricitet (linje elektrike)	1
Total per 23 njesi vendore te rajonit	81

Burimi: Keshilli i Qarkut Kukës

Conclusions

Rajoni karakterizohet nga tiparet e mëposhtme të të ardhurave publike lokale dhe përvojave në menaxhimin e projekteve:

- Ka një nivel shumë të ulët të të ardhurave të veta të NJQV-ve, cka pasqyron ekonominë e dobët rajonale e cila është e varur nga fondet e zhvillimit të qeverisë qendrore dhe donatorëve ndihmë. Në afat të gjatë kjo situatë duhet të ndryshohet, duke krijuar kushte për punë, biznes dhe investime në sektorët produktiv.
- Qarku Kukës ka një përvojë relativisht të pasur në projekte dhe mbledhjen e fondeve, e fituar kryesisht nga me mbështetja e UNDP-së dhe BE-së.

2. Analiza SWOT

Tabela SWOT ofron një përmbledhje të mirë të të gjitha çështjeve kyçe të marra në konsideratë dhe lidh vlerësimin të situatës aktuale me drejtimet e zhvillimit rajonal.³⁹

Pikat e Forta dhe Dobësitë

Pikat e Forta	Dobësitë
<i>Demografia dhe Zhvillimit Hapësinor</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i popullsisë është stabilizuar vitet e fundit sidomos krahasuar me shpopullimin e konsiderueshëm të viteve 90. Që nga 2006 deri ne 2010 ajo ka rënë me (0,4%), (+ +) • Rajoni ka një popullsi relativisht të re duke qene se 38.5% e popullsisë është nën moshën 15 vjeç (+ +) • Afërsi relative me vende të rëndësishme (Tiranë, Kosovë) për shkak të rrugës së re. (+ +) 	<ul style="list-style-type: none"> • Migrimi i brendshëm nga zonat rurale në ato urbane është një faktor shumë i rëndësishëm që prek zonat rurale dhe është shqetësues për shkak të mospërdorimit të punës në bujqësi papunësi e fshehur (- -) • Kushte të pafavorshme natyrore për zhvillimin hapësinor, vendbanimet, ekonominë duke përfshirë këtu dhe bujqësinë - kryesisht terrene të vështira malore me pak mundësi për përdorim nga popullsia (- - -) • Lidhja me kryeqytetin dhe me qendra te tjera te rendesishme te vendit vazhdon te mbetet e veshtire per per Tropojen, Hasin dhe zona te tjera rurale te Qarkut (- - -)
<i>Rritja, konkurrueshmeria dhe Kohezioni Ekonomik</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Infrastrukturë transporti ndër-rajonale e mirë dhe e përmirësuar duke lejuar akses më të mirë në tregje dhe punë: autostrada e re(+ + +) • Burime të pasura natyrore: minerale, ujëra bukuri natyrore (++) • Përdorim i madh i tokës në lartësi të konsiderueshme mbi nivelin e detit dhe të prodhimeve bujqësore: p.sh. vreshta, arrore (+) • Një ekonomi e larmishme për sektorët që kontribuojnë në GVA. (++) 	<ul style="list-style-type: none"> • Copëzimi i lartë tokës bujqësore dhe infrastrukturë e pamjaftueshme për bujqësinë (---) • Pabarazi të mëdha ekonomike ndërmjet pjesëve të ndryshme të rajonit, veçanërisht qytetit të Kukësit dhe komunave periferike (- - -) • Përdorimi i paqëndrueshëm i pyjeve: shfrytëzimi i paligjshëm, mungesa e menaxhimit të duhur (-) • Sektorë të pazhvilluar përkundër potencialit relativisht të lartë: turizmi, energjia e rinovueshme, minierat (- - -)
<i>Kohezioni social, Shëndetësia dhe Arsimi</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Akses i mirë në arsim në zonat urbane (++) • Nivel i mirë i kujdesit shëndetësor, por jo në zonat e thella periferike (++) • Shërbimi bashkëkohor i spitalit rajonal te Kukesit, ekzistojne te gjitha pajisjet bashkëkohore. (++) • Prezenca e Deges se Universitetit te Tiranës ne Kukes, si dhe dy fakultete te tjera private (++) • Ndryshim i ndjeshem i mentalitetit te shoqerise (+) 	<ul style="list-style-type: none"> • Pabarazi të mëdha në sigurimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimit në zonat e thella për shkak të dendësisë së ulët të popullsisë dhe kushteve të vështira natyrore (-) • Varësi e madhe nga ndihma sociale: 45% e totalit të familjeve në rajon marrin ndihmë sociale (të pjesshme dhe të plotë) (-) • Nivele jashtëzakonisht të ulëta të të punësuarve që kontribuojnë për të sjellë të ardhura në rajon (vetëm 9% e popullsisë së përgjithshme në vitin 2010) (---) • Mungese te personelit te specializuar ne shendetesi • Qendrat shendetesore ne zonat rurale jane te

³⁹ Niveli i rëndësisë për zhvillimin rajonal është treguar nga numri i pluseve apo minuseve në kllapa (një - i konsiderueshëm, dy - i lartë, dhe tre-shumë i lartë)

Pikat e Forta	Dobësitë
	<p>pajisura me shume pak mjete dhe kane staf infermjeresh te pa kualifikuar; disa prej tyre nuk kane uje te rrjedhshem dhe u mungon higjena</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka mungese doktoresh dhe pajisjesh per te dhene ndihmen e shpejte apo nje trajtim te thjeshte. • Spitali ne Bajram Curri nuk ka disa nga pajisjet baze dhe nuk ka nje pediater. • Ka mungese te sherbimeve sociale dhe te ofrimit te sherbimeve rehabilituese dhe parandaluese per femijet dhe te rriturit me aftesi te kufizuara, femijet me semundje mendore apo femijet qe jane ne rrezik dhe qe jetojne ne zonat rurale. • Mungese ne adresimin e nevojave te femijeve apo perfshirjes se tyre ne strategji apo ne alokimin e buxhetit • Mungojne sherbimet per nderhyrje ne femijerine e hershme, si dhe ka kufizim te sherbimeve per edukimin parashkollor ne shumicen e zonave rurale • Mungon sherbimi psikologjik ne zonat rurale ; • Nuk ka shërbime arsimore per femijet me aftesi te kufizuara; • Nuk ofrohen sherbime per viktimat e dhunes ne familje; • Nuk ka zyra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne zonat rurale. • Ne zonat rurale, shumica e mesuesve jane te pa trajnuar; ka nje mungese totale monitorimi dhe vleresimi nga Inspektoret e DAR • Mungese e barazise gjinore • Mos-perfshirja e te rinjve ne strukturat e vendim marrjes
<i>Mjedisi, Aksesimi në infrastrukturë dhe shërbime</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Infrastrukturë kombëtare rrugore e mirë dhe e përmirësuar - autostrada e re (++) • Vendet me bukuri natyrore dhe ekosisteme të pasura: parku natyror I Valbonës, zona e mbrojtur strikte Lumi I Gashit; zona turistike e Shishtavecit (+++) • Atraksione turistike te Qarkut, monumente te natyres dhe te kultures(++) 	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli shumë i ulët i masave të mbrojtjes së mjedisit dhe infrastrukturës e shoqëruar me ndërgjegjësimin e ulët të komunitetit (- - -) • Dëme mjedisore për shkak të industrisë minerare, përdorimi i paqëndrueshëm i pyjeve, I ujërave për peshkim etj (- - -) • Infrastrukturë e varfër e brendshme e transportit rrugor, që vështirëson së tepërmi aksesin e zonave periferike dhe të thella të qarkut (- -) • Rruget rajonale Kukes – Bajram Curri dhe Kukes – Peshkopi, nuk kane akses te mire • Infrastrukturë/shërbime të brendshme, publike dhe private, shumë të varfëra: Furnizimi me ujë, aksesimi në kanalizime, telekomunikacioni, interneti, etj, sidomos në vende të largëta

Mundësitë	Kërcënimet
<i>Demografia dhe Zhvillimi Hapësinor</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Programe të qeverisë dhe donatorëve për të rritur punësimin rajonal; për të rritur rentabilitetin e prodhimit bujqësor nëpërmjet kredive/granteve; për të zhvilluar turizmin dhe për të forcuar kapacitetet për zhvillim të qëndrueshëm në rajon. (+ +) 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillim më i shpejtë i zonave me të cilat kufizohet qarku i Kukësit gjë që ul atraktivitetin e Kukësit dhe shkakton emigrim të lartë të njerëzve (-- -) • Rritja e migrimit nga zonat rurale në ato urbane, nëse politikat e zhvillimit rural nuk janë të efektshme (-)
<i>Rritja, konkurrueshmeria dhe Kohezioni Ekonomik</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e interesit të turistëve të huaj për Ballkanin shoqëruar me promovimin e turizmit në nivel kombëtar (+ +) • Politika preferenciale të infrastrukturës dhe programet mbështetëse të zhvillimit ekonomik: SME-ve, etj (+) • Heqja e pengesave doganore me Kosovën (+ +) • Kualifikimi profesional dhe programe për kapacitetet njerezore (rikualifikimi) nga qeveria dhe donatorët (+ +) 	<ul style="list-style-type: none"> • Klima e pafavorshme politike në Shqipëri dhe integrimi i ngadaltë në BE duke penguar modernizimin e infrastrukturës dhe institucioneve (---) • Shpërndarje e paqëndrueshme e investimeve publike mes qarqeve (-) • Çështje dhe problematika të vazhdueshme rregullatore dhe pronësie mbi tokën dhe pronën i bëjnë të vështira investimet • Ulja e remitancave • Kriza globale ekonomike e zgjatur, mungesa e stabilitetit, sidomos financiar i disa ekonomive të BE-së: Greqia, në një masë më të vogël edhe Italia (--)
<i>Kohezioni social, Shëndetësia dhe Arsimi</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i arsimit profesional sipas programeve kombëtare dhe të BE-së (+ +) • Rritja e mundësive të punësimit në disa sektorë, bazuar në pikat e forta rajonale: bujqësi, turizëm etj. • Mundësi për të punuar në partneritet me organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve me në fokus femijet dhe shërbimeve sociale; • Zhvillimi dhe përdorimi i tenderimit për organizatat e shoqërisë civile për të ofruar shërbime sociale 	<ul style="list-style-type: none"> • Mos përshtatja e shërbimeve dhe faciliteteve të shëndetësisë dhe arsimit sipas levizjeve demografike në rajon. (-)
<i>Mjedisi, Aksesi në infrastrukturë dhe shërbime</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje e vazhdueshme nga donatorët dhe qeveria në zhvillimin e infrastrukturës për ta sjellë atë në nivele të pranueshme (+ + +) • Krijimi i sistemeve të përshtatshme të mbrojtjes së mjedisit, sidomos mbeturinave të ngurta, ujrave të zeza (+ + +) 	<ul style="list-style-type: none"> • Presioni më i madh në infrastrukturë dhe shërbime publike në zonat urbane për shkak të fluksit të emigrantëve që vijnë nga zonat rurale (-) • Dëmtim gradual i biodiversitetit natyror dhe pyjeve rrezikon të çojë në: <ul style="list-style-type: none"> – Zhdukjen e specieve – Humbjen e pjellorisë së tokës bujqësore – Shkatërrimin e pakthyeshmë të ekosistemeve të pyjeve dhe kullotave – Degradimin e florës dhe faunës

Konkluzione nga SWOT

- Ka një stabilizim të popullsisë totale të rajonit në vitet e fundit pavarësisht se lëvizjet demografike brenda tij vazhdojnë (nga zonat rurale në ato urbane) si pasojë e terreneve gjeografike të vështira dhe ofrimit të dobët të shërbimeve në zonat më periferike.
- Ekonomia rajonale është mjaftueshmërisht e diversifikuar dhe nga ana tjetër rajoni posedon burime të mëdha natyrore të cilat kanë potencial të lartë ekonomik. Përmirësimi i aksesit infrastrukturor sidomos me pjesën tjetër të vendit i jep më shumë shanse ekonomisë rajonale. Por nga ana tjetër ka akoma potenciale të pashfrytëzuara të burimeve (turizmi, energjitë e rinovueshme, minierat). Për më tepër ka nevojë për parandalimin e shfrytëzimit të paligjshëm të burimeve (psh: pyjeve)
- Në aspektin social parametrat e arsimit e shëndetësisë kanë përmirësime sidomos në zonat urbane. Megjithatë rajoni në brendësi ka shumë pabarazi dhe problematike mbeten zonat rurale dhe periferike, zona të cilat vuajnë edhe nga varfëri dhe papunësi e lartë dhe akses më i dobët në shëndetësi dhe arsim.
- Rajoni ka bukuri të rralla natyrore por që nga ana tjetër vihen shumë në rrezik nga niveli shumë i ulët përgjegjshmërisë dhe masave mbrojtëse ndaj mjedisit (psh: ndotje mjedisore për shkak të industrisë minerare, përdorimi i paqëndrueshëm i pyjeve, i ujërave për peshkim etj). Ndërkohë, aksesit infrastrukturor i përmirësuar mund të përbëjë dhe kërcënim duke qenë se mund të rrisë presionin mjedisor. Infrastruktura e brendshme rrugore mbetet akoma e dobët.
- Ka një sërë politikash të zhvillimit ruaral për të mbajtur nën kontroll lëvizjet demografike, duke i krijuar mundësi njerëzve të punësohen dhe të jetojnë mirë në territoret e tyre, megjithë riskun e lëvizjeve është i madh meqenëse rajonet përreth mund të jenë më atraktive për të jetuar.
- Duke qenë se rajoni ka prioritet të parë zhvillimin e turizmit duhet thënë që ai është i favorizuar nga rritja e interesit të turistëve për të vizituar Ballkanin. Gjithashtu ka politika preferenciale të infrastrukturës dhe programeve mbështetëse të zhvillimit ekonomik: SME-ve, punësimit etj që adresojnë problematikat e rajonit

3. Konteksti Politik

Ka shumë modele të mundshme dhe qasje të ndryshme për Zhvillimin Rajonal. Në Shqipëri, kuadri ligjor dhe institucional për Zhvillimin Rajonal është akoma I paqartë dhe jo I plotë. Për këtë arsye, aktorët e zhvillimit rajonal duhet të orientohen në një situatë që është në evolucion. Rajoni duhet të dijë se çfarë mund të bëjë vetë më mirë; çfarë mund të bëhet më mirë nga të tjerët; ku ka nevojë për bashkëpunim me autoritetet kombëtare; dhe ku e në çfarë shkalle duhet të bashkëpunohet me aktorëve rajonalë. Në këtë kapitull, Partneret Rajonale, paraqesin "Hartën" e realitetit të zhvillimit - problemet, sfidat dhe ndërhyrjet ku ne mendojmë se, duke vepruar së bashku, ne tashmë mund të kontribuojmë në zhvillimin e rajonit tonë në një mënyrë që të tjerët nuk mundën. Në thelb ka dy realitete për këtë:

- fusha ku disa kontribute përgatitore dhe planifikim nga aktorët rajonale janë thelbësore dhe të mjaftueshme (për të informuar dhe drejtuar kryesisht politika dhe strategji kombëtare)
- fusha ku zbatimi bëhet më mirë në nivel rajonal - dmth më lart se thjesht niveli lokal, dhe më poshtë sesa niveli kombëtar. Në shumë raste "rajonale" nënkupton një agregim ose koalicion të interesave të ndryshme lokale.

Idetë e paraqitura në këtë kapitull janë përfutur nga ushtrimet analitike dhe shkëmbimi i përvojave të ndërmarrë nga aktorët rajonal në kuadër të Programit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal. Ne nuk paraqesim këtu një analizë ligjore të asaj se "kush duhet të bëjë çfarë" por, më tepër një analizë të realitetit se kush aktualisht bën çfarë, kush faktikisht pritet të veprojë dhe kush është I pozicionuar më mirë dhe më I përshtatshëm për të vepruar. Konkluzionet kyçe të këtij ushtrimi jepen më poshtë:

- Atribuimi i roleve dhe përgjegjësi të ndryshme në aspektin e veprimeve të zhvillimit (marrë gjerësisht) në Shqipëri është i paplotë. Ndërkohë që ka disa mbivendosi, ka edhe shumë boshllëqe- boshllëqe ku askush nuk bën asgjë. Për më tepër pikat e takimit ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes (sidomos kombëtare dhe rajonale / lokale) ose midis rajoneve, ndërmjet publikut dhe aktorëve të ndryshëm janë krejtësisht të pamjaftueshme. Praktikisht kjo pengon çdo përpjekje reale proaktive të zhvillimit në shumë fusha dhe ka nevojë të ndryshohet.
- Ka shumë fusha ku asnjë agjenci publike apo nuk po është aktive duke reflektuar kështu mungesën e burimeve financiare, të vizionit dhe kapaciteteve institucionale e organizative. Rëndom vihet re dhe përqendrimi i madh në infrastruktura të mëdha dhe përqendrim i pamjaftueshëm në investime produktive (jashtë skemave të caktuara të subvencionimit në bujqësi), mbështetje ndaj tregut të punës, dhe promovimit të turizmit.
- Fushat e zhvillimit nuk janë blloqe homogjene, të cilat mund t'i atribuohen ekskluzivisht këtij apo atij niveli të autoritetit publik. Në çdo fushë (mbështetja për investime produktive, infrastrukturë të transportit, infrastrukturë të mjedisit, zhvillimi i turizmit, etj) kërkohen një seri procesesh dhe burimesh politikash, strategjish, investimesh dhe praktikash të nevojshme për të sjellë ndryshimin e dëshiruar. Proceset kanë janë të thella dhe të gjera dhe në kohë të ndryshme ndërhyjnë aktorë të ndryshëm. Në shumë fusha zhvillimi, në Shqipëri si kudo tjetër, shumë aktorë publike janë dhe duhet të vazhdojnë punojnë së bashku.
- Zhvillimi rajonal nuk i përket një shtrese të vetme të qeverisjes publike. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me qarkun si një institucion: kjo ka të bëjë me zhvillimin e territorit rajonal dhe si i tillë, përfshin nivele të ndryshme të qeverisjes publike dhe jo publike. Në situatën e Shqipërisë zhvillimi rajonal praktik kërkon edhe një qasje praktike partneriteti.

- Kështu, duhet të pranohet se masat kombëtare/qendrore edhe kur janë konceptuar, planifikuar, përgatitur dhe zbatuar në tërësi, drejtpërdrejt nga pushteti qendror, i kontribuojnë gjithashtu zhvillimit rajonal. Në shumë raste të tjera, të ashtuquajturat masa kombëtare/qendrore, kanë nevojë për njëfarë bashkëpunimi rajonal për të siguruar zbatimin e duhur (p.sh. gjithë fusha e mjedisit, që përfshinë mbetjet urbane, ujërat e zeza, menaxhimin e mbetjeve). Në këtë kuptim në shumë fusha është e qartë se aktorët rajonalë që punojnë së bashku mund të ndihmojnë në realizimin e shumë politikave kombëtare (mjedis, infrastrukturë, zhvillim të NMVve dhe promovim biznesi, zhvillim të bujqësisë, tregut të punës dhe burimeve njerëzore, etj)⁴⁰
- Duke analizuar fushat kryesore ku paratë publike mund dhe zakonisht ndërhyjnë për të mbështetur proceset e ndryshme të zhvillimit, kemi mundur të identifikojmë fushat ku një formë e veprimeve për zhvillim nga partnerët rajonalë a) është e nevojshme b) është e përshtatshme c) nuk është duke u ndërmarrë nga dikush tjetër d) mund të zbatohet shumë lehtë, pa ndonjë ndryshim thelbësor ligjor apo institucional. Këto janë fushat ku zhvillimi rajonal mund të ndodhë aktualisht. Në gjithashtu mund të identifikojmë veprime të cilat edhe pse bien në të njëjtën paradigme (e nevojshme, e përshtatshme, nuk është ndërmarrë nga të tjerët) do të kërkonin një nivel minimal të qartësisë nga qeveria qendrore në formën një kuadrit mundësues (zakonisht politikash, rregullatore apo strategjike). Ky është padyshim rasti për fusha të tilla si menaxhimi i mbetjeve).
- Zhvillimi rajonal ka të bëjë me: a) adresimin e nevojave dhe mundësive të gjithë territorit rajonal (në nivelin "meso"). E njëjta gjë vlen edhe kur e shikojmë zhvillimin nga perspektiva lokale. Teorikisht veprime të caktuara të zhvillimit mund të bëhen në nivel lokal si p.sh: marketingu i turizmit, trajtimi i mbetjeve, mbështetje për NVM-të. Por në shumë raste - dhe kjo është përvoja e shumicës të botës dhe sidomos e pjesës tjetër të Evropës - zgjidhjet lokale nuk do të jenë efikase, efektive apo të qëndrueshme në këto dhe shumë fusha të tjera. Shumë veprime kërkojnë të jenë të planifikuara, përgatitura dhe në të vërtetë shpesh të zbatuara për një zonë reference më të madhe, pra në një nivel më të lartë territorial. Në Shqipëri, në situatën aktuale ky nivel më i lartë ose madhësi është territori i qarkut (rajoni). Pyetja se kush i financon veprimet është një çështje krejt tjetër: në parim burimet mund të vijnë nga autoritetet qendrore tek ato rajonale dhe lokale përmes mekanizmave të ndryshëm të transferimit dhe/ose mund të dalin nga burimet lokale.
- Megjithatë është e qartë se në Shqipëri, si në shumë vende të tjera, nevojat e territorit të qarkut nuk mund të përmbushen vetëm nga kompetencat e kufizuara të administratës së qarkut. Nëse funksionet e qarkut, (apo funksione të tjera publike), do të riorganizohen për të marrë parasysh këto nevoja, ky është një vendim politik dhe administrativ. Por, për të qenë realistë, ky riorganizim nuk është absolutisht i domosdoshëm. Në shumë vende nevoja për përshkallëzim rajonal nuk është përmbushur nga ndryshimi apo riorganizimi total administrativ, por duke mundësuar mënyra fleksibile për të punuar përmes dhe ndërmjet institucioneve. Pra, nëpërmjet partneritetit mes autoriteteve lokale publike dhe mes niveleve të ndryshme të autoriteteve publike lokale dhe rajonale. Kjo është një qasje më funksionale, disi fleksibël për zhvillimin e nivelit rajonal. Ky është lloji i partneritetit të cilin e propozon Strategjia

⁴⁰Për shembull, a mundet që Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve të zbatohet në tërësi nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, ose Ministria e Mjedisit? A nuk ka një domosdoshmëri praktike për të mobilizuar përpjekjet e një koalicioni rajonal (Qarku dhe bashkitë për shembull) për të siguruar zbatimin dhe operimin e objekteve të menaxhimit të mbetjeve? Me pak fjalë edhe për të ashtuquajturat veprime shumënacionale / qendrore ka praktikisht një dimension të nevojshëm rajonal.

Më poshtë kemi treguar një matricë të këndvështrimit tonë për rolin që luan praktikisht secili nivel i qeverisjes. Nga kjo ne identifikojmë veçanërisht hapësira të vogla dhe të mëdha për ndërhyrje të qartë nga aktorët rajonal që veprojnë së bashku. Gjithashtu identifikojmë fusha të tjera ku duhet të japim kontribut. Ne identifikojmë fushat ku ne pranojmë dhe në të vërtetë edhe kërkojmë, që qeveria qendrore/kombëtare të marrë përgjegjësitë e saj dhe të bëjë, në nivel kombëtar, vetëm atë çka mund të bëjë në bazë të burimeve dhe kompetencave që ka. Si një Partneritet Rajonal ne jemi të përkushtuar për bashkëpunim me të gjitha nivelet dhe llojet e qeverisjes dhe komunitetin e donatorëve për të zhvilluar rajonin tonë.

1. Fushat e Zhvillimit ku Qeveria Qendrore ka mundësinë dhe është e mirë-pozicionuar për të vepruar vetëm (politika, strategji, rregullore, financim, zbatim):
 - Transport: Rrugët apo autostradat ndërkombëtare, gjithë rrjeti hekurudhor , të gjitha gjithë mjetet/asetet hekurudhore, gjithë rrugët ujore dhe lumenjtë e brendshëm kryesorë, Zbatimi I reformave në nivel kombëtar - sisteme të reja çertifikimi, standarte të reja
 - Energjia: të gjitha rrjetet e mëdha energjitike që vijnë apo lidhen me vendet e tjera të prodhimit / brez energjisë objektet, të gjitha faciliztetet e prodhimit/gjenerimit të energjisë
 - Telecommunications/IT: Të gjitha investimet në infrastrukturën kryesore (kjo ka shume gjasa te jete investim privat), zbatimi I reformave në nivel kombëtar – sisteme të reja çertifikimi, standarte të reja
 - Burimet njerëzore dhe zhvillimi I tregut të punës: zbatimi I reformave në nivel kombëtar - sisteme të reja çertifikimi, standarte të reja, ndoshta disa programe të mëdha që përfshijnë gjithë tregun e punës – (nëpërmjet përshtatjes rajonale ose lokale mund të jetë e mundur
 - Bujqësia: Të gjitha skemat kombëtare të subvencionimit, subvencionimet për investime, apo zbatime përkatëse të reformave në nivel kombëtar - sisteme të reja çertifikimi, standarte të reja, të gjitha llojet e skemave të subvencionimit të çmimeve

2. Fushat ku kërkohet kontribut rajonal (dhe lokal) në pjesë të ndryshme të zbatimit të politikave:

Fusha e Zhvillimit	Roli i Aktorëve Rajonale – Identifikimi i nevojave nga poshtë lartë planifikimi, përgatitja edhe nëse ekziston një kuadër i politikave/strategjive kombëtare	Roli i Aktorëve Rajonale – Zbatim i përbashkët në shkallë rajonale (kryesisht rajonale)	Shënime
Transporti	Rrjeti i Rrugëve/Lokale	Përgjithësisht jo	NJOV të mëdha mund t'i zbatojnë, Aktualisht zbatohen nga Fondi Shqiptari i Zhvillimit. Qarqet mbështesin zbatimin për komunat më të vogla
Mjedisi	Investime infrastrukturore për të siguruar trajtimin dhe/ose riciklimin, ripërdorimin e mbetjeve familjare apo industriale	Po	Brenda Strategjisë Kombëtare dhe Kuadrit Rregullator, kërkohet koordinim vertikal kombëtar-rajonal, por ofrimi është kryesisht rajonal dhe lokal
	Investime infrastrukturore për të siguruar trajtimin e ujërave të zeza	Investime infrastrukturore për të siguruar trajtimin e ujërave të zeza	Si më sipër. Kërkon një planifikim mbi-lokal; zbatimi mund të jetë lokal
	Mbledhja/furnizimi me ujë	Mbledhja e ujit – Po Furnizim rajonal dhe lokal me ujë	Brenda Strategjisë Kombëtare dhe Kuadrit Rregullator
	Investime për të rritur qëndrueshmërinë e mjedisit natyror, veçanërisht në lidhje me zonat me pamje piktoreske apo që paraqesin ndjeshmëri të lartë (psh: kanë biodiversitet të rrallë, etj)	Po (zakonisht kërkon disa komuna/qarqe, etj)	Si më sipër
Shëndeti	Organizimi dhe ofrimi i kujdesit parësor dhe infrastrukturës e shërbimeve jo-spitalore	Po	Brenda Kuadrit Strategjik Kombëtar
	Spitalet, spitalet rajonale (publike)	Jo	Si më sipër
	me disa përjashtime) disa programe shëndetësore publike (përndryshe ato mbeten tërësisht kombëtare))	Po	Si më sipër
Arsimi dhe Trajnimi	Arsimi Fillor dhe ai i mesëm	Jo (bashkitë dhe komunat)	Si më sipër
	Infrastruktura / Pajisje	Disa po	Si më sipër
	Infrastruktura e edukimit profesional/Pajisjet/Nevojat Rajonale të Tregut të Punës	Po (zyra rajonale/lokale pune, strukturat rajonale të arsimit)	Si më sipër
	Shërbime për personat jashtë arsimit formal dhe sistemit të edukimit profesional	Po, Shërbime për personat jashtë arsimit formal dhe sistemit të edukimit profesional	Si më sipër

Fusha e Zhvillimit	Roli i Aktorëve Rajonale – Identifikimi i nevojave nga poshtë lartë planifikimi, përgatitja edhe nëse ekziston një kuadër i politikave/strategjive kombëtare	Roli i Aktorëve Rajonale – Zbatim i përbashkët në shkallë rajonale (kryesisht rajonale)	Shënime
	Programe/Projekte të veçanta (inovative dhe komplementare) të përqendruara në nivel rajonal/lokal (edhe nëse janë të konceptuara mbështetur në paradigma kombëtare	Po (nga Zyra e Punës) dhe struktura të tjera rajonale	Si më sipër
Përfshirja sociale	Asistenca sociale	Përgjithësisht jo	Zbatimi mund të jetë kombëtar ose lokal – më pak rajonal
Turizmi	Pothuajse të gjitha aspektet e turizmit, përveç aspekteve rregullatore dhe marketingut ndërkombëtar, mund të planifikohen më së miri në këtë nivel; (menaxhimi i destinacionit, zhvillimi i produkteve, markimi, marketingut, madje edhe shitjet), objektet/lehtësirat/pajisjet kryesore	Marketingu, markimi, shitjet, dhe përpjekjet e mëdha të zhvillimit të produktit kërkojnë zbatim i në nivel rajonal (ndoshta edhe lokal) Zhvillimi faqeve internet të turizmit zakonisht do të zbatohen në nivel lokal (edhe pse me planifikim dhe përgatitje rajonale)	Brenda Kuadrit Strategjik Kombëtar
Zhvillimi bujqësor/rural	Grupet e prodhuesve, Markimi rajonal	Po	Brenda Kuadrit Strategjik Kombëtar dhe programeve, gjithmonë e më konvergjente me politikat e BE-së në këtë fushë
	Iniciativa të zhvillimit rural (agroturizëm etj)	Po	Si më sipër
Sektorët produktivë	Investimet infrastrukturore (subjekt i analizave të tregut), për të krijuar qendra për vendndodhjen e bizneseve, inkubim, përfshirë hapësirat e punës, , parqet e biznesit, sidomos ato zona që kanë funksion inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve, shërbimet e ndara, inovacionet/ risitë	Po – (disa mund të zbatohen në nivel local psh nga bashki të mëdha, por zakonisht do të përgatitje/planifikim rajonal	Ndërhyrjet më komplekse zbatohen më mirë nga agjencitë shtetërore të specializuara
	Iniciativa të promovimit të biznesit të rajonit (faqe ëeb etj)	Po	Financimi direkt për kompanitë më mirë ofrohet nga agjenci shtetërore
	Shërbime të ndara konsulence/këshillimi (përfshirë biznese të reja që duan të ngrihen, ide, plane biznesi, plane investimi, studime, marketing ose mbështetje të tjera praktike për shitjet)	Po	Brenda Kuadrit Strategjik Kombëtar

Nga sa më sipër, ne konsiderojmë se aktualisht asgjë nuk e ndalon zbatimin e menjëhershëm të projekteve rajonale, në fushat kryesore të dhëna më poshtë, përveç burimeve financiare dhe

kapaciteteve të përshtatshme. Me fjalë të tjera, nuk ka asnjë varësi apo kusht kufizues në politikat dhe programet kombëtare. Fusha ku mund të zbatohen iniciativat rajonale:

- Të gjithë aktivitetet e investimeve dhe zhvillimit të turizmit përveç marketingut të përgjithshëm ndërkombëtar
- Zhvillimin e i planeve menaxhuese mjedisore për zonat e mbrojtura dhe me ndjeshmëri të lartë natyrore
- Zhvillimi i strategjive të zhvillimit rural dhe të strukturave përkatëse , investime sipas zonave për të rigjeneruar, ri-projektuar, rinovuar, pastruar, përmirësuar dhe në fund për të përforcuar atraktivitetin për tregtinë, vizitorët, investimet në fshatra dhe zona rurale, ndërtimet dhe rikonstruksionet e rrugëve lokale për të cilat ka edhe një kërkesë të lartë (sidomos për transportimin e prodhimeve)
- Promovimi I Biznesit - marketingu rajonal dhe promovimi - "Pse të investosh në rajonin tonë?", "Çfarë ka Rajoni jonë për ti ofruar Investitorëve".

Për zonat e tjera planifikimi i investimeve do të përfitojnë nga qartësimi i kornizës kombëtare të investimeve nga organet shtetërore përkatëse. Planifikimi dhe investimet mund të bëhen më së miri nëpërmjet projekteve rajonale – por kjo është detyrë e qeverisë qendrore në radhë të parë për të sqaruar dhe kuadrin në të cilin kjo mund të bëhet (p.sh. rregullore, adresa, çështjet ligjore apo tregu) -) në disa raste investimet të veçanta mund të zbatohen më së miri nga një NJQV e vetme e madhe)

- Investime infrastrukturore për të siguruar trajtimin dhe /ose riciklimin, ri-përdorimin e mbetjeve të brëndshme ose industriale
- Investime infrastrukturore për të siguruar trajtimin e ujërave të zeza
- Investime për të rritur qëndrueshmërinë e mjedisit natyror sidomos duke konsideruar me kujdes zonat me atraktivitet natyror dhe ndjeshmëri të lartë (psh me biodiversitet të rrallë)
- Investime infrastrukturore (subjekt i analizave të tregut), për të krijuar qendra për vendndodhjen e bizneseve, inkubim, përfshirë hapësirat e punës, , parqet e biznesit, sidomos ato zona që kanë funksion inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve, shërbimet e ndara, risi/inovacione

Do të ishte një ndihmë e madhe në qoftë se rolet dhe përgjegjësitë në disa nga këto fusha do te ishin përcaktuar më mirë: megjithatë në shumë sektorë është e qartë se barra e përpjekjeve në drejtim të planifikimit të detajuar, përgatitjen dhe zbatimin, shpesh bie mbi organet publike lokale që veprojnë së bashku në vend të nivelit qendror. Roli i këtij të fundit, është kryesisht "mundësimi". Ndërkohë që investimet publike dhe programet e zhvillimit zgjerohen me kalimin e kohës, nevoja për më tepër përpjekje rajonale do të bëhet e qartë në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e zhvillimit

3. Vizioni

Strategjia është afat mesme, që do të thotë deri në 5 vjet (2012-2016) duke qenë se ka shumë pasiguri në të ardhmen për ti planifikuar në këtë moment. Plani i Veprimeve dhe masat në përgjithësi janë deri në 3 vjet, veçanërisht të detajuara për vitet 2012 & 2013. Projekte të caktuara që do të kërkojnë vite përgatitjeje para se të zbatohen janë të përfshira në të, pasi do të kenë nevojë për aktivitete përgatitore në një periudhë afat shkurtër apo afat mesme. Strategjia mbulon gjithë fushat që kanë lidhje me të, pavarësisht se cili nivel qeverisjeje është përgjegjësi kryesor për këto. Strategjia udhëhiqet nga një vizion i përbashkët zhvillimi dhe ndryshimi:

Vizioni

Në 5 vite Kukesi do jetë një rajon me zhvillim të qëndrueshem ekonomik – social, me fokus turizmin malor dhe ruajtjen e vlerave origjinale të kultures dhe natyrës, një rajon që do të ofrojë mjedis të pastër e të shëndetshem për banorët e tij.

Ky vizion nënkupton:

- Një thyerje të shumë tendencave/mentalitetesh tradicionale, që përfshijë qëndrime, sjellje apo performanca institucionale apo individuale
- Një angazhim për të farkëtuar një formë të re bashkëpunimi përmes sistemeve dhe niveleve të qeverisjes
- Një angazhim për të punuar për një shkallë më të lartë performance ekonomike e veçanërisht rritjen e produktivitetit të saj
- Një angazhim për të rishikuar dhe ndryshuar (kur kërkohet) praktika regullatore dhe administrative, që janë në kundërshtim me vizionin e kësaj strategjie.
- Një thirrje për qeverinë qendrore, e cila është përgjegjëse për aspekte të ndryshme brenda kësaj strategjie, për të përvijuar politikat dhe praktikatat e saj me këtë strategji dhe të pranojnë thirrjen për t'u angazhuar në partneritetet rajonale
- Një thirrje për organizatat donatore për ta studiuar këtë vizion dhe strategji dhe për të identifikuar veprime specifike të cilat ata ti mbështesnin.

Vizioni mund të realizohet përmes objektivave strategjikë të poshtëshënuar dhe veprimeve dhe instrumentave të zhillimit e investimeve që bëjnë pjesë në fushat prioritare

4. Objektivat

Objektivat Strategjikë
OS1 – Rritja e kapacitetit prodhues të ekonomisë rajonale, sidomos në fusha me potencial për gjenerimin e të ardhurave të përgjithshme rajonale
OS2 – Përmirësimi i mjedisit natyror të rajonit si një aspekt kyç i identitetit dhe atraktivitetit të tij, sidomos duke shmangur të gjitha efektet negative në mjedis përmes aktiviteteve njerëzore
OS3 – Zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve dhe institucioneve në rajon për të çuar procesin e zhvillimit rajonal përpara
OS4 – Të zhvillojë kapacitetet e popullsisë së rajonit me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme të përfshirjes sociale, drejtësisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët në mënyrë që të marrin pjesë në ekonomi dhe shoqëri
OS5 – Të sigurohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore të përshtatshme dhe cilësore për qytetarët
OS6 – Sigurimi i një niveli të duhur të aksesit dhe lidhjes së rajonit me rajonet e tjera dhe njësisive brenda rajonit, thelbësore kjo për qëllime të zhvillimit ekonomik dhe social të zonës.

Një plan fillestar veprimi për periudhën 2012-2014 I bashkëlidhur në këtë strategji identifikon një numër veprimesh – kryesisht project-koncepte të vlefshme që janë identifikuar dhe përgatitur në një fazë fillestare, disa projekte dhe procese kyce – që do të ndiqen menjëherë. Kjo është një Axhendë për Ndryshim të menjëherëshëm.

5. Prioritetet, veprimet dhe përgatitjet

Brenda periudhës 2012 -2016 do të ndiqen prioritetet e mëposhtme. Partneriteti Rajonal fton:

- Ministritë dhe Agjencitë e vendit për të studiuar këto prioritetet me qëllim që të shohim se si këto mund të mbështesin politikën dhe strategjitë kombëtare dhe gjithashtu të mbështeten financiarisht nga ana e tyre, veçanërisht në kuadrin e shqyrtimit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, funksionimit të tij dhe SKZHI-së në të ardhmen
- Donatorët përfshirë BE-në, që gjithashtu të studiojnë këto prioritetet, sidomos Planin e Veprimit të projekt-ide të bashkëngjitur dhe proceset e zhvillimit për të parë se si ato und të mbështesin drejtimet e përcaktuara në partneritetin rajonal

Prioritetet janë të orientuara nga rezultatet, por gjithashtu edhe tregues të veprimeve që duhet të ndërmerren. Ata caktojnë drejtime që qartësisht shkojnë përtej burimeve financiare në dispozicion. Në shumë raste ndërkohë që Partneritetin Rajonal thellohet dhe fiton përvojë mbi projektet, atëherë ato do të fokusohen vetëm në aspekte të caktuara të zonave prioritare të përkufizuara gjerësisht. Në këtë kuptim kjo strategji i përngjan më shumë një procesi se sa një dokumenti përfundimtar.

Kjo strategji përfshin kryesisht masa që adresojnë nevojat rajonale. Termi "Rajonale" përkufizohet dhe i referohet "përfshirjes ose ndikimit në një pjesë të konsiderueshme të rajonit". Në teori ky mund të jetë një veprim që përfshin kryesisht një bashki, por vetëm nëse njihet prej të tjerëve si rajonale. Në përgjithësi termi do të përjashtojë veprime apo masa të një NJQV-je të vetme, veçanërisht të NJQV-ve më të vogla që janë qartësisht lokale. Përkufizimi "rajonal" mund të përfshijë projekte bashkëpunimi ndër-bashkiake/komunale. Masat do të shpërndahen në gjithë prioritetet dhe do të jenë si infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore.

Krahas kësaj, dhe në shprehje dhe në mënyrë komplementare me veprimet e rajonit, Qeveria do të ndjekë programet e saj të zhvillimit nga njëra anë, ashtu si bashkitë dhe komunat në anën tjetër. Partneriteti Rajonal i ka kushtuar vëmendje axhendës kombëtare të zhvillimit dhe kërkesave për integrimin në BE gjatë hartimit të kësaj Strategjie dhe paketës së projekteve fillestare. Ky dokument përfaqëson një koalicion të nevojave lokale dhe aspiratave që do të arrihen nga dy procese paralele dhe jo-ekskluzive: të zhvillimit rajonal, siç përshkruhet këtu, dhe zhvillimit lokal si shprehet në planet e zhvillimit lokal dhe projekteve të ngjashme. Strategjia nuk synon të zëvendësojë përpjekjet për zhvillim në nivelin lokal, por më tepër për të nxitur ndryshime të cilat mund të iniciohen më mirë në nivel më të lartë " në Mes"

Prioritetet strategjike janë përshkruar në detaje më poshtë:

Prioriteti 1	Zhvillimi i Turizmit malor si një nga sektorët kryesorë të zhvillimit të rajonit
Objektivi përkatës strategjik	SO1 - Rritja e kapacitetit prodhues të ekonomisë rajonale, sidomos në fusha me potencial për gjenerimin e të ardhurave të përgjithshme rajonale
Arsyetimi	<p>Sa i përket degëve të ndryshme të ekonomisë rajonale, është konsideruar se një nga mundësitë e zhvillimit për të ardhura shtesë dhe punësim më të lartë mund të hapen në sektorin e turizmit. Aktualisht, shumica e aktiviteteve turistike janë të organizuar në shkallë të vogël dhe ndarja e informacionit personal bëhet kur janë vizituar tashmë vende të caktuara. Lehtësirat dhe shërbimet janë të kufizuara në numër dhe shpesh kanë cilësi të diskutueshme. Kjo nuk është e mjaftueshme për ta bërë turizmin një element të rëndësishëm të ekonomisë rajonale.</p> <p>Ky sektor është me të vërtetë " i orientuar nga eksporti", ku klientët e jashtëm janë të interesuar për të vizituar, dhe shpenzojnë kohë dhe para në produktet e shërbimit rajonale. Kukësi ka disa asete të shquara natyrore dhe kushteve të cilat mund të zhvillohen në produkte të qëndrueshme turistike. Arsyet e mëposhtme e favorizojnë këtë zgjedhje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rajoni ka të shpërnadara në gjithë territorin e tij zona me bukuri të rralla natyrore të cilat janë dhe pasuri kombetare. • Kukësi ka traditë mikepritjeje • Rajoni ka vlera të veçanta etnografike dhe gastronomike • Ka terrene të përshtatshme dhe me potencial për zhvillimin e sporteve të ndryshme si ski, hipizem etj.
Qëllimi	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i turizmit malor, natyrës dhe aventurës nëpërmjet zhvillimit të një produkti të konsoliduar turistik, paketave të përshtatura për çdo segment klientele dhe krijimit të një marke rajonale për turizmin. Veprime të mundshme që mund të ndërmerren në këtë fushë prioritare janë: • Inkurajimi dhe mbështetja e bizneseve që operojnë në këtë sektor, me qëllim rritjen e të ardhurave që çojnë në përmirësimin e jetës së komunitetit. • Nxitja e bizneseve të turizmit malor me qëllim rritjen e të ardhurave që çojnë në përmirësimin e jetës së komunitetit. • Ndertimi i bizneseve familjare dhe të vogla në të paktën 5 zona turistike, deri në fund të 2016: • Hartimi i një plani promovues për zonat e mbrojtura në rajon <p>Shumica e drejtimeve të zhvillimit të turizmit janë përmendur në Strategjinë ekzistuese të Zhvillimit të Turizmit Rajonal, i cili ka nevojë gjithsesi për një plan konkret operacional i miratuar mes të gjitha institucioneve pjesëmarrëse në Partneritetin Rajonal.</p>
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Biznese të vogla e të mesme (me natyrë hotelerie dhe gastronomie) të ngritura me standarte të larta të kapaciteteve akomoduese • 30 Guest house në Rajon funksionale dhe të standartizuara • Trajnimi i burimeve njerëzore të punësuar në sektorin e turizmit (100 persona të certifikuar në manaxhim turizmi dhe mikpritje) • Ngritja e një qendre informacioni për turizmin (siç parashihet tashmë në strategjinë e turizmit) • Caktimi i një terreni të disponueshëm në rajon dhe ngritja e infrastruktures përkatëse për hipizem • Impianti i skive në Shistavec i ngritur • Promovime të publikuara të zonave turistike të mbrojtura në rajon • Një eëbsite rajonal i turizmit i dizenuar dhe funksional • Një projekt i ndërmarrë mbi shenjimin e mirë të vendeve turistike kryesore në të gjithë rajonin
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e numrit të turistëve (mesatarisht me 50% në vit) • Rritje e kapaciteteve akomoduese (5 herë më shumë në 2016) • Aktivizim i sporteve të ndryshme malore (ngritja e një infrastrukture të përhershme

	<p>të skive dhe të paktën një qendër hipizmi)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i shërbimit ndaj klientit (anketa cilësore që tregojnë përmirësime të qëndrueshme vit pas viti) • Shtimi i iniciativave qytetare për të përmirësuar aspektin fizik të zonave turistike (të paktën një cdo vit) • Të ardhura shtesë nga turizmi të paktën për 50 familje
Organizata kryesore për zbatim (t)	<p>Iniciativat këtu janë kryesisht brenda fushëveprimit të aktorëve lokale / rajonale dhe më së miri mund të realizohet nga shoqata / bashkëpunimi i tyre. Administrata Qarku konsiderohet organizata udhëheqëse që do të tërheqë edhe institucione të tjera publike, shoqata dhe operatorë private, duke siguruar aktivitete zhvillimore gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara. Planet e zbatueshme vjetore duhet të zhvillohen në partneritet dhe zbatimi i tyre të monitorohet duke përdorur tregues të thjeshtë.</p>

Prioriteti 2	Zhvillimi i blegtorise dhe bujqësisë nëpërmjet mbështetjes teknike për zhvillimin cilësor të fermave blegtorale dhe pronave të tjera rurale në zonat me traditë dhe potencial të madh zhvillimi
Objektivi përkatës strategjik	SO1 - Rritja e kapacitetit prodhues të ekonomisë rajonale, sidomos në fusha me potencial për gjenerimin e të ardhurave të përgjithshme rajonale
Arsyetimi	<p>Një problem i madh është paraqitur në lidhje me mënyrën se si ky sektor është organizuar në rajon. Në praktikë aktorët bujqësorë janë kryesisht pasiv: prodhimi bujqësor është kryesisht në përgjigje të kërkesës lokale. Produktet dhe shërbimet janë bazike dhe të ardhurat e ulëta. Ka pak veprime pro-aktive të rëndësishme të planifikimit ose organizimit në aspektin e zhvillimit të produktit ose të marketingut dhe të shitjes. Kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së vetëdijes, por kryesisht për shkak se asnjë aktor ekonomik nuk është i madh apo aq thelbësor sa të jetë në gjendje të diversifikojë dhe të profesionalizohet ashtu siç kërkohet. Kjo mungesë është në kontrast me potencialin e lartë të perceptuar të paktën në disa prodhime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Terren i përshtatshëm për rritjen e bagetive • Shumëllojshmëria e bagetive në rajon • % e madhe e të ardhurave nga blegtoaria dhe produktet blegtorale për zonat rurale

Qëllimi	<p>Veprimet e ndërmarra sipas këtij prioriteti do të jenë të fokusuar në iniciativat e përbashkëta midis aktorëve të ndryshëm të tregut në sektorë të njëjtë ose aleate. Veprimet do të përqëndrohen në nën-sektorët dhe produktet përkatëse - ullinj, perime, fiq, kumbulla, qumësht, mishit dhe produkteve sekondare që vijnë nga to. Shembuj të veprimeve të mundshme që mund të ndiqen në këtë fushë prioritare janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i aktiviteteve të agro-turizmit që përfshijnë rrjete me të paktën 10 ferma të ndryshme në të gjithë rajonin (strehim në fermë dhe kohaë e lirë) • Mbështetje për aktivitetet e përpunimit të ushqimit, duke përfshirë produktet të vecanta, unike lidhen me turizmin (p.sh. produkte lokale). • dërgjësimit i përbashkët, informacion, iniciativa trajnuese të ndërmarra nga dhe në emër të grupeve të prodhuesve të lidhura me çështje të tilla si: cilësia, përpuethshmëria ligjore, (me, për shembull, higjienën, shëndetin publik, agro-mjedisin, kërkesat e tregut duke përfshirë edhe ato për BE-në), planifikimin në biznes, markimin e përbashkë, marketingun dhe forma të tjera të bashkëpunimit <p>Të gjitha këto aktivitetet e tilla duhet të planifikohet me kujdes mbi parimet e biznesit dhe të përfshijë diskutimin dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Bujqësisë së Qarkut. Veprimet kryesore do të marrin formën e shërbimeve mbështetëse megjithëse mund të përfshijnë edhe skemat të subvencionimit të cilat duhet të vihen në dispozicion nga programe kombëtare ose të BE-së (sidomos IPA V).</p>
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Veprime trajnimi dhe ndërgjegjësimi për fermerët, që mbulojnë prodhimin, marketingun, cilësinë dhe mundësinë e bashkëpunimit, teknologjivtë e agro-përpunimit etj (të paktën 500 persona marrin pjesë) • Prezantimi i aktiviteteve të agro-turizmit në vende atraktive nga projekte pilot dhe skema (zbatohen së paku 4 projekte) • Fushata promovionale të metodave dhe teknologjive të reja bujqësore (të paktën 5) • Mbështetje për të paktën tre grupe prodhuesish në të paktën 2 nën-sektorë • Të paktën 50 fermerë të asistuar në grupe prodhuesish
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> • Shtimi i nr te gjedheve ne blegtori dhe sasisë së produkteve blegtorale të prodhuara • Përmirësimi i cilësisë së prodhimit • Rritje te ardhurash nga sektori • rritja e ndërveprimit dhe nismave të përbashkëta mes fermerëve për prodhuar më shume dhe në mënyre eficiente
Organizata (t) kryesore për zbatim	<p>Iniciativat këtu janë plotësisht brenda fushëveprimit të aktorëve lokale / rajonale dhe mund të realizohen më mirë nga partneritetet e tyre. Është parashikuar që Qarku do të luajë një rol lehtësues dhe iniciues në zhvillimin e këtyre partneriteteve së bashku me NJQV-të përkatëse. Një plan veprimi fillestar do të zhvillohen. Veprimet specifike sipas këtij Plani Veprimi do të planifikohen dhe zbatohen nga aktoerët relevant të cilët, në varësi të çështjes, ka të ngjarë të përfshijë partneritete të vogla (projektesh) dhe aktorë të tregut e publike. Kjo është reflektuar tashmë në disa nga projekt idetë e hartuara tashmë, bashkëlidhur me Strategjinë.</p>

Priority 3	Zhvillimi i industrise minerare sidomos i mineraleve të reja “jo aktive ⁴¹ ” dhe përdorimi i qëndrueshëm i pasurive minerare
Objektivi përkatës strategjik	SO1 - Rritja e kapacitetit prodhues te ekonomisë rajonale, sidomos në fusha me potencial për gjenerimin e të ardhurave të përgjithshme rajonale
Arsyetimi	Rajoni është i pasur me burime minerale të ndryshme, disa prej të cilave kanë potencial për të ofruar vende pune dhe të ardhurat të qëndrueshme. Infrastruktura aktuale e minierave ka qenë përdorur përpara viteve '90 dhe është pjesërisht e vjetëruar. Ekzistojnë probleme të rëndësishme në aspektin e dëmit mjedisor shkaktuar nga aktivitetet e paligjshme dhe të papërshtatshme të minierave në të kaluarën dhe ditët e sotme.
Qëllimi	Veprimet e ndërmarra sipas këtij prioriteti do të fokusohen në nisma të përbashkëta ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Veprimet do të përqëndrohen në promovimin e shfrytëzimit të planifikuar dhe të bazuar në kërkime, të mineraleve nëpërmjet aplikimit të metodave dhe teknologjive moderne, metoda dhe teknologji që konsiderojnë aspektet dhe pasojat mjedisore. Shembuj të mundshëm që mund të ndiqen në këtë fushë prioritare janë: <ul style="list-style-type: none"> • Studime, kërkime dhe inventar i depozitave minerale të disponueshme dhe ekonomikisht të qëndrueshme • Fushata ndërgjegjësuëse dhe promovuese mbi rezervat minerare ekzistuese dhe nxitjen e investimeve për të tërhequr kompanitë minerare në rajon • Pastrimi i atyre vendeve që paraqesin rreziqe mjedisore • Investimet në infrastrukturën përkatëse - linjat e energjisë, rrugët, etj • Prezantimi i programeve të trajnimit dhe edukimit profesional për industrinë
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Inventarizimi i përfunduar i depozitave të mëdha minerale të rajonit • Program i përpunuar dhe i ekzekutuar i promovimit të Investimeve • Së paku 2 ndërhyrje pilot të realizuara në vendet post-minerare • Programi i hartuar arsimor në bashkëpunim me industrinë dhe në përfitim të saj • Investimet infrastrukturore të kryera në zona ku angazhohen investitorët
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> • Së paku 2 investime të mëdha të kryera në sektorin minierar rajonal • Rritje e sasisë dhe vlerës së mineraleve të prodhuara / përpunuar (me 10%) • Të paktën 300 njerëz të trajnuar për sektorin • Së paku 200 vende të reja pune të krijuara në sektor • Së paku 2 zona post-minerare të rehabilituara
Organizata (t) kryesore për zbatim	Iniciativat këtu janë plotësisht brenda fushëveprimit të aktorëve lokale / rajonale dhe mund të realizohen më mirë nga partneritetet e tyre. Është parashikuar që Qarku do të luajë një rol lehtësues dhe nismëtar në zhvillimin e këtyre partneriteteve së bashku me bashkitë përkatëse. Do të zhvillohet një plan veprimi fillestar. Veprimet specifike sipas këtij plani do të planifikohen dhe zbatohen gjithsesi nga aktorët përkatës, të cilët në varësi të çështjes, ka të ngjarë të përfshijë (projekte) të vogla partneritetesh e aktorëve publike dhe privatë. Kjo është reflektuar tashmë në disa nga project-idetë e hartuara dhe të bashkelidhura me këtë Strategji.

⁴¹ qe kane ekzistuar me pare dhe nuk jane ne funksion tani

Prioriteti 4	Përmirësimi i situatës mjedisore, për një rajon më të pastër paster dhe më të shëndetshëm dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, përfshirë ujin.
Objektivi përkatës strategjik	SO2 - Përmirësimi i mjedisit natyror të rajonit si një aspekt kyç i identitetit dhe atraktivitetit të tij, sidomos duke shmangur të gjitha efektet negative në mjedis përmes aktiviteteve njerëzore SO1 - Rritja e kapacitetit prodhues të ekonomisë rajonale, sidomos në fusha me potencial për gjenerimin e të ardhurave të përgjithshme rajonale
Arsyetimi	<p>Vizioni i rajonit është ai i një rajoni atraktiv i cili gëzon një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Ky nuk është vetëm një prioritet për një cilësi jete më të mirë por është gjithashtu edhe kusht për zhvillim të qëndrueshëm më tej. Duke konsideruar edhe infrastrukturën mjedisore bazike në aspektin e trajtimit të mbeturinave të ngurta, ujërave të zeza dhe madje edhe furnizimit me ujë të pijshëm. Është gjithashtu edhe një çështje shëndeti publik dhe dhe perputhje me rregulloret e BE-së. Mbrojtja mjedisore është përgjithësisht një funksion rregullimi dhe detyrimi për zbatim. Kryesisht është një çështje parimi dhe e qeverisë qendrore. Autoritetet publike që janë pjesë e këtij Partneritetit Rajonal angazhohen, përmes aktiviteteve dhe praktikave të tyre, për përputhje të plotë me të gjitha normat në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në lidhje me këto fusha të cilat shtrihen brenda kompetencave të tyre, sidomos ato të planifikimit fizik dhe dhe kontrollit e lejeve të ndërtimit , partnerët e kësaj strategjie angazhohen për pajtim të plotë dhe zbatim të të gjitha normave ligjore. Një problem i madh është mungesa e vetëdijes qytetare dhe angazhimit në çështjet mjedisore dhe një neglizhencës e përgjithshme ndaj mjedisit qytetarë dhe operatorët ekonomikë. Dihet se kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së sistemit të përshtatshëm të mbledhjes dhe depozimit të mbeturinave: Megjithatë kjo nuk është faktori i vetëm. Është koha për të zhvilluar dhe për të vënë në praktikë një qasje shumë më rigorozë në mbrojtjen e mjedisit. Të gjitha këto çështje qëndrojnë plotësisht brenda fushëveprimit të aktorëve rajonal dhe lokal. Aktualisht nuk ka asnjë bashkëpunim ndërvendor të rëndësishëm në një shkallë rajonale në ndonjë nga këto fusha, të cilat janë gjithsesi funksionet bazë të njësive të qeverisjes vendore. Për këtë arsye, është e nevojshme që në këtë prioritet të përfshihet një nivel i konsiderueshëm i planifikimit dhe organizimit të mëtejshëm si një parakusht për ndërmarrjen e investimeve racionale në shkallën të duhur territoriale dhe të popullsisë. Çështjet kryesore që do të adresohen janë në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjshmëri dhe ndergjegjësim i ulët i komunitetit në lidhje me mjedisin. • Hedhje e grumbullimi i mbeturinave në vende të papërshtatshme dhe jashtë cdo standarti apo kushti të përshtatshëm higjieno-sanitar (psh. në lumenj, liqene dhe përrenj duke ndotur ujrat e tyre) • Nuk ka vend depozitime (vende të caktuara në distanca të përshtatshme dhe me infrastrukturën e duhur) për mbeturinat e rajonit. • Nën-përdorim i burimeve aktuale ujore si një burim energjie dhe miqësor ndaj mjedisit
Qëllimi	<p>Iniciativa për mbrojtjen e mjedisit të natyre pajtueshmërie administrative dhe rregullatore për të siguruar mbrojtje më rigorozë të mjedisit.</p> <p>Ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit, iniciativa edukimi dhe informuese për të adresuar çështjet kyçe të tilla si: hedhja e paligjshme e mbeturinave, shtimi i tyre etj</p> <p>Veprime për të inkurajuar qytetarët për të përmirësuar aspektin fizik të banesave të tyre, veçanërisht në zonat turistike, gara qytetare dhe shpërblime në nivel lokal, konkurse të qyteteve pastra brenda rajonit për kategorit e madhësi të ndryshme të qytetetesh, programe arsimore për nxënës dhe fëmijë për mbrojtjen e mjedisit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe edukim mbi ndryshimet klimatike në të gjithë rajonin</p> <p>Planifikim dhe përgatitje teknike e institucionale, për ngritjen e një strukture të vetme të menaxhimit të mbetjeve në rajon e bazuar në parimet e kategorive të mbeturinave dhe përfshirjen e një sistemi të plotë të mbledhjes së mbeturinave</p>

	<p>Zbatimi i një objekti të vetëm të menaxhimit të mbeturinave brenda rajonit, në përputhje me Strategjinë Kombëtare</p> <p>Planifikim dhe investimet në infrastrukturën hidro-energjitike duke respektuar plotësisht çështjet e mbrojtjes së mjedisit</p> <p>Përcaktimi i planeve të investimit për ujësjellësat dhe ujërat e zeza mbi bazën e bashkëpunimit rajonal, ndër-bashkiak dhe ndër-komunal të bashkërenduar me prioritet lokalitete të biznesit dhe zonta turistike të</p>
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Plan/ strategji e hartuar e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me strategjinë kombëtare • Krijimi i një strukture të përshtatshme që të zotërojë dhe të veprojë (nëse është e nevojshme me koncesion ose forma të tjera të jashtme)si një strukturë e vetme e madhe e menaxhimit të mbeturinave për gjithë rajonin • Mbledhja e duhur / depozitim / dhe pika transferimi, në varësi të planit rajonal të menaxhimit të mbetjeve, themeluar në Kukës, Krumë dhe BajramCurri. 4-5 iniciativa lokale çdo vit për të përmirësuar mjedisin (p.sh. gara ndërmjet qyteteve dhe fshatrave, aktivitete shkollore, etj) • Ndërmarrja e projekteve të furnizimit me ujë 24 orë, për të gjithë vendbanimet me popullsi më të madhe se 4000 • Një i plant trajtimi i ujërave të zeza i ngritur të paktën për Kukës dhe komunat përreth • Eliminimi i aktiviteteve minerare të jashtligjshme në zonat me bukuri natyrore (masa rregullatore)Një plan i gjerë rajonal për zhvillimin e hidro-energjisë dhe ndoshta investime të mëtejshme
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> • Ulje me 50% e vengrumbullimeve të jashtligjshme të mbeturinave • Ulje me 30% e papastërive në lumenj, përrenj e liqene, • Ulje me 50% e shkeljeve të rregullave mjedisore në rajon • Rritje e ndërgjegjësimit të komunitetit (iniciativat vullnetare në qytete e shkolla rritur me 30%, rritje e pemëve të mbjella etj) • Të gjitha qytetet mbulohen nga një sistem i përshtatshëm dhe i mirë organizuar i mbledhjes dhe depozitimit të mbeturinave • Rritja e kapaciteteve të prodhimi të hidro-energjisë
Organizata kryesore për zbatim (t)	<p>Iniciativat këtu janë kryesisht brenda fushëveprimit të aktorëve lokale / rajonale dhe më së miri mund të realizohen nga bashkëpunimi mes tyre. Çështjet për ndërgjegjësimin e publikut janë për tu planifikuar dhe përgatitur së pari në nivel rajonal, nga Partneriteti Rajonal për Mjedisin, i cili thirret thirret nga Qarkun.</p> <p>Në fushat e grumbullimit të mbeturinave dhe menaxhimit të mbetjeve ka nevojë për planifikimin të detajuar dhe përgatitje të zgjidhjeve brenda kuadrit kombëtar rregullator, që tu komunikohet në mënyrë efektive edhe niveleve të ulëta të qeverisjes. Kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit, dhe kur bëhet fjalë për investime specifike, edhe e Ministrisë së Punëve Publike eTransportit. Sidoqoftë, dukeqenese ministrinë nuk zotërojnë dhe me sa duket nuk kanë si qëllim të veprojnë drejtpërdrejt në ndonjë infrastrukturë (ujësjellës, ujërat e zeza dhe mbledhjen e menaxhimin e mbeturinave) është evidente që aktorët kryesorë të zbatimit të zgjidhjeve dhe ofrimit të shërbimeve do të jenë aktorët rajonale dhe lokale.</p> <p>Nevoja për të planifikuar në një shkallë të caktuar territoriale, të paktën në një fazë paraprake, për furnizim me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe mbledhjen e mbeturinave e menaxhimin e vazhdueshëm të tyre, sugjeron se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është i nevojshëm një partneritet rajonal, sidomos me aktorë publik si pjesë e tij, për të identifikuar zgjidhje në këto fusha, dhe në disa raste (p.sh. menaxhimi i mbeturinave) për ti zbatuar ato individualisht • Është i nevojshëm një dialog i vazhdueshëm për këto çështje, me MPPT dhe Ministrinë e Mjedisit, në mënyrë që zgjidhjet rajonale dhe lokale duhet të informojnë dhe të informohen nga politikat dhe strategjitë kombëtare.

	Në këtë aspekt, kjo zonë kërkon një koordinim shumë të fortë vertikale përveç bashkëpunimit rajonal.
--	--

Prioriteti 5	Zhvillimi i kapaciteteve (burimeve njerëzore, institucioneve, sistemeve dhe proceseve) lidhur me menaxhimin e zhvillimit rajonal
Objektivi përkatës strategjik	OS3 - Zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve dhe institucioneve në rajon për të çuar procesin e zhvillimit rajonal përpara
Arsyetimi	Mungesa e shumë kapaciteteve lidur me drejtimin e proceseve të zhvillimit në rajon konfirmohet edhe nga analiza institucionale punuar në kuadër të Projektit PNUD-ISD (2011). Edhe pse rezultatet e zhvillimit të kapaciteteve në qarkun Kukës janë tashmë të dukshme nga pjesëmarrja aktive e aktorëve të rajonit gjatë hartimit të Strategjisë dhe përgatitjes së inventarit të projekteve, ata kanë nevojë të mbështeten edhe më tej, si nga aktorët rajonalë ashtu edhe nga asistencë e jashtme, veçanërisht për sa i përket përgatitjes së inventarit të projekteve, shkrimit dhe menaxhimit të tyre. Investimi në zhvillimin e këtyre kapaciteteve është po aq i rëndësishëm sa investimi në çdo fushë tjetër të rëndësishme për zhvillimin e rajonit. Kjo do të thotë zhvillimin e një "Komuniteti Zhvillimi" më efektiv.
Qëllimi	Veprimet e ndërmarra sipas këtij prioriteti do të fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve për të udhëhequr dhe mobilizuar aktorët rajonale dhe lokale (persona dhe institucione) për të punuar së bashku praktikisht dhe efektivisht. Kjo nuk do të mbulojë çdo kapacitet të mundshëm të zhvillimit, por kufizohet kryesisht në veprimet e zhvillimit të kapaciteteve dhe të liderit. thelbësore për të çuar më tej zbatimin e kësaj Strategjie. Shembuj të veprimeve të mundshme që do të ndiqen në këtë fushë prioritare janë:: <ul style="list-style-type: none"> • Forcimi i strukturave dhe burimeve minimale për të siguruar zbatimin e kësaj Strategjie të Zhvillimit Rajonal në vazhdimësi, udhëheqje komunikim, stimulum, monitorim dhe zhvillimi projektsh • Zhvillimi i strukturave minimale (p.sh. mekanizmave bashkëpunues) dhe burimet për të siguruar një zhvillim të vazhdueshëm të turizmit, produktit dhe marketingut, me qëllim rritjen e cilësisë, marketingut dhe shitjeve në fushat e bujqësisë (përpunimin fillestar) dhe prodhimit të ushqimit, ndërgjegjësim dhe sensibilizim në lidhje me kërkesat e përfitimeve ekonomike dhe sociale të projekteve të infrastrukturës, menaxhimit të përshtatshëm mjedisor, • Zhvillimi i partneriteteve rajonale për shëndetin publik dhe edukimin. • Asistencë teknike, konsulenca, këshillime, trajnime, dhe forma të tjera të ndërtimit të kapaciteteve
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Së paku një aktivitet trajnimi në vit për të krijuar një bashkëveprim të njerëzve për të luajtur një rol aktiv në proceset e zhvillimit në fushat prioritare të strategjisë dhe projekteve rajonale të zhvillimit
Rezultatet	<ul style="list-style-type: none"> • Personel i administratës publike dhe OJF-ve, i trajnuar në hartim strategjish, shkrim dhe menaxhim projektsh (50 persona) • Rritje e bashkëveprimit dhe rrjetëzimit të aktorëve rajonalë të zhvillimit me qëllim shkëmbimin e ideve, njohurive, eskperiencape dhe ndarjen e roleve e përgjegjësi sipas fushave të zhvillimit (5 projekte të përbashkëta) • Rritje e nismave të bashkëpunimit ndër-vendor dhe modeleve të tjera të partneritetit, për një ofrim më eficient të shërbimeve publike dhe rritjes së përfitimeve ekonomike të territoreve përkatëse (5 kontrata ose Memorandume Bashkëpunimi)
Organizata kryesore (t) për	Iniciativat këtu janë plotësisht brenda bashkëveprimit të aktorëve lokalë/rajonalë dhe mund të realizohen më së miri nga ana e tyre. Qarku do të luajë një rol lehtësues dhe iniciues në

zbatim	zhvillimin e shumë prej këtyre partneriteteve. Bashkitë kanë një rol të madh praktik pasi që ata janë de facto aktorët kryesorë publikë për zbatimin e shumë prej veprimeve përkatëse. Format e bashkëpunimit ndër-bashkiake, bashki-komune dhe qark-bashki/komunë janë parashikuar të gjitha në këtë prioritet dhe të tjerat lidhur me të. Partneritetet e sugjeruara do të përfshijnë në shumë raste domosdoshmërisht edhe OJQ-të dhe subjektet e tjera të zhvillimit. Dihet se procesi i pjesëmarrjes është thjesht vullnetare dhe do të ketë organizata që nuk do mundën ose nuk do të të përfshihen në fazat fillestare.
Veprimet kyce përgatitore dhe vendimet e kërkuara	Secilit partneritet të krijuar do ti akordohet mbështetje e kufizuar administrative nga administrata qarku dhe të caktohet një person për të lehtësuar çdo partneritet të paktën në fazat fillestare. Organet e tjera publike (p.sh. bashkitë) mundet gjithashtu ti drejtojnë këto partneritete në marrëveshje me qarkun. Partneritetet janë kuptuar, të paktën fillimisht, si koalicione vullnetare të gatshëm. Në pothuajse të gjitha rastet ata do të përpunojnë një plan veprimi të thjeshtë për të drejtuar punën e tyre. Marrëveshjet fillestare të punës do të miratohen për një periudhë prej 12 muajsh, subjekt rishikimi. Në këtë kuptim, qasja është eksperimentale dhe progresive.

Prioriteti 6	Zhvillimi i njerëzve
Objektivi përkatës strategjik	OS4 – Të zhvillojë kapacitetet e popullsisë së rajonit me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme të përfshirjes sociale, drejtësisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët në mënyrë që të marrin pjesë në ekonomi dhe shoqëri
Arsyetime	<p>Analiza tregon situatën relativisht të pasigurt të shumë personave dhe komuniteteve në të gjithë rajonin në aspektin e kapaciteteve që ato kanë për të siguruar një jetesë të përshtatshme për veten dhe familjet e tyre dhe të një niveli të përshtatshëm të mundësisë për të përmbushur potencialin e tyre njerëzor dhe shoqëror. Sigurisht që ekonomia rajonale, relativisht e dobët, është një problem që kufizon pjesëmarrjen sociale dhe tregun e punës, por është gjithashtu e vërtetë se niveli i përgjithshëm i aftësive është relativisht i ulët dhe shumë pak i përshtatur me tregun aktual dhe të ardhshëm të punës. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i personave - sidomos ata që jetojnë në zonat periferike rurale - janë në një situatë të rëndë të pambrojtur, të varfër dhe marginalizimit. Një numër i konsiderueshëm oor akoma jo saktësisht i njohur, i personave punojnë në ekonominë joformale që karakterizohet nga nivele aftësie të ulëta dhe asnjë trajnim formal apo mundësitë arsimore.</p> <p>Niveli aktual i pjesëmarrjes në edukimin dhe formimin profesional duket se është i ulët, sepse nuk është tërheqës apo nuk përmbush nevojat e tregut të punës. Ka evidenca që tregojnë se një numër i madh i studentëve vazhdojnë arsimin universitar jashtë rajonit, duke përfshirë këtu edhe universitetet private, kapaciteti i të cilëve për të siguruar një edukim të vlefshme mund të jetë disi i dobët.</p> <p>Nuk duket se ka asnjë program në rajon që të integrojnë personat në tregu punës, jashtë sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional. Kjo shtron pyetjen se si një person me nivel të ulët edukimi apo me ndonjë paaftësi shoqërore mund të shpresojë ndonjëherë që të zhvillojë aftësi minimale që ti mundësojë atyre të gjenë një punë ose një trajnim të mëtejshëm. Në këtë kuptim, nuk ka de fakto praktikat aktive të tregut të punës në rajon.</p> <p>Në forcën e punës, në të gjithë sektorët, nivelet e aftësisë janë përgjithësisht në fund të zunxhirit të njohurive. Gjithnjë në ekonominë moderne burimet njerëzore janë konsideruar si kryesore për mundësimin e rritjes dhe zhvillimit. Ndërsa mund të duket në rrethana veçanërisht të vështira ekonomike, shumë persona të kualifikuar ndjekin pak pozicione pune, është po aq e vërtetë se njohuritë dhe aftësitë e pamjaftueshme pengojnë të gjitha format e sipërmarrjes, pengojnë rritjen dhe zhvillimin, dhe vecanërisht pengojnë investimet. Balancimi dhe sinkronizimin i aftësive për zhvillim me kërkesat e gjera ekonomike, është alternativa e vështirë por edhe më e përshtatshme për tju kundërpërgjigjur rënies së arsimimit, aftësive dhe trajnimit.</p> <p>Një numër fushash kyçe tërheqin vëmendjen. Disa prej tyre janë pa dyshim një funksion</p>

	<p>kombëtar politik dhe nismëtar më tepër sesa rajonal apo lokal, por sidoqoftë disa prej tyre nuk mund të adresohen, të paktën deri në një farë mase, pa përpjekjet rajonale dhe lokale. Sfidat më të mëdha duket se janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoritë e rrezikuara në rajon jo gjithmonë të integruara në jetën social-ekonomike të vendit • Cilësi e ulët e shërbimeve parësore dhe spitalore dhe infrastrukturave përkatëse • Përmirësimi i atraktivitetit dhe cilësisë së përgjithshme të programeve dhe kurseve brenda sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional për të siguruar nivele të larta të cilësisë së konkurentëve (kjo është ngushtësisht e varur nga politika kombëtare) • Adresimi i problematikave të përfshirjes sociale veçanërisht në lidhje me personat e rinj, niveli i përjashtimit të të cilëve, parandalon integrimin e tyre në sistemin e Arsimit dhe Formimit Profesional. • Zhvillimi i një qasje më aktive të tregut të punës në drejtim të orientimit të personave të papunë ose të marginalizuar drejt një pune ose arsimit dhe formimit profesional (kjo varet fuqimisht nga politika kombëtare) • Sigurimi i angazhimit nëpërmjet menaxhimit (trajnimet në ndërmarrje) si një mjet për të rritur produktivitetin, forcimin e burimeve njerëzore dhe përfitimin më të mirë nga stafi • Zhvillimi strategjive dhe qasjeve vetë-ndihmuese në komunitetet e prapambetura, të karakterizuar nga nivele të larta të varfërisë
Qëllimi	<p>Qëllimi zërthehet në aktivitetet e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i partneritetit rajonal të arsimit, punësimit dhe aftësive i cili përfshin ofruesit kryesorë të arsimit dhe formimit profesional, zyrat e punës, shërbimet sociale dhe drejtoritë e këtyre të fundit,, përfaqësuesit e sektorit të arsimit fillor dhe para-fillor, arsimit të mesëm dhe atij universitar (nëse është relevante) (Prioriteti 1), përfaqësuesit e punëdhënësve dhe sindikatat. • Hartimi nga ana e Partneritetit rajonal të mësipërm, i planit të veprimit të "Edukimit punësimit, aftësive dhe mundësive 2012-2020" përfshin angazhime të veprimit nga ana e organizatave përkatëse. Fokusi i tij duhet të jetë sigurimi i rrugëve rrugëve cilësore nëpërmjet sistemeve të arsimit dhe trajnimit të lidhura me kërkesat e tregut të punës dhe aspiratat e qytetarëve në aspektin e mësimin dhe zhvillimit, rekrutimit, punësimit dhe përmirësimin e praktikave të menaxhimit të njerëzve • Planifikimi, përgatitja dhe zbatimi nga zyrat e punës në bashkëpunim me partnerët relevantë, të iniciativave pilote për të adresuar nevojat e personave në nevojë për trajnime, por përtej mundësive të sistemit të AAP • Programe trajnimi brenda kompanive të përfunduara dhe të dokumentuara, si praktika të mira • Zhvillimi si projekt pilot i një qasjeje këshillimi për punë të punëkërkesve, në një përputhje me parimet e zhvillimit profesional
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Plan veprimi 2012-2020 i Arsimit, punësimit aftësive dhe mundësive • 3 nisma pilote për të adresuar nevojat e personave në nevojë për trajnim, por përtej mundësive të sistemit të AAP • 3 programe trajnimi brenda kompanive të dorëzuara dhe dokumentuar si praktika të mira • Një nismë pilot këshillimi profesional, drejtuar punëkërkesve

Rezultatet	<p>Rezultatet janë hartuar nga pikëpamja cilësore meqenëse kërkohet më tej një punë e konsiderueshme nga aktorët rajonale për të përcaktuar më mirë problemet dhe çështjet kyçe dhe për të identifikuar përfitimet dhe përmirësimet kryesore që janë të nevojshme për aktorët rajonale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkallë pjesëmarrjeje e përmirësuar e moshës mbi 18 vjec në Arsimin dhe formimin Profesional (me 20% deri në 2016) • Përqindja të papunëve që u është ofruar orientim dhe këshillim - 20% (nga baza e supozuar - 0%) • 500 punonjësit kanë marrë një trajnim të certifikuar • 5 iniciativa vetë-ndihmuese të ndërmarra në komunitetet më të privuara
Organizata kryesore zbatim	<p>(t) Fushat e mbuluara nga ky Prioritet janë thelbësore për suksesin dhe mirëqenien e ardhshme të rajonit dhe qytetarëve të saj. Është e vërtetë se në Shqipëri ashtu si edhe në vende të tjera, politikat kombëtare duhet të sigurojnë korniza të hollësishme brenda së cilës mund të planifikohen veprime. Në të vërtetë, në shumë vende mekanizmi ofrimit për këtë fushë është vetëm kombëtare, por shpesh përfshin edhe organet e dekoncentruara shtetërore në rajon. Ka dy opsione në këtë drejtim: ose shteti ngre agjenci të fuqishme ofrimit ose shteti lehtëson dhe inkurajon zhvillimin e mekanizmave nga poshtë-lart për të ofruar veprime brenda për brenda një kornize politike të shtrënguar dhe të bazuar në standarte. Është sugjeruar në këtë prioritet që qasja e dytë është më shumë e zbatueshme në Shqipëri. Në qoftë se është ky rasti, atëherë partneritetet e ndryshme duhet të mbështesin dhe të angazhohen tashmë. Prandaj organizatat drejtuese për këtë prioritet do të jenë, në varësi të temës dhe zonës së saktë: zyrat e punës dhe strukturat përgjegjëse për AFP. Megjithatë ata do të angazhohen dhe nxisin zgjidhje praktike nga organizatat partnere, në gjendje të propozojnë dhe pilotojnë zgjidhje (psh. organizatat e punëdhënësve , punëdhënës të veçantë, sindikatat, dhomat e tregtisë etj).</p>
Veprimet kryesore përgatitore dhe vendimet kërkuara	<p>Partneriteti ka nevojë të hartojë një plan të thjeshtë veprimit të fokusuar në fushat kryesore që ajo mendon se mund ti kontribuojnë objektivave prioritare.</p>

Prioriteti 7	Mbrojtja e Shëndetit
Objektivi përkatës strategjik	OS5 – Të sigurohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore të përshtatshme dhe cilësore që sigurojnë shëndet të mirë dhe mirëqenie për qytetarët
Arsyetimi	<p>Në Shqipëri, si në shumicën e vendeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, sistemi i shëndetit publik është një kompetencë e qeverisë kombëtare. Brenda rajonit, drejtoritë e ndryshme të shëndetësisë për qarkun, pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë në Tiranë, kanë disa përgjegjësi të caktuara operative dhe administrative. Ashtu si edhe në pjesën tjetër të vendit, sistemi shëndetësor është përbërur me nevojën për tu përgjigjur në mënyra më efikase dhe efektive, të krahasueshme me vendet e tjera evropiane dhe për të lëvizur nga sistemi I vendosur para vitit 1991. Kjo nënkupton një shkallë të caktuar racionalizimi, reduktimin e disa shërbimeve të caktuara (sidomos ato spitalore të përgjithshme apo kujdesin gjatë natës) dhe zgjerimin e formave të ndryshme jo-spitalore në komunitet. Ndërsa politika dhe strategjia e përgjithshme është kombëtare, ekziston një nevojë e qartë për të rikonfiguruar kujdesin primar, spitalor dhe të komunitetit duke marrë parasysh shpërndarjen rajonale hapësinore të popullsisë. Ky lloj i rikonfigurimit nuk të mund të bëhet ekskluzivisht as nga qendra e as në nivel local Në praktikë shërbime të caktuara do të duhet të ri konfigurohen dhe shkallëzohen në bashki dhe komuna. Rajoni mund të përgjigjet dhe ta ndihmojë këtë proces nëpërmjet informimit gjë që po</p>

	<p>zhvillohet edhe në shumë vende të tjera në Ballkan dhe në Evropën Qendrore e Lindore, duke formuar një partneritet rajonal shëndetësor të bashkive dhe grupeve kryesore të komunave, që thirren nga qarku dhe drejtorja e shëndetësisë. Brenda parametrave të përgjithshme të politikës dhe strategjise të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ky partneritet mund të propozojë një konfigurim racional për nivele të ndryshme të kujdesit shëndetësor, nga ai parësor dhe më lart, duke marrë parasysh realitetet e ndryshme që lidhen me patologjitë e ndryshme dhe grupet e synuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analiza tregon se sëmundjet koronare të zemrës mbeten problem kryesor për shëndetin në rajon. Ashti si dhe në vende të tjera, ky është pjesërisht një problem jetese që mund të adresohet dhe parandalohet përmes vetëdijes dhe informimit. Kjo është një zonë e madhe për ndërhyrje në drejtim të ndërgjegjësimit nga drejtoritë e shëndetit public. Meqenëse kjo fushë politike është kryesisht kombëtare, ka pasur një tendencë nga rajoni për të mos u përfshirë. Një hap i parë i madh për të siguruar një fokus nga "poshtë lart" të politikës kombëtare të kujdesit shëndetësor siç është zbatuar në rajon, është krijimi i një Partneritet Shëndetësor Rajonal (shiko Prioriteti 1) dhe përpunimi i një plani veprimi realist që mund të zbatohet nga partnerë të ndryshëm. Natyrisht fokusi i kësaj do të duhet të jetë kryesisht në ato elemente që aktorët rajonale dhe lokale mund të zbatojnë të vërtetë, edhe pse mund të përmbajë propozime që mund të informojnë politikën kombëtare si të vendoset në rajon.
Qëllimi	<p>Qëllimi i aktiviteteve përcaktohet nga ajo që parashikohet më qartë në kompetencat praktike të institucioneve publike në rajon dhe që po ashtu përbën një shqetësim të madh për qytetarët e rajonit. Shembuj të veprimeve që mund të parashikohen në këtë prioritet janë: Hartimi i një Plani Veprimi Shëndetësor Rajonal, nga Partneriteti Rajonal i Shëndetësisë që fokusohet në fushat kryesore ku aktorët rajonale dhe lokale kanë një rol të rëndësishëm për të për t'ju përgjigjur çështjeve të kujdesit shëndetësor (p.sh. racionalizimi dhe ri-organizimin i ofrimit të kujdesit shëndetësor në nivele të ndryshme); Iniciativat të kujdesit shëndetësor bazuar kryesisht në informim dhe vetëdij, informacioni dhe ndërgjegjësim në lidhje me çështje të veçanta të tilla si kujdesi shëndetësor para lindjes dhe pas lindjes, mënyrë jetese e shëndetshme (fushatat anti-duhan dhe alkool, etj) dhe patologjitë kyçe të tilla si sëmundje koronare të zemrës, etj)</p>
Produktet	<ul style="list-style-type: none"> • Një plan veprimi rajonal, shëndetësor i hartuar dhe zbatuar nga Partneriteti Shëndetësor Rajonal dhe anëtarë të saj • Propozime për të siguruar një akses të përshtatshëm në kujdesin parësor për të gjithë qytetarët në rajon • Propozime për të siguruar akses të përshtatshëm nga pikëpamja kohore, të udhëtimit dhe mënyrave të transportit për të gjithë qytetarët, drejt spitaleve, e njësive të emergjencës • Të paktën 4 nisma shëndetësore informimi dhe ndërgjegjësimi •
Rezultatet	<p><i>Rezultatet janë hartuar nga pikëpamja cilësore meqenëse kërkohet më tej një punë e konsiderueshme nga aktorët rajonalë për të përcaktuar më mirë problemet dhe çështjet kyçe dhe për të identifikuar përfitimet dhe përmirësimet kryesore që janë të nevojshme për aktorët rajonalë</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i bazës shëndetësore të qytetarit dhe pacientit për racionalizimin e kujdesit shëndetësor • Rritja e vetëdijes në lidhje me patologjitë kyçe dhe rreziqet shëndetësore, veçanërisht të grupeve të rrezikuara

Organizata kryesore për zbatim	(t)	Partneriteti ka nevojë për të krijuar një plan të thjeshtë të veprimit të fokusuar në fushat kryesore ku ajo mendon se mund tu kontribuojë objektivave prioritare.
--------------------------------	-----	--

Prioriteti 8		Aksesibilitet rritur (rritje e numrit të rrugëve dhe përmirësimi i kushteve të tyre), sidomos në zonat e largëta periferike të rajonit
Objektivi Strategjik përkatës		OS4 – Të zhvillojë kapacitetet e popullsisë së rajonit me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme të përfshirjes sociale, drejtësisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët në mënyrë që të marrin pjesë në ekonomi dhe shoqëri
Arsyetimi		Teoria ekonomike tregon se distanca nga tregjet dhe qendrat kryesore përbën pengesë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik në rajonet me akses të dobët. Realiteti aktual në rajon tregon se koha së udhëtimit është tepër e gjatë dhe infrastruktura e dobët dhe jo cilësore, me përjashtim të aksit kryesor të autostradës Tiranë-Prishtinë. Ka ende disa rrugë në kushte tejet të këqija që lidhin vendbanimet periferike, dhe kohët e gjata të udhëtimit në to bëhen penguese të ndërveprimeve ekonomike dhe sociale. Çështjet kryesore që do të adresohen janë rrjeti i brendshëm rrugor që ka nevojë për përmirësime madhore.
Qëllimi		<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi, analizimi i rrugëve dhe prioritizimi i rrugëve rajonale dhe lokale me rëndësi për të ardhmen e biznesit dhe zonat e zhvillimit të turizmit • Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rajonale dhe lokale me një përparësi ndaj atyre të rëndësishme për biznes dhe turizëm • Identifikimi dhe mbrojtja e tokës për rrjetin e ardhshëm rajonal të transportit dhe kërkesat infrastrukturore, duke përfshirë kërkesat e rezervave të mëdha rrugore dhe korridoreve të transportit publik • Përmirësimi i efikasitetit, sigurisë dhe integrimin e rrjetit të rajonit transportit nëpërmjet zhvillimit të koordinuar të gjitha llojet e transportit, • Rritje e funksionalitetit dhe shfrytëzimin e rrjetit ekzistues publik të rajonit përmes infrastrukturës së transportit të shpejtë, të shpeshtë dhe të besueshëm mbi-rrugor dhe shërbimeve të lidhura me të. • Rritja e përdorimit të qëndrueshëm të alternativave personale dhe komunitare të transportit, duke i dhënë prioritet çiklizmit dhe opsioneve të tjera të sigurta. • Rrugët kombëtare që lidhin rajonin me rajone të tjera dhe pjesë të Shqipërisë, <p>Të gjitha investimet e propozuara duhet të jenë subjekt i analizave të kërkesës të cilat do të mundësojnë më pas një analizë më të gjerë ekonomike dhe sociale të projekteve të propozuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> •
Produkte		<ul style="list-style-type: none"> • Të paktën 100 km rrugë kombëtare/rajonale dhe lokale të rehabilituara
Rezultate		<ul style="list-style-type: none"> • Reduktimi i kohës së udhëtimit midis qendrave të NJQV-ve me të paktën 30%
Organizata kryesore për zbatim	(t)	Në sistemin e tanishëm të qeverisjes është MPPT ekskluzivisht përgjegjëse për rrugët nacionale. Në këtë drejtim, rajoni mundet vetëm të artikulojë nevojën për investime të veçanta. Sa i përket rrugëve rajonale infrastruktura është nën administrimin e këshillit të qarkut, ndërsa rrugët lokale i përkasin bashkive dhe komunave. Për këto arsye, roli i aktorëve rajonale është kryesisht për të formuluar dhe prioritizuar nevojat koherente, bazuar në analizën e kërkesës duhur. Sipas prioritetit të parë një veprim mbi kapacitetet është parashikuar për të rritur

		ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin në lidhje me kërkesat ekonomike dhe sociale të përfitimeve të projekteve të infrastrukturës. Kjo është e nevojshme të theksohet meqenëse është e qartë se jo të gjitha rrugët në rajon mund të rehabilitohen në afat të mesëm, prandaj nevojitet një prioritarizim transparent, bazuar në kërkesën që plotësojnë projektet.
Veprimet përgatitore dhe vendimet kërkuara	kyce dhe e	Do të ishte e dobishme në qoftë se Partneritetit Rajonal përgjegjës për zbatimin e kësaj Strategjie mund të hartojë një listë prioritare të investimeve rrugore kombëtare dhe rajonale të kërkuara në rajon, bazuar në kërkesë. Në raste të veçanta, kjo duhet të marrë parasysh edhe zgjerimet që po planifikohen në fusha të veçanta për biznes apo turizëm.

6. Burimet e nevojshme

Vizioni, prioritetet dhe projektet e vecanta (në shtojcën e kësaj Strategjie) nuk mund të zbatohet pa identifikuar dhe vënë në dispozicion burimet specifike. Shumë nga këto janë lehtësuese ndërsa disa janë edhe institucionale. Prioriteti parë identifikon masat për kapacitetet institucionale që do të kërkohen dhe janë duke u zhvilluar tashmë brenda rajonit. Megjithatë ekziston një nevojë për mbështetje të caktuar institucionale në një nivel më të lartë e cila do të lehtësojë procesin e zhvillimit në këtë rajon dhe të tjera gjithashtu. Ne identifikojnë dhe përshkruajnë këto më poshtë. Në ato zona ku janë të nevojshme përpjekje të rëndësishme rajonale ose përpjekje të bashkërenduara rajonale, ka nevojë për një mekanizëm koordinues dhe komunikues vertikal mes partneriteteve rajonale dhe agjencive të veçanta dhe aktorëve në nivel kombëtar. Në mungesë të tyre, ato fusha që kërkojnë bashkëpunim rajonal-kombëtare, do të jenë subjekt mosfunksionimi në planifikimin dhe implementimin. Më poshtë janë listuar fushat kryesore ku kjo është e nevojshme, urgjentisht:

- Rrugë rajonale
- Manaxhim I mbetjeve të ngurta
- Trajtimi I ujerave të zeza
- Mbrojtje mjedisore
- Formim dhe arsim profesional
- Turizëm– marketing ndërkombëtar (për tu lidhur me përpjekje rajonale marketinu), akomodim (sidomos, certifikim)
- Promovim I Biznesit Ndërkombëtar (për tu lidhur me përpjekje rajonale promovimi të biznesit si psh, faqe ëeb, etj)
- Sigurimi I vendeve/zonave të biznesit (kërkohet koordinim dhe bashkëpunim midis Ministrisë së Ekonomisë, AIDA-s dhe Qarkt/NJQV-ve.)

Ndërkohë që mund të ketë edhe fusha të tjera, të mësipërmet duket se kërkojë një mekanizëm të komunikimit të rregullt / koordinimit / bashkëpunimit. Për momentin ka një boshllëk për sa i përket bashkëpunimit vertical të efikas. Ne I bëjmë thirrje qeverisë ta adresojë këtë çështje sa më shpejt të jetë e mundur.

Strategjia në këtë pikë fillestare nuk është e financuar plotësisht. Në fakt financohet minimalisht nga kontributet e drejtpërdrejta të Qarkut dhe bashkive e komunave që e përbëjnë atë. Disa nga përpjekjet e zhvillimit mund të adresohen pa shpenzime të konsiderueshme financiare. Megjithatë është evidente që ka nevoja financiare që duhet të mbështeten:

- Zhvillimi I kapaciteteve institucionale për zhvillim (Prioriteti 1)
- Përgatitjet e vazhdueshme të nismave specifike dhe projekteve (Prioritetet 2-7) - veçanërisht projektet që aktualisht konsiderohen të jenë "ide të vlefshme dhe të mundshme " (b.lidhur strategjisë), dhe për të ciat ne jemi duke punuar dhe kemi nevojë emergjente për burime financiare (për studime, konsulence etj) për ti sjellë ato në një fazë gatishmërie të plotë
- Implementimi i projekteve të zhvillimit dhe të investimeve sic jepet në inventarin e projekteve b.lidhur strategjisë

Këshilli rajonal shikon instrumentat dhe organizatat e mëposhtëme për të asistuar në këto çështje:

- Fondi i Zhvillimit Rajonal - i fokusuar të paktën edhe pjesërisht në të ashtuquajturat "projekte rajonale", të përcaktuara si të tilla sipas termave të angazhimit, ndikimit dhe partneritetit të punë
- Donatorët ndërkombëtarë - veçanërisht ato të angazhuar për qeverisjen rajonale dhe lokale dhe zhvillimin e tyre
- BE – me gjithë fokusin e ashtuquajtur "kombëtar" dhe mbi projekte të mëdha, nuk mund të zbatohet (të paktën në fusha të tilla si ajo e mjedisit dhe zhvillimin të biznesit) në mungesë të mbështetjes në nivel rajonal (zhvillimin e kapaciteteve, zhvillimin e projekteve, investimet)

7. Menaxhimi

Përgjegjës për të siguruar zbatimin e Strategjisë dhe projekteve është këshilli i qarkut. Çdo dy vjet Qarku do të marrë një raport mbi zbatimin e secilit nga prioritetet dhe strategjinë në përgjithësi, duke përfshirë çdo vonesë, probleme apovështirësi të tjera. Ai do të kërkojë gjithashtu informacion në mënyrë të vazhdueshme, do të bëjë rekomandime dhe do të marrë vendime relevante në lidhje me strategjinë. Këshilli rajonal do të diskutojë Partneritetin Rajonal të vendosur në të gjitha vendimet strategjike të zhvillimit.

Funksionet e manaxhimit të Strategjisë do të organizohen në mënyrën e mëposhtme:

- **Monitorimi Operacional** - Departamenti i Zhvillimit të Qarkut do të sigurojë sisteme të përshtatshme për të monitoruar dhe raportuar progresin në zbatimin e Strategjisë. Kjo do të përfshijë një raport mbi secilin prioritet në baza tremujore, sipas treguesve të synuar. Do të mbledhë informacione, do lidhet me palët e interesuara dhe në këtë mënyrë do të ofrojë raporte të rregullta dhe sipas kërkesave (6 mujore) mbi zbatimin e secilit prej prioriteteve
- **Inventari i Projekteve** - Departamenti i Zhvillimit të Qarkut do të administrojë inventarin e projekteve që është ngritur. Ai do të raportojë dhe do të ofrojë mbështetje praktike dhe ndihmë nëpërmjet Programeve të përshtatshme rajonale të zhvillimit të projekteve. Ky është një inventar (portofol të projekteve rajonale) që në çdo kohë rajoni po e çon përpara drejt financimit dhe zbatimit. Për të siguruar këtë, ai do të jetë pro-aktiv në lidhjen me aktorët lokal dhe kombëtar
- **Informimi dhe Komunikimi** - Departamenti i Zhvillimit të Qarkut do të mbajë një faqe interneti të dedikuar për "Zhvillim Rajonal". Kjo do të sigurojë në vazhdimësi informacion të gjithë aktorëve të zhvillimit në rajon, përfshirë Strategjinë, shumicën e raporteve më të fundit në Këshillin e Qarkut, si dhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm në ndjekje të zhvillimit rajonal. Ai gjithashtu do të menaxhojë një seksion të veçantë në lidhje me "promovimin e biznesit" në të cilën rajoni dhe pasuritë e saj do të shfaqen dhe promovohen për investitorët e brendshëm apo të jashtëm.
- **Mbështetje për Këshillin e Qarkut në ndjekje të Zhvillimit Rajonal:** Departamenti i Zhvillimit të Qarkut do të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme sekretariale dhe administrative për Këshillin Rajonal në lidhje me zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Rajonal
- **Koordinimi i Donatorëve:** Departamenti i Zhvillimit të Qarkut do të sigurojë që Këshilli i Qarkut mbahet i informuar për aktivitetet dhe qëllimet e donatorëve në Shqipëri, duke përfshirë çdo mundësi të mundshme në zhvillim.

Aneks 1 – Projekte Prioritare

Projektet prioritare janë veprime reale të cilat synojnë të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike rajonale. Lista e projekteve që mbështetësin direkt i Strategjinë do të azhurnohet me vendim

të Këshillit të Qarkut kur të jetë e nevojshme, në mënyrë që një inventar projektësh të ketë mundësinë të zhvillohet vazhdimisht

Projekti: Zhvillim i Qendrueshem Permes Qasjes ne Informacion		
<u>Objektivat:</u>		
<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i nje baze te dhenash me informacion gjithepershires, lehtesisht te aksesueshem. • Ofrimi i informacionit sa me te sakte dhe sa me shpejt per aktoret e interesuar • Lehtesim i proceseve te hartimit te politikave dhe strategjive, permes informacionit te aksesueshem lehte dhe ne kohe reale 		
<u>Justifikimi i projektit:</u>		
<p>Ky projekt eshte ne perputhje jo vetem me Strategjine e Zhvillimit Rajonal te Kukesit, por eshte dhe mjet i nevojshem per implementimin e saj. Nevoja per informacion shfaqet ne do fushe (turizem, miniera, ekonomi) per aresye nga me te ndryshmet. Ky projekt, i vjen ne ndihme te gjithë aktoreve qe kane kerkese per informacion te cilet jane dhe grupet perfituese te ketij projekti, ku perfshihen: Turistet, Bizneset, OJF-te dhe OJQ-te, donatoret, nxenes, studente, mesues, institucione te ndryshme, komuna dhe bashki, komuniteti. Dhenia e informacionit permes raporteve (te gjeneruara nga baza e te dhenave) do behet ne nivele te ndryshme sipas nevojave dhe kerkesave</p>		
<u>Rezultatet:</u>	<u>Produktet:</u>	<u>Aktivitetet:</u>
<ul style="list-style-type: none"> • Informacioni eshte i mbledhur dhe i perpunuar dhe lehtesisht i aksesueshem per gjithë publikun e interesuar • Koha e marrjes se informacionit nga perdoruesit finale eshte ulur ndjeshem • Saktesia e informacionit te marre eshte rritur shume 	<ul style="list-style-type: none"> • Nje database me informacion gjithepershires • Raporte te niveleve te ndryshme • Informacione statistikore • Manuali i perdorimit dhe rregullave te sigurise 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimii fushave qe do popullohen me informacion dhe institucionet perkatese • Percaktimi imarrevshjes me partneret per shkembimin e informacionit • Grumbullimi paraprak i te dhenave dhe strukturimi i tyre • Pergatitja e struktures se menaxhimit dhe mirembajtjes se databazes • Pergatitja e nje procedure per perditesimin e databazes dhe popullimin me informacion • Popullimi me te dhena dhe krijimi i aplikacioneve per afishimet ne EEB

<u>Partnerët dhe kontakte:</u> Keshilli i Qarkut Kukës; Vladimir LUSHI +355 662066461 vladimir.lushi@kqk.gov.al Prefektura Kukës; Shkelqim OULLA +35524 222378 shkelqimdulla@gmail.com
Vlera totale e projektit - 58.529 Euro Financimii kerkuar nga jashte - 49.750 Euro Buxheti(koha) per projekt propozimin e plote - 1.000 Euro (2 muaj)

Projekti: Evidentimi dhe Rehabilitimi i Mbetjeve Sterile dhe Karrierave si Rezultat i shfrytezimit te Mineraleve ne Qarkun e Kukësit		
<u>Objektivat:</u> <ul style="list-style-type: none"> Njohja e gjendjes aktuale si rezultat i shfrytezimit te mineraleve ne qarkun Kukës Perpilimi i raportit teknik per zgjidhjen e problemeve. Kthimi i zonave te demtuara nga veprimtaria minerare ne zona anti-ndotje ne mjedisin rrethues. 		
<u>Justifikimi i projektit:</u> Situata e krijuar nga shfrytezimi i mineraleve para viteve 1990 ne Gjegjan dhe shfrytezimi i rerave karbonatike ne komunën Bicaj eshte e rende. Pas ndryshimit te sistemit ne keto dy vendburime u krijuar nje gjendje shume negative me pasoja te medha mjedisore. Gjendje e tille u krijuar edhe si rezultat i krijimit te damkave sterile te skorjes se Uzines se shkrirjes se bakrit Rexhepaj - Komuna Shtiqen e cila ndikon ne ndotjen e ujerave te Liqenit te Fierzes. Problem shqetesues eshte shfrytezimi pas viteve 1997 dhe ne vazhdim nga persona te pa liqensuar te zonave mineral-mbajtese ne Qarkun tone		
Rezultatet:	Produktet:	Aktivitetet:
<ul style="list-style-type: none"> Banoret e zonave te nderhyrjeve jetojne ne kushte me te mira mjedisore dhe sigurie Qeverisja Qendrore dhe ajo lokale kane informacionin e duhur per nderhy e rehabilituese Bizneset ne fushen minerare jane sensibilizuar per mbrojtjen e mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i projektit per fazen e pare. Evidentimi i zonave te demtuara. Rehabilitimi i nje pjese te zones se shfrytezuar te mineralit te bakrit nepermjet pyllezimeve, etj. – Shtiqen Ndertimii rezervuarit vadites ne Bicaj 	<ul style="list-style-type: none"> Ekspedita dhe vrojtime ne terren per njohjen e siperfaqeve te demtura Analizim i fakteve te marra ne terren Takim me grupet e interesit. Perpilim i projekteve per zonat me priotare te demtuara Fushate per sensibilizimin kompanive te liqensuara per mbrotjen e mjedisit ne zbatim te legjisacionit ne fuqi
<u>Partnerët dhe kontakte:</u> Keshilli i Qarkut Kukës; Besnik Axhami; +355672786916; axhami.besnik@yahoo.com ARM Kukës; Petrit Peposhi; +355682147259; petritpeposhl@yahoo.com		
Vlera totale e projektit - 39.900Euro		

Financimi i kerkuar nga jashte - 35.000 Euro
 Buxheti(koha) per projekt propozimin e plote - 2.000 Euro (6 muaj)

<p>Projekti: Sistemimi i Bregut te Liqenit dhe Pershtatja ne Pike Turistike</p>		
<p>Objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kthimi i kesaj bukurie natyrore ne sherbim te rajonit, pasja e nje ambjenti te paster, te bukur, çlodhes dhe mbi te gjitha kthimi ne nje destinacion turistik. • Kthimi ne sherbim te komunitetit dhe ndikim ne rritjen e bizneseve te vogla qe ushtrojne aktivitet ne fushen e lundrimit, peshkimit, sherbimeve ambulante etj. 		
<p>Justifikimi i projektit:</p> <p>Liçeni i Fierzes eshte liçeni artificial me i madh ne Shqiperi, 72 km i gjate, sipërfaqe 8,169 ha. Ai eshte habitati i 13 llojeve te peshqve, molusqeve, gaforreve dhe amfibeve. Ai ofron shume perparesi per zhvillimin e turizmit si: peshkim, lundrim, varka me motor, lidhje me liçenin e Komanit, vende pergjate bregut per kamping, restorante. Me VKM Nr.88, dt 1.3.1993 kjo zone eshte shpallur zone me perparesi per zhvillimin e turizmit. Ky potencial natyror ipa shfrytezuar, ka nje kerkese ne rritje nga banoret per t'u vizituar dhe interes nga pushteti vendor per ta shnderruar ne nje destinacion turistik (perfshirja ne Planin Rregullues te Bashkise Kukës).</p>		
<p>Rezultatet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ambjenti ne bregun e Liqenit eshte bere me terheqes dhe i kendshem per turizem • Bizneseve te vogla u jane krijuar mundesi me te medha per ushtrim aktiviteti • Te ardhurat jane rritur deri ne 15% • Numri I vizitoreve eshte rritur 	<p>Produktet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 5000 banore qe shfrytezojne liçenin per turizem • 2000 fletepalosje te pergatitura per fushate • Projekt teknik cilesor i dizenuar • Vendosja e 1 linje Ujore • Breg liçenor I pastruar 	<p>Aktivitetet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Percaktimi i vijes se bregut per destinacion turistik • Pajisja me objektet dhe mjetet e nevojshme • Mbushja e nje vije bregu me rere plazhi • Venia ne funksion e linjave ujore • Nenshkrimi i marreveshjes se bashkepunimit mes partnereve • Dizenjimi dhe publikimi i 2000 fletepalosjeve • Publikimi ne median vizuale
<p>Partnerët dhe kontakte:</p> <p>Keshilli i Qarkut Kukës; Valdete Sinanaj; +355 66 20 66 456; valdete.sinanaj@kqk.gov.al Bashkia Kukës; Shpetim Dulla; +355 66 40 12 455; timdulla@yahoo.com</p>		

Vlera totale e projektit - 100.000 Euro
 Financimi I kerkuar nga jashte - 90.000 Euro
 Buxheti(koha) per projekt propozimin e plote - 3.000 Euro (6 muaj)

<p>Projekti: "Pastrimi i Liqenit te Fierzes dhe Zones Perreth tij"</p>		
<p>Objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Permiresimi i kushteve aktuale te liqenit te Fierzes, zhvillimi dhe ruajtja e faunes, si dhe krijimi i kushteve te pershtateshme per atraksion turistik. • Hartimi i planit te veprimit per pastrimin dhe mirembajtjen e Liqenit te Fierzes. 		
<p>Justifikimi i projektit:</p> <p>Liqeni i Fierzes ka nje gjatesi prej 72km dhe siperfaqe rreth 8,169 ha. Liqeni i Fierzes eshte i krijuar nga derdhja e lumenjve te Orinit te Bardhe, Drinit te Zi etj. Liqeni i Fierzes eshte i pasur me habitate dhe 13 lloje peshqsh, eshte i pershtatshem per udhetime turistike, peshkim etj. Me VKM Nr 88 Date 01/03/1993 bregu i liqenit te Fierzes eshte shpallur zone me perparesi per zhvillimin e turizmit. Problemi me i madh qe ekziston eshte se ky liqen ndotet shume nga mbetjet urbane ku pjesa me e madhe vjen nga rrjedhjet e lumenjve te Drinit te Bardhe dhe Drinit te Zi, te cilat ndikojne negativisht ne cilesine e ujit, faunes. ambjetit perreth, si dhe shfrytezimin e terrenit per plazh dhe aktivitete ujore. Perfitues te ketij projekti jane banoret e zones, nje numer i konsiderueshem peshkataresh, pushuesish, turistesh, grupesh interesi qe merren me aktivitete ujore</p>		
Rezultatet:	Produktet:	Aktivitetet:
<ul style="list-style-type: none"> • Siperfaqja ujore e Liqenit te Fierzes eshte permiresuar ne aspektin e pastertise • Komuniteti ka mundesine e shijimit te nje bregu te paster nga mbeturinat urbane • Jane krijuar kushte optimale per nje faune te zhvilluar dhe per peshkun si dhe per zhvillim turistik 	<ul style="list-style-type: none"> • Siperfaqe ujore dhe breg liqeni i pastruar • Peshk i shendetshem • Frekuentim me i madh ne liqen • Mjedis i paster 	<ul style="list-style-type: none"> • Vleresimi i gjendjes aktuale • Rekrutimi dhe krijimi I grupit te punes. • Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve te grupit te punes • Pergatitja e fletepalosjeve dhe langimi ne media i fushates per sensibilizim • Bashkepunim me i gjere me vendet kufitare nga ku vjen rrjedhja e lumenjve
<p>Partnerët dhe kontakte: Keshilli i Qarkut Kukes; Shkelqim Kastrati; +355693847984; shkelqim_ka@hotmail.com Komuna Kolsh; Jah Spahiu; +355 68 2140 331</p>		

Vlera totale e projektit - 60.000 Euro
 Financimi ikerkuar nga jashte - 51.000 Euro
 Buxheti (koha) per projekt propozimin e plote - 3.000 Euro (2 muaj)

<p>Projekti: Peshkezimi Artificial i Liqenit te Fierzes dhe Ujembledhesve te Qarkut Kukes</p>		
<p><u>Objektivat:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e prodhimtarise peshkore ne Liqenin e Fierzes dhe te gjithe Ujembledhesit e tjere te Rajonit. • Ngritja e nivelit ekonomik te gjithe komunitetit te popullsise banuese perreth pellgut ujembledhes te Liqenit. • Rindertimi dhe venia ne funksion e Qendres artificiale te kultivimit te larvave dhe rasateve te peshqeve. 		
<p><u>Justifikimi i projektit:</u> Vitet e fundit eshte vene re nje varferim krahasimisht i madh i mjediseve ujore me peshk si burim i mirefillte mireqenieje e te ardhurash nga punesimi. Kjo ka ardhur si pasoje edhe e peshkimit te pakontrolluar, por edhe si pasoje e mos furnizimit me peshk (rasate) te liqenit. Pervojet evropiane kane treguar se te gjitha zonat rurale qe kane shfrytezuar siperfaqet ujore ne akuakulture kane pasur nje bum ekonomik te dukshem.</p>		
<p><u>Rezultatet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekonomia e peshkimit ne liqenin e Fierzes eshte rehabilituar. • Te ardhurat e familjeve qe jetojne me peshkim jane rritur. • Peshkimi legal e industrial eshte me i organizuar • Liqeni eshte permiresuar ne aspektin mjedisor permes pasurimit te faune 	<p><u>Produktet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e ekonomise se rasateve • Punesim i perhershem i moshave te reja. • Kthimi i mjediseve ujore ne burime fitimi per te gjithe • Mbrojtja integrale e mjediseve ujore. • Organizimi i OJF-ve dhe OJQ-ve te peshkatareve ne intreresa te mjedisit 	<p><u>Aktivitetet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Takime dhe seminare me grupet e interesit • Studime dhe projektim per rehabilitimin e qendres se prodhimit industrial te akuakultures • Sensibilizim dhe takime bashkepunimi per parandalimin e demtimit te rasateve
<p><u>Partnerët dhe kontakte:</u> Inspektoriati i Peshkimit; Arben Palushi;+355 672083472 palushiarben@gmail.com Drejtoria e Bujqesise Kukes; Sehat Murataj;+355674065844 sehat_murataj@hotmail.com</p>		
<p>Vlera totale e projektit - 1.500.000 Euro Financimi ikerkuar nga jashte -1.275.000 Euro Buxheti (koha) per projekt propozimin e plote - 75.000 Euro (2 muaj)</p>		

Projekti: Promovimi i Turizmit Malor ne Zonen e Shishtavecit		
<u>Objektivat:</u>		
<ul style="list-style-type: none"> • Kthimi i Shishtavecit ne destinacion Turistik • Adaptimi i shtepive pritese duke ruajtur origjinalitetin • Funkcionaliteti i sporteve te skive nepermjet adaptimit te pistes ekzistuese 		
<u>Justifikimi i projektit:</u>		
Komuna Shishtavec gjate dimrit eshte e mbuluar nga debora prej 4-5 muajsh. Kjo zone ka potenciale per zhvillim te turizmit gjate gjithë vitit prej potencialeve te pasura natyrore. Ka mundesi hipizmi, skish dhe alpinizmi duke shfrytezuar terrenin shume te pershtatshem si dhe ecje ne male. Ne fshatin Shishtavec prej vitesh shfrytezohet nje piste natyrore per ski me permasa 1800 m dhe 60 m, ky lloj sporti eshte kthyer ne tradite per te gjithë. Ne kete zone mund te ofrohet sherbimi i shtepive pritese gjate gjithë vitit (40-50 shtepi mund te sherbejne qe tani). Fshataret e kesaj zone jane shume mikeprites dhe te pasur me nje kulture folku, gatimi, rregulli dhe pastertie.		
<u>Rezultatet:</u>	<u>Produktet:</u>	<u>Aktivitetet:</u>
<ul style="list-style-type: none"> • Numri i turisteve vendas dhe te huaj eshte rritur ndjeshem. • Turizmi malor eshte aktivizuar ne Qarkun e Kukësit • Jane krijuar kushte me te favorshme per organizimin e aktiviteve dimerore. • Komuna Shishtavec dhe zonat perreth kane pesuar rritje ekonomike • Komuniteti eshte i afte per menaxhimin e shtepive pritese per turiste, si te huaj dhe vendas 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtepi pritese me kushte te mira per pritjen e turisteve • Pista e skive me facilitetet e duhura per organizimin e sporteve dimerore • Struktura e menaxhimit te qendrueshem te kompleksit turistik dimeror 	<ul style="list-style-type: none"> • Krijim dhe takime te rregullta te nje grupi konsultativ ekspertesh • Hartimi i nje kodi mirembajtjeje per ruajtjen e mjedisit • Identifikimii nevojave dhe potencialeve te shtepive pritese • Trajnime per rritjen e kapaciteteve te aftesive menaxhuese per shtepite pritese • Aktivitete promovuese te ofertes turistike te zones
<u>Partnerët dhe kontakte:</u>		
Keshilli i Qarkut Kukës; Irena SHAHU; +355662066458; irena.shahu@kqk.gov.al Komuna Shishtavec; Dilaman Nela; +355 68 20 65 040; dilamannela@yahoo.com		
Vlera totale e projektit - 200.000 Euro Financimi i kerkuar ngajashte - 170.000 Euro Buxheti (koha) per projekt propozimin e plote - 5.000 Euro (6 muaj)		

Projekti: Mbrojtja dhe kultivimi i bimeve medicinale
<u>Objektivat:</u>
<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytezim ne menyre te qendrueshme te bimeve mjekesore eterovajore e tanifere. • Evidentim i plote i specieve BMET • Ndergjegjesimi dhe edukimi i komunitetit
<u>Justifikimi i projektit:</u>
Shfrytezimi drastik i pyjeve dhe nenprodukteve te dyta, sic jane BMET ne vitet e fundit, ka sjelle uljen e kapacitetit prodhues te tyre. Disa prej BMET po shkojne drejt zhdukjes. Shfrytezimi i qendrueshem kontrolli me i mire nga ana e shtetit, NJ.Q.V, dhe ndergjegjesimi i komunitetit do te sillte nje mundesi

rritjeje te te ardhurave familjare nga tregetimi e perpunimi i BMET dhe nje mjedis me pak te demtuar.		
Rezultatet:	Produktet:	Aktivitetet:
<ul style="list-style-type: none"> Mjedisi ne pergjithesi dhe BMET ne vecanti jane mbrojtur dhe menaxhuar ne menyre te qendrueshme. Mundesite e punesimit per nje pjese te konsiderueshme te popullsise jane rritur. Te ardhurat ekonomike per familjet dhe bizneset e perfshira jane rritur. 	<ul style="list-style-type: none"> Nje database, hartezimi i shperndarjes se specieve e popullatave me rendesi ekonomike per kete rajon rrethet Kukes, Has. Fidanishte me bime mjekesore. Toka te mbjella me bime mjekesore. Produkte te perpunuara bio(cajra, recelra, komposto, lengje) Teknologji te reja ne manipulimin e perpunimin e bimeve mjekesore. Lista e plote e specieve te BMET ne kushtet aktuale, perfshire listen e kuqe te BMET. Punesim i rreth 1500 personave. 	<ul style="list-style-type: none"> Takim me komunitetin dhe perfaqesues te njesive te qeverisjes vendore. Ekspedita ne terren. Workshop-e trajnuese per kultivimin e perpunimin shtepiak te produkteve. Sensibilizim ne media. Panair me disa prej produkteve te perpunuara ne kushte shtepie. Aktivite per te nxitur pervojat e kultivimit te BMET dhe perpunimit familjar te tyre.
<p><u>Partnerët dhe kontakte:</u> Keshilli i Qarkut Kukes; Majlinda Onuzi ; +355 66 20 66 460 ; majlinda.onuzi@kqk.gov.al Shoqata Mbrojtja e Mjedisit; Besnik Hallaci; +355 69 30 11 533 ; hallacibesnik@yahoo.com</p>		
<p>Vlera totale e projektit - 73.000 Euro Financimi i kerkuar ngajashte -70.000 Euro Buxheti (koha) per projekt propozimin e plote - 3.000 Euro (6 muaj)</p>		

<p>Projekti: Aftesimi Profesional ne Qarkun Kukes</p>
<p><u>Objektivat:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Permiresimii aftesimit profesional ne Qarkun Kukes Promovimi i arsimit profesional ne Qarkun Kukes Krijimi i shanseve me te medha per punesim
<p><u>Justifikimi i projektit:</u></p> <p>Shkolla e mesme e pergjithshme publike ne Kukes eshte e vetmja shkolle ne te gjithe Qarkun qe mundeson arsim profesional te integruar brenda ambienteve te saj. Nga 1400 nxenes ne total, rreth 300 prej tyre kane preferuar te ndjekin studimet profesionale. 90% e tyre jane kryesisht nga zonat rurale.</p>

<p>Gjithsej, jane 15 klasa te arsimit profesional te cilat mbuloohen me veshtiresi nga nje stat jo i mire-kualifikuar pedagogjik. Nxenesit qe studiojne ne disa profile si: elektrike, mekanike dhe hidraulike dy vitet e fundit te shkolles i vazhdojne dhe diplomohen ne shkollen profesionale te qytetit Shkoder per arsye te mungeses se mjeteve laboratorike dhe praktike ne Kukes</p>		
<p>Rezultatet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Interesi per ndjekjen e arsimit profesional eshte rritur; • Cilesia didaktike eshte permiresuar • Cilesia e mesimdhenies eshte permiresuar • Shanset per punesim jane rritur • Mundesite per rekrutime konkrete ne profesione perkatese jane permiresuar • Qasja ne tregun e punes per profesionet e ndryshme eshte me profesionale 	<p>Produktet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkolle publike profesionale bashkekohore • Staf i kualifikuar pedagogjik • Kurrikula dhe laboratore bashkekohore • Dyfishim i numrit aktual te nxenesve • Kontigjent i afte per pune profesionale 	<p>Aktivitetet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studim i tregut te punes per evidentimin e profesioneve te nevojshme • Pajisja me mjetet didaktike dhe laboratorike • Trainime kualifikimi per stafin mesimdhenes • Promovim i arsimit profesional • Rekrutime
<p><u>Partnerët dhe kontakte:</u> Bashkia Kukes; Shpetim Dulla +355 66 40 12 455 kordinim-zhvillimi@bashkiakukes.com ORP<;SSHB Vera Istrefi+35569 22 44 911veraistrefi@yahoo.com</p>		
<p>Vlera totale e projektit: 300.000 Euro Financimi i kerkuar nga jashte - 255.000 Euro Buxheti(koha) per projekt propozimin e plote - 6.000 Euro (12 muaj)</p>		

<p>Projekti: Bashke per nje Mjedis me te Shendetshem ne Pellgun e Kukesit</p>
<p><u>Objektivat:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e sherbimit te menaxhimit te mbeturinave urbane ne 4 komuna qe shtrihen ne pellgun e Kukesit • Permiresimi i ketij sherbimi aty ku ekziston. • Ndergjegjesimi i komunitetit prej 35,000 banoresh dhe aktoret e tjere mbi rendesine e menaxhimit te mire te mbeturinave urbane
<p><u>Justifikimi i projektit:</u></p> <p>"Pellgu i Kukesit" qe perfshin bashkine Kukes dhe kater komunat: Gjinaj te rrethit Has, Terthore, Shtiqen dhe Kolsh te rrethit Kukes perbehet nga 35 000 banore. Sasia e mbetjeve qe ata prodhojne gjate nje viti eshte 8000 ton. Mjedisi eshte i ndotur, jo i shendetshem dhe perkeqeson cilesine e jetes se banoreve. Sherbimi ofrohet vetem ne bashkine Kukes per qytetaret. Hedhja e mbeturinave ne komuna behet ne vende te paautorizuara, kryesisht ne perrenj qe derdhen ne Orin. Shqetesues eshte fakti se 80% e femijeve qe bejne analiza ne laboratore shendetesore rezultojne me e-coli, nje bakter</p>

<p>qe perhapet kryesisht nga fekalet e kafsheve neper uje. Perzierja e mbetjeve ka ndikuar rende ne shendetin e banoreve duke perhapur shume semundjet e mushkerive, laringut etj</p>		
<p>Rezultatet:</p>	<p>Produktet:</p>	<p>Aktivitetet:</p>
<ul style="list-style-type: none"> Banoret jetojne ne nje ambient me te paster ne pellgun e Kukesit, 35,000 banore te pellgut Kukes kane shendet te sigurt Kushtet per zhvillim turistik ne pellgun e Kukesit jane permiresuar Banoreve te 5 NjQV-ve u sherbehet permes sistemeve te pershtatshme Banoret e bashkise Kukes perfitojne sherbime te permiresuara Komuniteti eshte ndergjegjesuar per pasojat e hedhjes se mbeturinave urbane ne vende te paautorizuara 	<ul style="list-style-type: none"> Sistem menaxhimi funksional Vend-grumbullim i percaktuar per mbetjet e pellgut Kukes 80 konteniere te vendosur ne komuna 4 plane te miratuara ne komuna per menaxhimin e mbetjeve Vend-grumbullim i sigurte dhe i ruajtur 	<ul style="list-style-type: none"> Pergatitje,botim dhe shperndaje materialesh informative Ndergjegjesim i komunitetit per nje perkujdesje mjedisore Takime me keshillat komunale Takime me komunitetin Biseda ne radio dhe TV Asistence NjQV-ve per pergatitjen e planeve te menaxhimit
<p><u>Partnerët dhe kontakte:</u> Keshilli i Qarkut Kukes; Jetmir Axhami; +355 662066505; jetmir.axhami@kqk.gov.al ARM Kukes: Petrit Peposhi; +355682147259; petritpeposhi@yahoo.com</p>		
<p>Vlera totale e projektit - 70.000 Euro Financimi i kerkuar nga jashte - 60.000 Euro Buxheti (koha) per projekt propozimin e plote - 3500 Euro (8 muaj)</p>		

Aneks 2 – Autorë dhe kontribues

Nr.	Emri	Institucioni	Pozicioni
1	IBSEN ELEZI	KËSHILLI I QARKUT KUKES	KRYETAR

2	IRENA SHAHU	KESHILLI I QARKUT KUKES, DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT	DREJTOR
3	MAJLINDA ONUZI	KESHILLI I QARKUT KUKES, DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT	PERGJEJGJESE PER STRATEGITE
4	VALDETE SINANAJ	KESHILLI I QARKUT KUKES, DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT	SPECIALISTE PER MJEDISIN
5	ARJOLA DOMI	KESHILLI I QARKUT KUKES, DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT	SPECIALISTE PER TURIZMIN DHE INVESTIMET
6	VLADIMIR LUSHI	KEHSILLI I QARKUT KUKES, DEPARTAMENTI TIPS	DREJTOR
7	DESANTILA HASA	KEHSILLI I QARKUT KUKES, DEPARTAMENTI TIPS	SPECIALIST PER STATISTIKAT
8	ROBERT GIREJKO	ISD – UNDP	TEAM LEADER
9	COLM MCCLEMENTS	ISD – UNDP	EKSPERT NDERKOMBETAR
10	IRIS KUQI	ISD – UNDP	EKSPERT LOKAL
11	EDVIN PUKA	ISD – UNDP	EKSPERT LOKAL
12	DRITAN SHUTINA	CO PLAN	DREJTOR
13	BILBIL KERAJ	ISD – UNDP	EKSPERT LOKAL

Aneks 3 – Konsultimet e strategjisë

Data: 06/06/2012

Aktiviteti i Konsultimit: workshop - Prezantimi i Draft Strategjisë, grupeve rajonale te interesit – konsultimet publike

Nr.	Emri	Institucioni	Pozicioni
1	AGRON HOXHA	SHOQERIA CIVILE	ADMINISTRATOR
2	BESNIK HALLACI	SHOQERIA CIVILE	SPECIALIST PER BIMET MEDICIONALE
3	DILAMAN NELA	KOMUNA SHISHTAVEC	KRYETAR
4	DAN KOLOSHI	KOMUNA ZAPOD	KRYETAR
5	GONXHE KANDRI	PARTNERE PER FEMIJET	ASISTENTE PROJEKTI
6	INGRID JONES	PARTNERE PER FEMIJET	DREJTORE
7	ARBEN KORBI	KOMUNA BICAJ	KRYETAR
8	ZENEL KASTRATI	KOMUNA GOLAJ	KRYETAR
9	RUSTAN HASALAMI	SHERBIMI GJEOLOGJIK	PERGJEGJES ZYRA KUKES
10	HYSNI ZENELAJ	DRSSH KUKES	DREJTOR DEGE
11	URIM HOTI	RAIFFEISEN BANK	SPECIALIST MIKRO BIZNESI
12	BILBIL KERAJ	RAIFFEISEN BANK	DREJTOR DEGE
13	MIRDASH HOXHA	DREJTORIA RAJONALE E TATIM TAKSAVE	DREJTOR
14	SHKELQIM MUCA	OBSERVATORI PER TE DREJTAT E FEMIJEVE	EKSPERT
15	GENTIAN PALUSHI	ALB-AID	PROJEKT KOORDINATOR
16	SHPETIM DULLA	BASHKIA KUKES	SPECIALIST
17	BUKUROSH ONUZI	UNDP KUKES	KOORDINATOR PROJEKTI
18	VERA ISTREFAJ	QKGSHS	DREJTORE EKZEKUTIVE
19	ARBEN BASHA	DREJTORIA E RRUGEVE	DREJTOR
20	HALIL ALIAJ	KOMUNA SURROJ	KRYETAR
21	VESEL SHEHU	KOMUNA CAJE	KRYETAR
22	AHMET SHIRA	KOMUNA KALIS	KRYETAR
23	RRAHIM CELIKU	KOMUNA TOPOJAN	KRYETAR DEGA FINANCES
24	LABIBE TOTA	PREFEKTURA KUKES	SEKRETARE
25	ADRIANA BELA	IPA CBC	DREJTORE
26	ZANA SHEHU	INSTAT KUKES	DREJTORESHE
27	FILIPPO ONTERHOFER	CELIM	PROJEKT MANAXHER
28	FRANCESCA BIGI	CELIM	BASHKEPUNTORE
29	MERITA BRATI	ZYRA E PUNES KUKES	DREJTORE
30	SELMAN MATMUJA	KOMUNA TERTHORE	N/KRYETAR
31	SULEJMAN NOKA	KESHILLI I QARKUT KUKES	KESHILLTAR
32	VLADIMIR LUSHI	KESHILLI I QARKUT KUKES	DREJTOR TIPS
33	BESNIK AXHAMI	KESHILLI I QARKUT KUKES	SPECIALIST DPT
34	TRENDELINA MUJA	KESHILLI I QARKUT KUKES	DREJTOR DPT
35	PRANVERA VESELI	KESHILLI I QARKUT KUKES	SPECIALISTE
36	OMER LLUKOZI	KESHILLI I QARKUT KUKES	SPECIALIST
37	GAZMEND CEJKU	KESHILLI I QARKUT KUKES	JURIST
38	ALBERT ZENELI	KESHILLI I QARKUT KUKES	DREJTOR SHERBIME
39	SHKELQIM KASTRATI	KESHILLI I QARKUT KUKES	SPECIALIST
40	ELONA SHAQIRI	KESHILLI I QARKUT KUKES	KESHILLTARE
41	DESANTILA HASA	KESHILLI I QARKUT KUKES	SPECIALISTE

Aneks 4 – Integrimi I komenteve nga konsultimet publike

Konsultimet publike u mbajtën më 6 qershor 2012, dhe u ndoqën nga një periudhë prej 10 ditësh për komente të mëtejshme. Tabela e mëposhtme liston komentet e marra dhe trajtimin e tyre në dokumentin final

Komentet e Marra	Shqyrtimi i Komenteve
Strategjia duhet të nxjerrë në pah nevojën për infrastrukturë në zonat rurale lidhur me nevojën për kujdes shëndetësor, kujdesin e fëmijës dhe shërbimet e tjera publike dhe mënyra të tjera për të siguruar ndryshime pozitive.	Komentet e integruara tashmë në draft Prioritetet (1,2,5,6,8) merren me çështjet e përmendura sipas perspektivës së cdo sektori.
Strategjia është e fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës por nuk reflekton situatën në zonat rurale.	Koment jo i integruar Strategjia mbulon tërë rajonin dhe trajton diferencimin qyteteteve dhe zonave rurale kudo. Me karakteristikat që ka, i tërë territori konsiderohet 'rural' sepse urbanizimi është minimal.
Duhet të përfshihen objektivat e mbrojtjes së monumenteve historike dhe kulturore	Komentet e integruara tashmë në draft Mbrojtja e monumenteve natyrore, historike dhe kulturore është pjesë e aktiviteteve dhe qëllim i prioritetit të parë 'zhvillimin e turizmit malor ...' dhe të katërt "Përmirësimi i kushteve mjedisore
Trashëgimia natyrore dhe kulturore dhe ruajtja e saj nuk është trajtuar siç duhet.	Si më sipër
Burimet natyrore duhet të inventarizohen dhe të vihen në shërbim të turizmit .	Komente të integruara tashmë në draft Strategjia i referohet shpeshherë Strategjisë së Zhvillimit Rajonal të Turizmit kështu që nuk ka nevojë të kujtojmë përmbajtjen e saj në mënyrë të plotë.
Zhvillimi i rrugëve duhet të marrë në konsideratë aksesin në zonat e turizmit malor.	Komente të integruara tashmë në draft Prioriteti 8 'Rritje e aksesibilitetit ...' thekson qartësisht se zhvillimi do të mbulojë rrugët zonat e largëta dhe të prapambetura e do të prioritetizojë destinacionet me potencial ekonomik dhe turistik
Zhvillimi i bujqësisë duhet të përfshijë ndërhyrjet përkatëse infrastrukturore: p.sh. kanalet e vaditjes.	Komente të integruara tashmë në draft Prioriteti 2, "Zhvillimi i bujqësisë ..." mbulon të gjitha veprimet që lidhen me përmirësimin e kushteve të zhvillimit të bujqësisë. Meqenëse nismat kryesore të ujitjes në rajon janë ndërmarrë tashmë në kohën e hartimit të Strategjisë, nuk është nevojë të përqendrohemi më gjatë këtu
Shumë rezultate nuk kanë tregues të matshëm. P.sh. rezultat i prioritetit 1 "rritje më e madhe ekonomike në rajon".	Komente të integruara pas konsultimeve Shumica e rezultateve janë shprehur në vlera numerike dhe tregues. Kur kjo nuk ka qenë e mundur, janë ofruar shënime shpjeguese.
Vihet re se në strategji nuk është përmendur fokusi i veçantë për gratë	Komente të integruara tashmë në draft Prioriteti 6, "Zhvillimi i Njerëzve" ofron një paketë gjithë-përfshirëse për të integruar plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha grupet e shoqërisë.
Nuk janë përmendur çështjet që prekin fëmijët	Si më sipër
Strategjia duhet të shoqerohet nga nje plan veprimi	Koment i përfshirë pjesërisht në draft Nuk ka një Plan Veprimi formal, por udhëzimet për zbatimin e

	Strategjisë janë integruar në dokument në pjesët që kanë të bëjnë me menaxhimin e Strategjisë. Për më tepër, çdo Prioritet tregon hapat e mëtejshme që do të ndërmerren nga ana e Partneritetit Rajonal përkatës (s) që kanë të bëjnë me çdo çështje tematike. Tashmë në Strategji ka një numër të mirë të projekteve që e cojnë zbatimin një hap më tej, nëpërmjet operacionalizimit të ndërhyrjeve konkrete që kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike.
Ekziston një nevojë për sensibilizimin e komunitetit për të zhvilluar sektorin e turizmit, si p.sh. nëpërmjet takimeve të komunitetit në terren.	Koment i përfshirë pjesërisht në draft Prioriteti 1, "Zhvillimi i turizmit ..." mbulon veprimet lidhur me aktivizimin e potencialit njerëzor dhe masat për zhvillimin e kapaciteteve për sektorin e turizmit. Projektet individuale do të detajojnë më tej qëllimin e veprimeve specifike.
Strukturat lokale (kryesisht NJQV) duhet të jenë të trajnuar për zbatimin e Strategjisë.	Komente të integruara tashmë në draft Strategjia bën thirrje për funksionimin e Partneritetit Rajonal edhe në fushat tematike, që përfshijnë jo vetëm njësitë e qeverisjes vendore, por edhe aktorët e tjerë. Ky proces u iniciua në fazën e përpunimit të Strategjive dhe është planifikuar të vazhdojë në fazën e zbatimit të tij
OJQ të ndryshme në sektorët prioritarë duhet të përfshihen, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve (p.sh. shërbimet e kujdesit në fëmijërinë e hershme).	Komente të integruara tashmë në draft Strategjia bazohet në parimet e pjesëmarrjes dhe partneritetit dhe ka përfshirë të gjitha OJQ-të përkatëse që në krye të herës
Duhet të përfshihet mbështetja për bizneset lokale familjare në kushte jo-diskriminuese	Koment i integruar tashmë në draft Përgjithësisht nuk ka mbështetje për bizneset e vogla dhe të mesme, ndërkohë asistencë ofrohet në sektorët prioritarë të zhvillimit: turizmi / agro-turizmi dhe agro-përpunimit (Prioritet 1 "Zhvillimi i Turizmit ..." dhe Prioriteti 2 "Zhvillimi i Bujqësisë "). Gjithashtu promovimi i sipërmarrjes është parashikuar në Prioritetin 6 "Zhvillimi i Njerëzve"
Mungojnë shërbimet në arsim, shëndetësi, të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, etj Kanë nevojë të identifikohen dhe zhvillohen.	Koment i integruar tashmë në draft Prioritet 5 "Zhvillimi i kapaciteteve për të menaxhuar Zhvillimin Rajonal" ... dhe Prioriteti 6 "Zhvillimi i njerëzve", adresojnë nevojën për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve kryesore publike dhe integrimin e të gjitha grupeve të shoqërisë.
Janë të nevojshme për zbatimin e Strategjisë, planet për bashkëpunim mes NJQV-ve dhe grupeve të interesit	Koment jo i integruar Strategjia përcakton Partneritetin (et) Rajonal (e) si mekanizëm për të përfshirë të gjithë aktorët përkatës në zbatim të tij. Planet individuale / sektoriale / dhe tematike duhet të zhvillohen si një veprimë përforcuese të Strategjisë aty ku është e nevojshme.
Strategjia duhet të përqëndrohet më shumë në bashkëpunimin ndër-kufitar dhe atë ndër-kufitar rajonal.	Koment jo i integruar Strategjia në vetvete nuk i përket vetëm çështjeve të BNK. Megjithatë, këto bashkëpunime janë inkurajuar si në analizë ashtu edhe në veprimet e propozuara, (p.sh. disa projekte kyçe të përfshira tashmë në dokument, parashikojnë mundësinë që të zbatohen së bashku me rajonet CBC
Ne e shohim dokumentin strategjik rajonal si një mjet të integrimit me rajonet përreth, sidomos me Kosovën.	Si më sipër
Ekziston nevoja për përvijimin e prioriteteve të NJQV-ve me zhvillimin në	Koment i përfshirë pjesërisht në draft Strategjia trajton rajonin si një njësi funksionale të vetme dhe

tërë territorin e rajonit.	megjithëse ka diferencim në aspektin lokal, ajo ende mbetet një strategji të përbashkët. NJQV-të, ndërsa zhvillojnë planet dhe strategjitë e tyre lokale duhet t'i referohen kësaj Strategjie, si një document in je niveli më larti miratuar nga Këshilli rajonal përfaqësuesi i tyre.
Fëmijët janë parë si një pasuri, por nuk ka shërbime që ndihmojnë zhvillimin e tyre, në aspektin shëndetësor dhe kohës së lirë.	Koment i përfshirë pjesërisht në draft Disa prioritete si psh: 5, "Zhvillimi i kapaciteteve për të menaxhuar ZHR ..." Zhvillimi i njerëzve" dhe 8 "Mbrojtja shëndetësore" u përgjigjen nevojave të kategorive të ndryshme shoqërore dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike.
Cilat janë shërbimet që ofrohen për personat me aftësi të kufizuara?	Si më sipër
Ka një problem lidhur me zhvillimin e pabarabartë të komunave të ndryshme.	Koment i integruar tashmë në draft. Pabarazitë ndër-rajonale janë paraqitur dhe analizuar. Disa prioritete synojnë reduktimin e pabarazive nëpërmjet integritit të lokaliteteve dhe grupeve në zhvillimin ekonomik dhe social.
Bordi i Punësimit duhet të përfshihet në vlerësimin e projekteve.	Koment jo i integruar Ndërsa është e njohur se Bordi Punësimi është një aktor i rëndësishëm rajonal, Strategjia parashikon që Partneritetit Rajonal (ose Ekzekutiv në emër të tij), do të prioritetizojë projekte duke marrë parasysh një sërë aspektesh zhvillimore dhe kritere përkatëse.
Duhet të konsiderohet bashkëpunimi me biznesin për të siguruar mundësi punësimi	Koment i integruar tashmë në draft. Strategjia është e ndërtuar mbi parimin e partneritetit dhe bashkëpunimit. Organizatat e biznesit janë të përfshira në hartim dhe do të ftohen në zbatimin e Strategjisë
Duhet të sigurohen fonde të mjaftueshme nga donatorët dhe qeveria për zbatimin e Strategjisë. Prioritetet nuk kanë buxhete të paracaktuara.	Koment jo i integruar Strategjia është zhvilluar në kuadër të një situatë buxhetore të papërcaktuar nga aktorët rajonale / lokale dhe donatorët. Dukeqenëse nuk ka angazhime të forta, janë përcaktuar vetëm rezultatet dhe veprimet e pritshme. Pastaj është për tu siguruar financimi në nivel projektes, i varur nga fondet e jashtme në dispozicion si: (qeveria BE dhe donatorë të tjerë). Prioritarizimi i fushave të zhvillimit dhe projektet kyçe, bazuar në objektivat strategjike dhe konsensus mes Partneritetit Rajonal, sigurojnë një mekanizëm të shëndoshë për një përdorim më të mirë të fondeve.
Duhet të parashikohet të paktën një laborator për energjitë e rinovueshme në aspektin "studimor".	Koment jo i integruar Strategjia është fokusuar në nevojat më të dukshme dhe urgjente në rajon; në fushën e energjisë, që qartësisht është përdorimi racional dhe maksimal i burimit ekzistues e të rinovueshëm të të hidro-energjisë.
Duhet të zhvillohet një plan për monitorimin e objektivave dhe projekteve që përfshijnë këtë strategji.	Koment i integruar tashmë në draft. Është shkruar në mënyrë të qartë se si do të zbatohet dhe monitorohet strategjia. Këshilli rajonal është organi që do zhvillojë më tej treguesit e monitorimit sipas prioriteteve apo projekteve.
Zbatimi i programeve dhe projekteve duhet të marrë në konsideratë barazinë gjinore.	Koment i integruar tashmë në draft. Strategjia synon një zhvillim gjithë-përfshirës dhe merr parasysh edhe aspektin e barazisë gjinore. Më konkretisht veprimet që kanë për qëllim balancimin e përfitimeve për grupe të ndryshme të shoqërisë janë përshkruar në prioritetin 6 "Zhvillimi i njerëzve" dhe Prioritetin 7 "Mbrojtja shëndetësore".

Grupet e interest duhet të paraqiten në dokument	Koment i integruar tashmë në draft. Kategori të ndryshme të palëve të interesuara janë paraqitur në anekset bashkëlidhur strategjisë, ndërsa lista e institucioneve anëtare të Partneritetit Rajonal është në dispozicion në Administratën Rajonale.
Diskutimet përfundimtare me të gjitha palët e interesuara duhet të bëhen një pjesë integrale e strategjisë.	Koment i integruar pas konsultimeve Strategjia integron komentet e mbledhura përmes procesit të konsultimeve publike dhe i trajton ato në dokument.
Zhvillimi i turizmi dhe industrisë minerare nuk duhet të konsiderohen si prioritetet e para.	Koment jo i integruar Ndërkohë që mund të ketë shumë arsye pro dhe kundër, zgjedhjet strategjike duhet të bëhen në bazë të evidencave nëpërmjet metodave demokratike e pjesëmarrëse. Faktet tregojnë se këto sektorë, si dhe bujqësia, mund të sjellin përfitime të konsiderueshme në ekonominë rajonale dhe popullsi. Nga konsultimi në grupe sektoriale që përfaqësojnë autoritetet rajonale dhe lokale, OJQ-të dhe përfaqësuesit e biznesit e sektorëve të mësipërm janë përzgjedhur si një fokus kryesor i zhvillimit afatmesëm. Kjo nuk përjashton domosdoshmërisht mbështetjen për sektorët e tjerë, nëse burimet e lejojnë.
Një bazë të dhënash rajonale duhet të jetë pika e fillimit të projekteve të zhvillimit.	Koment jo i integruar Ndërsa baza rajonale e të dhënave dhe informacionit është një element kyç për zhvillimin e mbështetur në evidenca, hartimi i saj nuk duhet të kushtëzojë ecurinë e projekteve të tjera zhvillimore